

Autorin e ndjerë të albumit fotografik *Berati, dream and feeling*, Leon Çika, reporter e fotograf i rrallë i trashëgimisë materiale shqiptare, diku-diku i përafërt me Marubët; gjetiu i ngjashëm me zgjedhjet artistike të Gjon Millit, e njihja prej së hershmi, por nuk më kishte rënë gjasa të bashkëpunoja. Një dekadë e ca më parë, kur albumi kishte marrë fytyrën e një veprë të mbyllur, ndodhi ajo që nuk e kisha menduar: një kërkesë për të shkruar hyrjen e tij. Dhe u nis e u shkrua kjo parathënie, e botuar në atë kohë në hyrje të veprës dhe e ribotuar sot *ad honorem* për autorin e saj Leon Çika.

Ad honorem/Për Beratin, ëndërr dhe gëzim/ Berati, dream and feeling (album fotografik) të Leon Çikës

Nga Shaban Sinani



Botohet në Itali romani i parë i Besnik Mustafajt, "Vera pa kthim"

Në Shqipërinë komuniste seksualiteti ishte një tabu që i nënshtrohej censurës

Nga Gianni Santamaria

L'Avvenire, 15/11/2024

(fq. 9)

SHËNIME MBI LIBRAT

Refleksione mbi vëllimin "Njeriu buzë lumit", Agron Tufa

"Ka diç që (s')të bind" në poezinë e Agron Tufës

Nga Rei F. Hodo

(fq. 6)

Dimensioni sintaksor dhe semantik në romanin "Lakimi" të Durim Taçit

Nga Arben Iliazi

(fq. 7)

Mbi antologjinë poetike "Midis njeriut dhe Zotit", përkthyer nga Melsen Kafilaj
MIDIS NJERIUT DHE ZOTIT,
QËNDRON POEZIA

Nga Teuta Dhima

(fq. 8)

Poezia e Sadik Bejkos
Në thellësitë e vuajtjeve mund të jetë dhe lartësimi yt

Nga Fatbardh Amursi

(fq. 10)

Variacione mbi temën "Camera obscura" të autorit

Stefan Çapaliku

Nga Arben V. Shala

(fq. 14)



Libri i ri i Ahmet Shqarrit Një udhëtim mes mallit dhe dashurisë njerëzore...

Nga Ylli Pepo

(fq. 12)

Ahmet Shqarri është edhe një analist i ngjarjeve shoqërore, kulturore dhe politike, skenarist filmash, ku ka fituar edhe çmime ndërkombëtare (në Milano, në Pekin dhe në Jakutsk të Rusisë, 100 km larg Polit të Veriut), ideator, drejtues e moderator i një sërë të madhe programesh televizive, autor i shumë shkrimeve, të botuar në gazetë e revistat e shumta, së fundmi, edhe autor i dy librave me vlera tepër të veçanta për historinë e sportit shqiptar.

Fragment nga libri biografik "Jolanda nëna ime"

Mamaja dhe ne vajzat

Nga Prof. Dr. Klara Kodra

(fq. 11)

Zbigniew Herbert –
kronikan i rrethimit apo
dëshmitar i fatalitetit?

Nga Noel Boci

(fq. 22)

MIEKO
KAWAKAMI
Dera ndërmjet nesh

Përktheu Andreas Dushi

The New Yorker



(fq. 23)

BIBLIOTEKË

Ismail Kadare

(fq. 16)

Nudo

Entela Tabaku

(fq. 18)

Qeramikiana

Jani Malo

(fq. 19)

Nga Tirana në Boston

Sadik Qaka

(fq. 15)

'gjyshja nuk thotë asgjë'...

Marash Mirashi

(fq. 20)

Pylli i verdhë i parafinës

Faruk Myrtaj

(fq. 21)

I fundmi që do lërë Amerikën...

Istref Haxhillari

(fq. 21)

Karmençita

Arben Meksi

(fq. 24)

Karikatura e së shtunës

Një ekspozitë e artistit durrsak

Krist Dimo në sallën

e Kryeministrit

Nga Artur Spanjoli

(fq. 13)

Dimo ka arritur të ketë një stil krejt origjinal, të tijin. Një stil që aludon, provokon, thellohet, mediton, ëndërron. Një stil plot pulsione jete, ku Dimo filozof me ngjyra dhe linja, na flet me poezinë e tij.

Autorin e ndër të albumit fotografik *Berati, dream and feeling*, Leon Çika, reporter e fotograf i rrallë i trashëgimisë materiale shqiptare, diku-diku i përafërt me Marubët; gjetiu i ngjashëm me zgjedhjet artistike të Gjon Millit, e njihja prej së hershmi, por nuk më kishte rënë gjasa të bashkëpunoj. Një dekadë e ca më parë, kur albumi kishte marrë fytyrën e një veprë të mbyllur, ndodhi ajo që nuk e kisha menduar: një kërkesë për të shkruar hyrjen e tij. Përgjigjes sime të mirësjellë se nuk isha njohës i artit të fotografimit autori i albumit iu përgjigj aq shpejt sa dukej qartë se do ta kishte paramenduar ngurrimin tim:

- Nuk prish punë, ti shkruaj për Beratin, albumi do të botohet shqip e anglisht, gjithë qëllimi është që lexuesi, sidomos ai që nuk na njeh, ta dojë këtë qytet.

Dhe u nis e u shkrua kjo parathënie, e botuar në atë kohë në hyrje të veprës dhe e ribotuar sot *ad honorem* për autorin e saj Leon Çika.

I.

Qyteti i Beratit është një vendbanim protoshqiptar, i themeluar në kufijtë e shekullit të 6-të dhe të 5-të para Krishtit. Në shekullin e 4-t mori karakterin e një qyteti (*polis*), kurse në shekullin e 3-të ishte *qytet-kështjellë*. Në periudhën antike njihet me emrin *Antipatrea* (Αντιπατρία).

Martin Leake, një udhëpërshkrues i njohur britanik, në vitin 1835, duke u nisur prej ngjashmërive të dukshme të Beratit me *Antipatrea*-n antike, si një *qytet që ndodhet në një grykë të ngushtë*, siç përshkruhet nga Tit Livi (XXXI, 27: 3), i pati njësuar Antipatrea dhe Beratin si dy vendbanime urbane që vijnë kronologjikisht njëri-tjetrit. Një argument kritik të plotë i ka bërë kësaj vijimësie arkeologu shqiptar Neritan Ceka (*Lashtësia dhe emri antik i kështjellës së Beratit*, në *Monumentet*, 1990/2, f. 33-36, numër përjashtimor për *Beratin monumental*). Neritan Ceka shqipton gjithashtu hipotezën e një lidhjeje burimore etimologjike midis emrit të fisit ilir të *parthinëve* dhe kryeqendrës së tyre *Parthe* (nga rrënja e ilirishtes *i bardhë*, ngjashëm dhe në shqipen e sotme), me formën mesjetare të kalkuar semantikisht të të njëjtit qytet, *Belegradon* (Βελεγράδων) me kuptimin *qytet i bardhë*; sido që nuk mund të përjashtohet dhe interpretimi prej greqishtes *παρθένος*, me kuptimin *i pastër, i virgjër*).

Në terminologjinë e administratës së krishterimit të hershëm emri i Beratit, si qendër ipeshkvie, del në formën *Pulheriopolis* (Πουλχερίοπολις / Πουλχερίοπολις). Ipeshkvi i *Pulheriopolit*, siç kemi përmendur më herët në një shkrim tjetër (*Kodikët e Shqipërisë, thesare të kulturës botërore*, në *Eksklusive*, nr. 36/2003, f. 84-119) mori pjesë në koncilin e parë të Nikesë dhe nënshkroi aktet ekumenike të pranuar. Por, sipas një historiani jo shumë të njohur të antikitetit, *Sozomenus*, vendbanimi i hershëm në buzë të Osunit, që njihet me emrin *Antipatrea* (Αντιπατρία) mbante edhe emrin tjetër, *Veritos* (Βηρυτός, Βερυτός), që fonetkisht ngjan shumë me emërtimin e sotëm.

Aleksandër Meksi, njohës i dorës së parë i historisë së ngulitjes së krishterimit në formë të organizuar administrativisht, mendon se Pulheriopolis si njësi episkopale përmendet pak më vonë, në *udhërrëfyesin e Hieroklitit*, që i takon viteve 528-529. Meksi vëren se për një kohë emri i kësaj peshkopate del nga vëmendja dhe rishfaqet në fund të shekullit të 10-të, në kohën e sundimit të perandorit bizantin Cimiskes, kohë kur qyteti i shpëton sundimit bullgar

Ad honorem



Për Beratin, ëndërr dhe gëzim / Berati, dream and feeling (album fotografik) të Leon Çikës

Nga Shaban Sinani



(vitet 970-998). Emri *Pulheriopolis* ruhet deri në shekullin e 12-të, kur, me sa del nga burimet, përmendet për herë të fundit së bashku me Gllavinicën, si ipeshkvi të varura administrativisht nga Ohri.

Berati *ridëshmohet në epitafin e njohur të Gllavinicës, ku përmendet Kalisti, peshkopi i Gllavinicës dhe i Beogradit* (A. Meksi, *Kishat bizantine të Beratit*, në *Monumentet*, 1990/2, f. 37).



Një nga relacionet e Ambasadës së Shqipërisë në Pekin drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Tiranë, me njoftime për punën që u bë për shërimin e dy kodikëve (AQSH, dhjetor 1971)

II.

Guntram Koch, një studiues bashkëkohës i shkollës klasike gjermane, heq çdo dyshim nëse Antipatrea, Pulheriopolis dhe Berati janë apo jo i njëjti qytet në periudha të ndryshme të historisë, pavarësisht se *nuk e dimë me siguri se deri kur Antipatrea u quajt Pulheriopolis*. E sigurt është se, së paku prej fillimit të shekullit të 6-të, Antipatrea - duke e marrë të besueshme tezën e mbivendosjes së Beratit të sotëm ndaj saj - quhej *Pulheriopolis*, apo *qyteti i Pulherias*, një toponim i zgjedhur për nder të emrit të motrës së perandorit Teodosios i dytë. *Pulheria*, në vitin 450, u martua me gjeneralin *Markianos*, i cili, për këtë arsye, pasoi në fron perandorin.

Vetë ky fakt tregon se Berati në krishterimin e hershëm nuk ishte një vendbanim çfarëdo. Një vendbanimi dytësor nuk mund t'i rezervohej privilegji për të mbajtur emrin e motrës dhe të tutores së perandorit. G. Koch mendon se në veprën *Mbi ndërtimet të kronikanit Prokopios*, bashkëkohës i perandorit Justinian, toponimi *Antipagrai* (Αντιπαγραί) si qytet ku ishin rindërtuar kështjella, duhet të jetë një formë gjuhësisht e gabuar e emrit *Antipatrea*, ku shkronja *T* (ταυ) e greqishtes është ngatërruar me shkronjën *G* (γάμμα). Në artikullin e tij *Disa dëshmi të periudhës së hershme bizantine në Berat* (*Monumentet*, 1990/2, f. 113-115) G. Koch sjell fakte të rëndësishme që provojnë se Berati kishte një shkallë të lartë zhvillimi në kohën kur mendohet se u shkrua kodiku më i hershëm i traditës kishtarë në Shqipëri, *Kodiku i Purpurt i Beratit - Codex Purpureus Beratinus j 043*, që nga viti 2005 pjesë e programit të trashëgimive më elitare të UNESCO-s *Memoire du Monde*.

Sado që shumica e studiuesve pajtohen se Berati mori rolin e një kryeqendre administrative dhe kulturore kishtarë nga shekulli i 12-të e këndeje, një pjesë e rëndësishme e tyre mendojnë se *në antikitetin e vonë, prej shekullit të 4-t deri në shekullin e 6-të, rëndësia e qytetit rritet* (E. Riza, *Qyteti muze i Beratit, arritje dhe perspektiva*, në *Monumentet*, 1990/2, f. 10). Njoftimi i Guntram Koch se në antikuarin e pasur të Beratit gjendet, veç *Kodikut të Purpurt* (duke nënkuptuar me këtë të *parin*, atë të mesit të shekullit të 6-të, sepse Berati ka dhe një kodik tjetër të purpurt, të shekullit të 9-të) edhe një objekt tjetër *i pazakontë*, i së njëjtës kohë, *një pllakë parmaku që i përket një kisha bizantine të hershme, të ndërtuar në gjysmën e parë të shekullit të 6-të*, merr një rëndësi thelbësore në lidhje me debatet që janë zhvilluar e zhvillohen rreth burimit të traditës së shkrimeve të krishtera në Shqipëri. Koch mendon se objekte të tilla *vijnë nga kisha paleokristiane* (po aty). Ai shprehet i shqetësuar pse këtij artefakti nuk i është dhënë vëmendje shkencore e merituar, qysh prej vitit 1918, kur dietari E. Buschbec pati saktësuar se ai gjendej në *Xhaminë e beqarëve*, dikur *kishë e Ungjillizimit*, ku në vitin 2010 nuk u gjet asnjë gjurmë.

Duke vlerësuar tipologjinë e këtij relikti, ku shquhen dy figura-simbol: kryqi dhe qengji, Koch mendon se *nuk mund të gjejmë shembuj të tjerë në perandorinë bizantine, veçse në Sirinë e largët* (*Disa dëshmi të periudhës së hershme bizantine në Berat*, në *Monumentet*, 1990/2, p. 113-115), dhe kjo na kujton se një shumicë paleografësh dhe historianësh të *Shkrimeve të Shenjta* edhe prejardhjen e *Kodikut të Purpurt të Beratit* e gjejnë të referuar në



Kodiku i Purpurt i Beratit (Codex Purpureus Beratinus - CPB), foto para dhe pas restaurimit

shkollën siro-palestineze (E. Crisci, *Vangelo di Matteo e Marco*, në *I Vangelo dei Popoli*, Roma 2000, p. 123), përkundër një mundësie tjetër, që t'i përkasë shkollës së ndërmjetme (middle school). Vetë Koch sheh një lidhje të mundshme zanafillëse midis këtij objekti, që mund të ketë qenë në Berat prej periudhës së krishterimit të hershëm, dhe kodeksit të kushtueshëm të purpurt, ndoshta një kushtim i perandorit Justinian për Antipatrean (Antipatrai-n"). Përfundimi i Koch se të gjitha këto gjetje së bashku na bëjnë të mendojmë për shkëlqimin e Pulheriopolis-Antipatreia-s në antikitetin e vonë dhe në periudhën e hershme bizantine, ndihmon shumë për të kuptuar historinë e Shkrimeve të Shenjta të hapësirës shqiptare.

Në fundin e mijëvjetëshit të parë, kur qyteti i Ohrit, deri në vitin 1767 me status patrikane (e kryesuar ndër të tjera edhe nga klerikë arbëreshë), u shfaq si kryeqendër e krishterimit slavonik (pravosllav), Berati ishte në lulëzim. Në studimet e fundme pranohet se Ohri e mori ndriçimin jo nga Beligradi sllav, por nga Beligradi shqiptar, Berati. Kjo tashmë pranohet dhe nga disa studiues të mundësisë tjetër. Njëri prej tyre, Trendafil Krstanov, njohës ngulmues i burimeve arkivore të Selisë së Shenjtë, në studimin *Vatican Sources on Velegrad-Belgrad-Berat: Clement of Velitza Episcopacy from 906 to 916* (p. 124-125), shkruan: *Shën Cirili, Shën Metodi dhe dishepujt e parë, Klementi, Naumi, Sava, Gorazd dhe Angelarius, janë njohur si "7 mësuesit e shenjtë të Bullgarisë", ose "drita e Bullgarisë dhe Dalmacisë". Duke punuar në Bibliotekën e Vatikanit, unë munda të mbledh një koleksion me mbi 200 dorëshkrime greqisht. Në të njëjtën përmbledhje në bibliotekën e dorëshkrimeve greke të Vatikanit, unë gjeta një tekst të panjohur sllav. Në përpjekje për të ekzaminuar këto dorëshkrime dhe*

për të realizuar interpretimet e tyre, në shënimet e mia nga Vatikanit zbulova disa të dhëna me ndikim ndër ne për Velegradin - Beligradin tjetër ose Beratin shqiptar (Eshtë fjala për tekstin që pason i kronikën e Astarhi Stavraki-it, në *Greek Vatican Cod. 2492*): *Bishopric of Velograd or Velegrad (Berat) ana Canina, Northern Epirus. A town in Albania, the present day Berat. The Bishopric originally belonged to the Drach Metropolis, known as Pulheriopolis, subsequently the Velegrad Metropolis, under the Ohrid Archbishop's see and from 1767 under the Patriarchate of Constantinople, with a Metropolitan title: Υπερμπος εντιμότατος και έξαρχος πάσης Αλβανίας - Most Honest and Exarch of all Albania*).



Go Moruo - kryetar i CASS në kohën e restaurimit


III.
Deri në mesin e shekullit të 6-të pas Krishtit kultura e Beratit dëshmohej në gjetjet arkeologjike dhe në burimet e autorëve antikë grekë e romakë. Prej shekullit të 6-të fillon periudha e dokumentuar e saj. Kësaj kohe i takon i mirënjohuri *Kodiku i Purpurt i Beratit*, një prej versioneve më të vjetra të letërsisë ungjillore në shkallë botërore shkruar në pergamenën më të shtrenjtë e më luksoze të krishterimit të hershëm, e njohur fillimisht si *purpurea imperialis* e më pas si *purpurea divina*; fund e krye në ar e argjend (gjithë *nomina sacra* shkruar në ar, duke nisur nga shkurtesat për emrin *Krisht* e *Zot* dhe për *shenjen e kryqit*). Ky dorëshkrim përmban Ungjillin sipas Mateut dhe sipas Markut. Mendohet se

është shkruar me dorën e vetë *Shën Gjon Gojartit* (Joan Chrysostomos / Ιωάννης ο Χρυσόστομος), siç shkruan Pierre Batiffol.

Deri në mesin e shekullit të kaluar *Kodiku i Purpurt i Beratit* është përdorur si libër liturgjie një herë në vit, pikërisht në ditën e shenjtorit që besohet të jetë autor i tij, më 27 janar. Në këtë ditë ungjilli nxirrej para besimtarëve për t'u dhënë bekim. Në kohën kur u shkrua ky kodik, ungjijtë ende nuk ishin njësuar e kanonizuar tërësisht. Aleks Buda shkroi një gjysmë shekulli më parë se në përmbajtjen e këtij kodiku ka shenja të asaj epoke kur mendimi njerëzor i njihte ende vetes njëfarë kompetence mbi *Shkrimet e Shenjta* (periudhës para kanonizimit të ungjijve).

Kodiku i Purpurt i Beratit ka rëndësi për historinë e zhvillimit të mendimit të krishterë në shkallë botërore. *Shkronjat e kllapuar* që janë përdorur (*oncial, uncial*) dhe lëkura e kuqe që prodhohej në qytetin antik të Pergam (Azi e Vogel) shprehin madhësi, sakralitet dhe vlera të shenjta. Në ekspozitën *Ungjijtë e Popujve*, që u hap më 2000 në Vatikan, veç *Kodikut të Purpurt të Beratit*, kishte vetëm dy kodikë të tjerë të purpurt: *Sinopensis O* (që e mori emrin nga qyteti antik *Synope*) i bibliotekës kombëtare të Parisit dhe *Rossanensis* i bibliotekës së dioqezës së Rossano-s në Itali. Midis dorëshkrimeve kishtarë që ruheshin në bibliotekën e kishës së Shën Gjergjit në kohën kur u vizitua nga Pierre Battifol gjendeshin vlera që nuk ruhen më në botë. Deri në mesin e shekullit të 19-të në këtë bibliotekë ruhej edhe dorëshkrimi origjinal i *Liturgjisë së Shën Gjon Gojartit*, një kodik tjetër i shekullit të 4-t dhe një kodik i ruajtur në Gjirokastër i shekullit të parë, që nuk gjenden më në biblioteka kishtarë e laike. *Shkrimet e Shenjta beratini* krijuan një traditë të njohur në shkallë europiane.

Në gjysmëshekullin e fundmë për




Vepra të zgjedhura të dr. Wang Zhongshu - ishte drejtor i Institutit të Arkeologjisë në Pekin kur u restaurua CPB



Disa nga arkivistët shqiptarë e kinezë që morën pjesë në grupin e shëruesve



Aleks Buda me një grup restauratorësh të kodikëve



Shkrimi origjinal në CPB



Fragment nga një fletë e restauruar e CPB



Fletë kodiku të mbyllura hermetikisht në qelq organik

Kodikun e Purpurt të Beratit kanë dalë të reja për të vërteta të përjashtuara përgjatë gjithë traditës së mëhershme të studimeve.

Procesi i shërimit të *Kodikut të Purpurt të Beratit* dhe të *Kodikut të Artë të Anthimit* u realizua nën përgjegjësinë e drejtpërdrejtë të Aleks Budës, kryetar historik i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, dhe ish-kryetarit të Akademisë së Shkencave Shoqërore të Kinës (CASS) Go Moruo. Çfarë zbuloi ky proces, përveçse shpëtoi dorëshkrimet, ende nuk është studiuar. Në vitin 2005, ku Asambleja e Përgjithshme e UNESCO-s, e mbledhur për rastësi në Pekin, vendosi regjistrimin e dy kodikëve në programin e *Kujtesës së Botës*, lindi një interesim fillestar për teknologjinë aq shumë të vlerësuar dhe më pas edhe për mundësitë e krijuara nga restaurimi për të bërë të dukshme të padukshmen, pa folur për leximet e mundshme të tekstit përmes inteligjencës artificiale dhe lehtësimit të një transliterimi tjetër pas afro një shekulli e gjysmë që nga tejshkrimi i belgut Pierre Battifol, tashmë mjaft i diskutueshëm. Disa përfundime, të konsideruara historikisht si të mbyllura, u vunë në dyshim dhe pikëpyetjet po shtohen.

Ishte pohuar ngulmësisht që nga shkrimi i parë e për më shumë se një shekull se në *Kodikun e Purpurt të Beratit* nuk kishte asnjë shenjë të alfabetit muzikor (*neuma*, νεύμα), ndoshta duke pasur në mendje faktin që kodifikimi muzikologjik i liturgjisë (*Antifonari*, Αντιφωνάριον) u krye gati tre shekuj më vonë, nën autoritetin e Papa Gregorit. Por, në një studim të S. Shupos, u dëshmuua se, së paku në dy fletë (fl. 44 dhe f. 156), ka qartësisht shenja drejtuese të frazës muzikore, jo rastësisht në një prej vargjeve më të kanonizuara të ungjijve: *Krishti u ngjall së vdekurish / me vdekjen vdekjen mundi* (S. Shupo, *Gjurmët më të lashta të shkrimit muzikor bizantin në Shqipëri: neumat ekfonetike në Codex Purpureus Beratinus*, Tiranë 2008), pa veçuar fletët e tjera me shkrim muzikor të mbivendosur në kohë të mëvonshme dhe me ngjyra e ngjyruara të zakonshëm (jo argjend e ar).

Me të njëjtën këmbëngulje është pohuar se në këtë dorëshkrim ka vetëm shkrim të pandërprerë (*scriptio continua*) dhe fjalët nuk ndahen nga njëra-tjetra. Por, përmes zmadhimit të mundësuar prej teknologjisë së numerizimit, është vërejtur se së paku në një rast gjendet një shenjë e pavërejtshme me sy të lirë, e ngjashme me asteriksin, që, me sa duket jo për rastësi, gjendet rregullisht në kufijtë ndarës të fjalëve.

Albanologia kineze Ke Jing dhe studiuesja tjetër e katedrës së shqipes në Pekin dr. Ma Sai kanë hedhur disa hapa të tjerë kërkimorë, që me sa duket do të

provojnë se shërimi nuk qe aspak vetëm çështje teknike. Ditari i mbajtur nga arkivistët shqiptarë, i botuar prej nesh në vitin 2003, është përkthyer e botuar tashmë në anglisht e frëngjisht nga studiues europianë të paleografisë dhe të historisë së *Shkrimeve* (Didier Lafleur, Luc Brogly, *Greek New Testament Manuscripts from Albania*, Brill 2018) Ndërsa ditari i mbajtur nga arkivistët kinezë vetëm sa është shfletuar. Para së gjithash merr rëndësi *procesverbali për pritjen e arkivistëve shqiptarë për restaurimin e dy librave antikë shqiptarë* (接待阿尔巴尼亚古书修复小组简报) dhe ditarë të tjerë të mbajtur nga ekspertë restauratorë, disa prej të cilëve ishin dijetarët më të formuar për njohjen e restaurimin e veshjeve më të hershme të mendafshëta të perandorëve kinezë, duke nisur nga studiuesi Wang Xu, që kryesoi drejtimin e punës në Institutin e Arkeologjisë të Pekinit (në *A collection of*

Wang Zhongshu's Work, botuar nga CASS, gjenden të dhëna paraprake).


Në arkivat e Pekinit ruhen kopjime (dizenjime) të miniaturave të dy kodikëve nga ky studiues dhe shenjime pas këshillimeve me historianë të kanonizimit të *Shkrimeve të Shenjta*. Ndryshe nga sa mendohej, teknologjia e shërimit është bazuar në përforsimin e çdo flete me rrjeta mëndafshi (rrjetëzim i katërfishtë). Numri i mjeshtërive të kombinuara në proces është mbi 40, duke përfshirë uzinën e prodhimit të monedhës kombëtare kineze dhe disa lloje fabrikash të përpunimit të arit e argjendit, mendafshit e lëkurëve; ngjyruarës natyrorë e kimikë. Vetëm ngjitesit janë 16 llojesh. Merr rëndësi të madhe gjithashtu ditari i zëvendësimit të atëhershëm të Institutit të Arkeologjisë Xia Nai, i cili citohet pjesërisht edhe në *Listën e Kryeveprave të Trashëgimisë Botërore*.

Më e rëndësishmja nga të gjitha është se kudo ku dy dorëshkrimeve u është kryer një shërbim, kudo ka një gjurmë njoftuese, pjesën më të madhe të të cilave nuk e dimë. Në aq dëshmi sa janë publikuar, falë kujdesit të dy kolegeve kineze, të cilat kanë organizuar së fundmi dhe një takim në katedrën e shqipes me kërkues që trashëgojnë dokumente dhe burime nga puna e drejtpërdrejtë për shërimin e dy dorëshkrimeve, për të inkurajuar studimet njohëse mbi historinë e jetës së kodikëve në Kinë.

Kodiku i Purpurt i Beratit është ekspozuar për herë të parë në jubileun e 2400-vjetorit të qytetit të Beratit, në kushte të forta sigurie, pas dhënies së lejes me shkrim nga kryesia kolektive e shtetit – Presidiumi i Kuvendit Popullor (1989). Ai është ekspozuar edhe një herë tjetër, pa bujë, në festimin e 50-vjetorit të themelimit të shërbimit arkivor kombëtar, më 1999, në mjediset e Muzeut Historik Kombëtar. Në vitin 2000, me vendim të posaçëm të Këshillit të Ministrave, një vëllim prej 20 fletësh i *Kodikut të Purpurt të Beratit* u paraqit në ekspozitën më të madhe ndërkombëtare kushtuar 2000-vjetorit të krishterimit *Ungjijtë e Popujve* organizuar nga Biblioteka Apostolike e Vatikanit. *Beratinus-1* u rishfaq edhe një herë po me atë rast jubilar përpara një publiku të zgjedhur vendës e diplomatëve të huaj, në Pallatin e Brigadave, në ekspozitën *Kodikët e Shqipërisë - përmendore të historisë së mendimit njerëzor*, që u zhvillua më 2002 nën kujdestarinë e akad. Rexhep Meidanit, në atë kohë President i Republikës. Më pas kodiku është ekspozuar edhe në Sofje dhe në një rast tjetër brenda vendit.

IV.

Berati është qyteti i mjeshtërisë së artit kishtar. Në Mesjetën e hershme kishte gjashtë shkolla piktore dhe bukurshkrimi. Sipas studiueses së artit mesjetar Dhorka Dhamo, mund të flitet për një varg ikonash dhe miniaturash të shekullit të 14-të - 15-të, të riprodhuara me dorë në skriptoret /shkollat, mjeshttrat/ e Beratit, në manastirin e Ungjillizimit (Dh. Dhamo, *Të dhëna për datimin e afreskeve në Berat*, në *Monumentet*, 1990/2, f. 52). Në Berat gjenden kryevepra të piktorit të shquar të afreskeve të stilit bizantin, të ndikuar fort nga shkolla e Rilindjes Europiane kreto-venete, Onufrit, kryemjeshtër e *protopapë* me titull (*kryepriift*). Me veprën e tij studiuesit kanë identifikuar terminologjikisht një prej nuancave të ndezura të së kuqes, e ngjashme vetëm me atë të inkonografit rus Andre Rubljov (Viktoria Puzanova: *Piktori shqiptar i shekullit të 16-të Onufri nga Neokastra - Elbasan*, në *Buletini për Shkencat Shoqërore* nr. 3/1953, f. 2-22; *Prapë përmbi*



Kapaku metalik në argjend i CPB në të cilin u ruajt që nga fillimi i shek. XVIII

artin shqiptar të shekullit të 16-të - 17-të, në *Buletini për Shkenca Shqiptare*, nr. 2/1958, f. 152-156; *Disa tipare të pikturës monumentale në Shqipëri gjatë shekujve të 12-të - 15-të*, në *Studime historike*, nr. 2/1967, f. 105-112). Në periudhën arbërore Beratit ishte zotërimi i Muzakajve e kryeqendër e zotërimeve të tyre dhe bënte jetën e një qyteti perëndimor. Në këtë periudhë emri i tij herë-herë konsolidohet në formën *Beogradon*. Sipas Kristo Frashërit, mitropolia e Beratit u fuqizua dhe mori një rol të rëndësishëm rajonal pasi u shua roli i peshkopatave të Bylis-it, Apollonisë, Amantias dhe Kaninës. Madje ai mendon se edhe peshkopata e Vlorës ka pasur një rol të mëhershëm.

Qyteti i Beratit u bë i njohur edhe për traditën e shkrimeve në gjuhët e Orientit: osmanisht, persisht e arabisht. *Sixhilati i sherijes së Beratit* (një formë ndryshe e kodikëve kronografikë, që, sikurse kuptohet nga emri, përmban akte të gjykimet të kadinjve sipas *Sherijatit*) është një prej regjistrave më të rëndësishëm të ngjarjeve, zhvillimeve dhe protagonistëve të historisë së Shqipërisë e të Ballkanit për rreth katër shekuj. Ky regjistër ka më shumë se 220 vëllime dhe përmban të dhëna me karakter enciklopedik për gjithçka ka ndodhur në këtë anë të Botës. *Sixhilati i Beratit* është një burim të dhënash të pazëvendësueshme për popullsinë, pronat, zhvillimin e dhënien e së drejtës, emërimet e lirimit e funksionarëve të administratës, dënimet dhe gradimet, ndëshkimet dhe shpërblimet, gjendjen kulturore dhe fetare, raportet e së drejtës shtetërore me atë etnozакonore, luftërat dhe paqet, kryengritjet dhe nënshtrimet, ndodhitë e natyrës, epidemitë, vitet e urisë, vitet e bollëkut, mrekullitë dhe çuditë e botës, të ngjarat e të pangjarat. *Sixhilati i Beratit* ka të dhëna për një hapësirë prej Besarabisë (emri i vjetër i Moldavisë) në Gjibraltar. Shënimi më i hershëm i këtij sixhilati është i vitit 1604 kurse më i vonshmi i vitit 1923. Një studim paraqitës ka botuar rreth vlerave të këtij regjestri Eleni Duka (*Sixhilati i sherijes së Beratit, dëshmi dokumentare-kulturore me vlerë*, në *Monumentet*, 1990/2, f. 103; *Haki Sharofi dhe vepra e tij*, Tiranë 2000, f. 148-151). Karakterit specifik të rendit osman, i njohur si *pax ottomana*, si dhe dallimeve midis otomanizimit të përgjithshëm dhe islamizimit të pjesshëm të shqiptarëve,



Miniatura të kodikëve të Beratit të stilizuara në veshje të sotme



CPB shpallet pjesë e programit të UNESCO-s, "Memoire du Monde"

si dhe staturave të ndryshme të kishës lindore dhe asaj romane në kuadër të këtij rendi e të protokollit shtetëror perandorak u patëm kushtuar gati dy dekada më parë një artikull të bazuar në dorëshkrimet orientale (botuar në revistën *Perla*, 2008/4, f. 132 e vijim.), si dhe në studimin e mëhershëm *Berat (Belgrat) shëri sher'yye*

sicil defteri (mahkeme kayit defteri) - Arnavutluk ve doğu bölgeleri hakkında ansiklopedik bir hazine (Gazi Üniversitesi, Ankara 2005).

Në Berat ka ekzistuar një shkollë dijetarësh të shquar orientalistë, si Vehxhi Buhara, Andrea Saatëçiu, Ferid Vokopola dhe jo pak të tjerë.

Berati lulëzoi si qendër kulture edhe në periudhën e asaj që për analogji me një zhvillim të ngjashëm në pikëpamje të alfabetit me një degëzim të letërsisë hispanike të shek. 8-të e vijim është quajtur *alhamiada-s* shqiptare, letërsisë e shkruar me alfabet rrokjesor. Bejtet e Nazimit të Frakullës dhe rivaliteti i tij me myftiun e vendit mulla Aliun bënë që qyteti të ndahej në dy pjesë dhe të hynte në ethet e garës. Shqetësimi u përcoll deri në qendër të ish-perandorisë osmane, prej nga bartësi i privilegjeve të *khalif-it* në Kostandinopojë i shkroi administratës vendëse këtë letër:


I ndershmi zoti gjykatës i Beligradit shqiptar. Mbas selamit, ju bëjmë të ditur se myftiu i Beligradit shqiptar Aliu është hequr nga detyra e fetvasë, meqenëse jemi lajmëruar që me sjelljet e tij të këqija është përzier në disa çështje, duke shkaktuar anarkinë e qytetit. Duhet ta porositni, në mënyrë të përsëritur, që prej ditës së sotme të rrijë në punë të vet e të mos përzihet më në çështje të fetvasë. Vesselam (Haki Sharofi dhe vepra e tij, Tiranë 2000, f. 149).

Siç dëshmoi orientalisti Vehxhi Buhara në historikun e mëhallës Çelepias të Beratit, qyteti kishte aq shumë tolerancë dhe mikpritje të artit, sa, në fillim të shekullit të 18-të, një lahtar nga Shkodra, që ishte larguar nga vendlindja e tij për shkak se nuk çmohej, madje përqeshej prej të vetëve, erdhi në këtë qytet dhe fitoi shumë shpejt admirues nëpër çajtoret ku këndonte si rapsod.


Fryma shembullore e bashkëjetesës, që shprehet edhe në faktin e fqinjësisë së shëndetshme të *Kodikut të Purpurt të Beratit* me *Sixhilatin e sherijes së Beratit*, dy kryevlera të trashëgimisë arkivore - secila në llojin e vet - përbën një përvojë historike me vlera bashkëkohore, çështje që e patëm trajtuar më herët në artikullin *Šta kažu albanski izvori*, botuar si hyrje në katalogun *Crna Gora u arhivskim dokumentima Albanije* (Tiranë-Cetinje, 2001, f. 3-10).

Berati është vendlindja e një prej familjeve më të fuqishme të ish-perandorisë osmane, Kūprilū. Vetë dhe me të tjerë ata reformuan dhe shpëtuan perandorinë nga rrënimi ekonomik dhe politik, duke ndarë pushtetin ekzekutiv (veziratin) prej pushtetit ligjvënës (sulltanatit). Dinastia Kūprilū sundoi për afro 70 vjet. Në Berat gjeti strehë ushtria kryengritëse e Sabbetha Zevi pas vitit pas dështimit të qëllimit shtetformues në vitin 1666. Hebrejntë sabbatazevistë që u vendosën në Berat formuan një sekt të ndërmjetëm, hebraik dhe islamik (bektashian) që njihej me emrin *dönme* (të *kthyerit*, të *konvertuarit*) dhe *maranos* (μαράνοσ). Mendohet se në Bilçë të Beratit gjendet një prej varreve të shumtë cenotafikë të Sabbetha Zevit. Deri vonë qyteti kishte një lagje hebrejsh rezidentë, që njihej me emrin *Mëhalla e çifutëve - Jahudi mehalasi* dhe sot ka një rrugë të pagëzuar me emrin e hebrejve. Gjatë Luftës së Dytë Botërore, në prill të vitit 1942 e më pas, në Berat u strehuan 94 familje hebrejsh dhe 87 individë të ardhur njëherësh (në grup) nga Kosova. Asnjë hebre i ardhur nuk iu dorëzua kundërshtarit. Të qeverisurit dhe qeverisësit, populli dhe bashkëpunuesit, mbajtën ndaj tyre të njëjtin qendrim mbrojtës.

Qyteti i Beratit është një kryeqendër kulturore rajonale, me rëndësi për historinë e Shqipërisë dhe të popujve fqinjë, Greqisë, Bullgarisë, Turqisë osmane etj. Për trashëgiminë e çmuar origjinale, materiale e shpirtërore që ruan, prej vitit 2008 Beratit është shpallur qytet i listës së qyteteve nën kujdesin e UNESCO-s.



Një fletë me neuma muzikore në CPB



Një fletë nga kodiku i artë i Anthimit

Edhe pse “është e vjetër mosmarrëveshja midis filozofisë dhe poezisë” (Platoni), shtegu që të krijon mundësinë e re të mendimit mund të gjendet edhe në fjalët e poetit e filozofit francez Paul Valéry, i cili ndër të tjera shprehet se: “Disa vepra krijohen nga publiku i tyre. Disa të tjera krijojnë publikun e vet. Të parat iu përgjigjen nevojave të ndjeshmërisë natyrore mesatare. Të dytat krijojnë nevoja artificiale që në të njëjtën kohë i përbushin.” Poezia është formuar e tillë, për të rilindur nga vdekja e saj dhe për të qëndruar pafundësisht ajo që është. Nisur nga sa më sipër, edhe tërësia poetike e vëllimit “Njeriu buzë lumit”, pra kjo poezi, formëson një lloj uniteti, një lloj harmonie midis njeriut të gjallë, botës së gjallë dhe njeriut të vdekur, botës së vdekur. Pra, përbush ato nevoja që i krijon si veten, për veten.

Nga një sy praktik i hedhur mbi vëllimin në fjalë, shquan se brenda tij jetojnë gjashtë libërtha të cilën konturojnë vetveten dhe njëkohësisht rrojnë në një përbashkësi sa të çuditshme aq edhe me arsye. “Lumi i brinjës”, “Yll në pezhishkë”, “Teh drite”, “Gjuetia e deleve të zeza”, “Goja epushore e agut”, “Kredo e re” janë eshtrat që formatojnë shtatin e radhës poetik të poetit e prozatorit Agron Tufa.

Gjithnjë e kam parë letërsinë si një formë e përsiatjes për vetë vdekjen. Shkrimtarin dhe poetin si një rrëfimtari të vdekjes; vdekja si një nevojë për rrëfim, si gjendje apo si periudë e nevojshme për t’u çliruar nga e pathëna. Edhe në krijimet e vëllimit në fjalë, vdekja zë një hapësirë të konsiderueshme edhe si subjekt, edhe si ornament ndihmës i poetit. Në poezinë “Matanjetë”, autori sendërton marrëdhënien ndërmjet njeriut (që njëkohësisht është edhe një tjetër shtyllë e vëllimit në fjalë) dhe vdekjes, pas aktit. “...mbas kalimit në Matanjetë,/ pata një përballje të ashpër me realitetin/ e premtimeve të papërbushuna.” dhe gjithashtu “...me e la vedin/ e me kthye me vdekë/ siç vdiset.” Ndoshta sipas një ligjësie të paracaktuar, të vdekurit nuk mundën të kthehen në jetë por autori kujdeset të gjejë lidhjen e munguar të njeriut me vetë fatin e tij. “Matanjetë” të ngjan si plotfuqi e materies mbi shpirtërore, e vdekjes mbi jetën. Kësisoj, kjo përballje është një moment i nevojshëm, i pashmangshëm, për sa kohë duhet të vijojë evolucioni. “Tan jetën e lume njeriu dashka me u përpjekë/ me pasë një deké krejt për vedin.” por për çarsye mund të lindë kjo kërkesë? Autori paraqet shpjegimin në vargjet më tej por a është kjo kërkesë edhe një formë e përjetësisë, ku vetë qenia kërkon të veprojë në të dhe sikurse citohet në vargjet: “Mbetet, po thonë, dhe një mundsi e prapë:/ me u ngritë lugat” Me kapërcye/ edhe një herë ndatë jetë./ me ua shti lëngjyrën bjerrakohsave,/ me i ç’mësue prej dobsive t’ mia,/ me e la vedin/ e me kthye me vdekë/ siç vdiset.”

Poezia “Kredo e re” shënjohe si misioni i gjithëkahershëm i Poetit. Pikërisht atë të cilin Quasimodo e quante “punëtorin e ëndrrave”, vetë poeti, poetin e ngarkon me një barrë të rëndë të cilën e jetëzon në sa vijon: “E çdreq poeti na qenke/ kur s’je në gjendje/ ungjillin tând ta shkruesh/ me vëna të hapura mbi letër/ dhe burrinë e fundit ta qesësh/ në bedenat e së pamundunës?” Asnjëherë nuk do të kishte pasur poetë nëse nuk do të kishte probleme që duhet të zgjidhen. Në shembullin në fjalë, poezia shtrihet në krejt qenien dhe kërkon të stimulojë çdo organ të qenies të arrijë pikërisht atë që kërkon poezia, atë unitet që përmendet në krye të këtij shkrimi.

Poezia “Elegji e pamundur” shënjohe si misioni i gjithëkahershëm i Njeriut. Përmes një loje brenda të njëjtëve dhe brenda të ndryshmëve, autori rreket të shtrojë dhe të zgjidhë dilemën e rradhës. Duke hedhur sytë nga trilli: “Duhet trilluar, ormisur i tillë truk i rrallë./ sa mes të gjallësh të ndihesh i gjallë.”

Refleksione mbi vëllimin “Njeriu buzë lumit”, Agron Tufa, Onufri 2024

“KA DIÇ QË (S)TË BIND” NË POEZINË E AGRON TUFËS

Nga Rei F. Hodo

njëkohësisht hedh sytë nga shmangia: “Ah, njësoj betej të rëndën të dyja palët!/ S’gjen prehtë tek të vdekurit, s’gjen prehtë tek të gjallët!” Poeti shpreson, ndonëse përmes dhimbjes ai sërish mundohet që “në Matanjetë prapë do ëndërojme./ sikur sapo zgjohe mi, sikur dëshirojmë/ një Fillim të ri, një rikthim të dytë/ që ta rrisim veten njësh me utopitë.”

Poezia “Njeriu buzë lumit” shënjohe si misioni i gjithëkahershëm i Unit në raport me kohën. Të ngjan si një marrëdhënie e pandërprerë midis shpirtit, vuajtjes apo të vërtetës. “Asht një garë shkatërruese/ me u përballë çdo grimëkohë me rrjedhën./ me imazhet mendore “me rrjedhë a me qenë”./ që lumi pavetëdijshëm t’i shuen si gurë gëlqerorë/ tinëzish ndër zgavra.” Shpirti i njeriut padyshim që gazohet nga veprimi i tij, duke e pranuar si të vërtetë. Kësisoj, duke e pranuar këtë të vërtetë, ai çlirohet nga makthi i kohës por njëkohësisht edhe nga dhimbja. Këtë mund ta hasim në vargjet si vijojnë: “Njeriu buzë lumit/ e mbledh rrjedhën vorbull/ ndër vedi./ bahet turbinë/ e shpërthen në dritë.” Por ndërkaq, nga ana tjetër, në fundin e poezisë, autori na lë të kuptojmë se ai që e mund vuajtjen, le ta bekojë atë ngase është ajo që mund të

dërgojë tek hyjnia: “Por ti, së paku, mundesh me mbetë/ veç një gjurmë drite, deri në fikje./ në rrjedhën e pamort.”


I njëjti mision vërehet edhe tek poezia “Ose jeta është e shkurtër, ose zgjimi është i vonë”. Mund të themi se nga poezia në fjalë kuptoj që do të duhet qoftë edhe vetëm një element guximi ose për ta kërkuar të vërtetën ose për ta ndërtuar atë. Pikërisht këtë të fundit, autori e paraqet në vargjet si vijojnë: “Kësaj jete i ngjitesh në majë veç me pak gjëra, në këmbë./ ashtu si alpinisti: një çantë, litar dhe kthetra dëbore.../ Shkarkojeni veten – këtë anije tonazhi të rëndë/ dhe flakini ëndrrat e mëdha në rrjedhën pluskore –/ pa grimë keqardhjeje! Nuk përbushen kurrë!/ Lumi i fryrë i brinjës i merr të tëra me vete,/ si trarët e mëdhenj. Të krimbur e të kalbur./ kur shembet me rropamë një urë. / Kjo jetë do peshë të lehta dhe lyp shëndet atletik;/ utopitë janë krusma ndër hekatomba flijimi./ Që nën vete mos t’ju gorrormisin ëndrrat e mëdha –/ ruajeni njërin brinjë prej lumi si valvul shkarkimi.” E ndërsa mundohesh, arrin të kuptosh se vetëm nëpërmjet humbjeve mund të shkosh tek fitorja; kjo fitore është e vërteta njerëzore, e vërteta e çdo vlere.



Në poezinë “Bëhu hiç e bjer në fashë”, autori përpiqet të pohojë atë ç’ka është njerëzore e tij si më të mirë. Ai nuk mund ta pajtojë atë me njerëzoret e tjera, në të kundërt do të kishte zbritur në një nivel më të ulët, thuasht shtazor. Nëpërmjet vargjeve si vijojnë: “Lidh një besë, bëj një pakt: tragjedia vjen vërdallë. / Dil nga loja, mos aktro – ferrit bjeri pashë më pashë:/ pa përvojë, pa dëshmi – bëhu hiç e bjer në fashë!”, autori në mëson se sa më shumë që jeta brenda shpirtit feston, aq më e pasur bëhet të qenit njerëzor.

Në përfundim, do thoja se të shkruarit e një vëllimi të tillë, ashtu si vetë procesi i të shkruarit, mbetet vëzhgim i vetes dhe i botës, vëzhgim i qenies njerëzore të parë si të veçuar dhe si pjesë të kolektives. Autori arrin të shpalosë të gjitha funksionet e poezisë dhe nëpërmjet tyre kërkon një pjesëmarrje gjithëpërfshirëse. Në të gjithë vëllimin mund të gjejmë mundim të pafundmë, grindje, sprovë, enigmë, shqetësim apo edhe pasiguri.

I gjithë mendimi i autorit është i fshehur në vargje, e ky mendim është i njëjtë me cilësinë e një fruti për të na ushqyer. “Njeriu buzë lumit” është një ftesë e hapur për leximin e poezisë cilësore.



Fotografia © Rromir Imami

Tek lexoja romanin “Lakimi” të Durim Taçit, që sapo ka dalë në treg, në fillim pata një si pendesë, se mos po e çoja kohën dëm. Por shumë shpejt u binda për të kundërtën. Nuk thonë kot “Një vepër e “paragykuar” është si një mineral i pazbulur”. Romani nuk është shkruar për një lexues të zakonshëm, pasi lind problemi i kuptimit të thellë, jo të menjëhershëm të tekstit, përndryshe mund të mos kuptohet ky tekst. Vitet e fundit shkrimtari i njohur Durim Taçi po zhvillon një gamë mbresëlënëse zotësish stilistikore. Në romanin “Lakimi”, Taçi, si një okultist, merret me njeriun brendësor, që duhet të forcohet e lirohet nga dominimi i trupit fizik dhe gjërave që e rrethojnë atë, të cilat duhet të bëhen shërbëtorët e tij.

Romani është një interpretim poetik i kohës së para 5000 viteve, njëkohësisht një projektim i defekteve të shoqërisë së sotme, kompleksitetit dhe misteriozitetit të kohëve moderne. “Sjellja më e dënueshme për një burrë ishte të kërkonte një lidhje të përhershme me një grua”, thuhet diku gjatë rrëfimit. Në këtë vepër shpalosen tema të rëndësishme të kohës, duke ndriçuar rrugëtimin e gruas, si dhe betejat e saj të përjetshme, gjatë gjithë kalvarit të historisë. Me një strukturë të veçantë dhe një përmbajtje të pasur, libri bën një reflektim të thellë mbi feminizmin dhe pozicionin e gruas në shoqërinë moderne. Askush nuk di të notojë derisa të futet në ujë thellë. Ligjet e natyrës nuk mund të harkohen sipas qëllimeve të lakuara ose të përdredhura. Në këtë roman krijohen disa lloj raportesh: simetri - asimetri, rregullsi - çrregullsi, mendësi - pamendësi, ndërtim - shkatërrim, etj.

Romani “Lakimi” vjen si një reflektim i thellë mbi feminizmin, gdhendjen e imazhit të gruas përmes historive të librit, kundërvënien e shkrimit me shkrim, lakimin jo të emrave, por të historisë, eksperimentimin e teknikave që burojnë nga teoritë më të fundit të raportimit të autorit me lexuesin.

Trajtimi i tematikës bashkëkohore të ndrydhjes së gruas në histori, përmes dijes e, specifikisht, shkrimit, me ngjarje që zënë fill në Shqipërinë moderne, shtrihen në Itali e zgjerohen në një vijimësi diakronike në 5000 vjet qytetërim, duke iu referuar disa pikave kyçe në historinë e njerëzimit.

“Lakimi” është një roman i përqëndruar i tëri në një dramë turbulluese të brendshme: E ndjekur dhe e kërcënuar nga burri, Elira, arkeologe nga Tirana, nisat në një kongres për artin e gdhendjes në shkëmb në Valkamonika (Itali), ftuar nga Robertoja, një artist me të cilin beson se ka nisur një marrëdhënie të re. Ajo mendon se shpikja e shkrimit përkon me daljen e gruas nga skena dhe e shmang atë duke dërguar vetëm mesazhe me zë. Megjithatë, janë tekstet që merr në formë mesazhesh që ritmojnë ditët e saj teksa takimi i prituri i dashurisë vonon.

Arbeni, burri i saj, bën gjithçka për të penguar lidhjen mes Elirës dhe Robertos, po kur tek ai nuk sheh një dashnor të zjarrtë, por një tip që jeton çastin, mendon ta përdorë për të goditur të shoqen pikërisht me atë që ajo urren: shkrimin. Ndërsa zbulon historitë, që i dërgon Roberto, Elira, i dërgon me mesazh vetëm dy fjalë: Emërore: serpens. Rrëfimtari nuhat që po i kërkohet një lloj lakimi i ngjarjeve, i cili nuk do të vonojë të vijë. Ajo lexon me qejf pesë ngjarjet e ekspozuara në pesë rase të lakimit, ku thyerja e rrëfimit linear i dhuron një lexim që bën bashkë shtatë ditë të së tashmes me pesë mijë vjet njerëzim.

Autori duket si i distancuar nga letërsia shqipe e traditës dhe ajo bashkëkohore që shkruhet sot. Ka përqafuar “metamodernizmin”, janë shprehur

Dimensioni sintaksor dhe semantik në romanin “Lakimi” të Durim Taçit

Nga Arben Iliazi

disa komentues të këtij romani, por në mendoj se teksti i Taçit është shumë kompleks dhe shumështrësor, përndryshe një fiksjon metaletrar, metamatik dhe palimpsestoid. Duke realizuar një trillim vetë-ndërgjegjës, shkrimtari ka përdorur metafiksionin, i cili nënkupton një stil të prozës tregimtare, ku vëmendja i drejtohet procesit të krijimtarisë trilluese. Fiksioni dhe mekanizmat e tij bëhen transparentë, ndërsa mekanizmat fiksjonale të brendshme dhe ato të jashtme injorohen tërësisht.

Metafiksioni ndodh në historitë trilluese kur historia analizon elementet e vetë trillimit. Në përgjithësi, metafiksioni te ky shkrimtar është një trillim vetë-ndërgjegjës. Autori e lë fiksjonin e përgjithshëm të rrjedhë në shumë rrafsh dhe duke tematizuar vetë fiksjonin. Pikësepari autori në këtë roman ka krijuar një metagjuhë, termat e së cilës janë univokë dhe të ndërpercaktuar. Në përgjithësi programet narrative të metafiksionit janë të shumëfishta dhe kanë një marrëdhënie hierarkike brenda tyre.

Kësaj vepra mbart fund e krye një koherencë logjike.

Modeli narrativ i Taçit është përpunuar gjerësisht vitet e fundit. Në këtë roman ai ka arritur një skemë narrative kanonike, ku veprimi i subjektit shndërron stadet e gjërave. Reflektimet e autorit zhvillohen gjithnjë e më qartë, dhe nuk duhet marrë në konsideratë niveli i thellë i abstraktit, por të gjitha nivelet, sepse kuptimi tërësor i tekstit lind vetëm nga përcaktimi reciprok i këtyre niveleve. Në vepër ka ndodhur një integrim mes dimensionit sintaksor dhe dimensionit semantik. Kemi të bëjmë me një simiotikë të situatave, ku konteksti pragmatik përshkruhet me të njëjtat mjete të semiotikës narrative e diskursive. Valenca e vlerave hyn në lojë kur merren vendimet për vlerën e vlerave, pra athere kur gjykohet jo vetëm nëse vlen dicka, por se cila është vlera e vlerës së tij.


Përmasa pragmatike ndërkallet tërësisht në brendësi të përmasës njohëse, përbrenda dukurive të njohjes, ndërtimit, manipulimit të vetes dhe të lexuesit. Semiotika strukturale rreket të trajtojë në mënyrë homogjene diskurset – objekt dhe kontekstet e tyre, duke përpunuar kështu një simiotikë të situatave, që është pjesë përbërëse e semiotikës më të gjerë të veprimit. “Meritën që ia dalim të kënaqemi kaq gjatë brenda njeri-tjetrit, duhet t’ia



njohim, mbase, atij dialogu të heshtur vështrimesh. Siç duket, e kemi kuptuar se dashuria, – ky udhëtim vetmitar në dy, – fillon dhe mbaron tek sytë, si leximi”.

Në këtë këndvështrim, ky roman është një bashkësi tekstesh ku vihen përballë hapësira të panumërta tekstore, qofshin edhe shumë larg njëra-tjetrës. Marrëdhëniet mes pjesëve në trësinë komplekse, janë gati organike.

Durim Taçi ka studiuar filologji e kinematografi në Tiranë dhe filozofi në Milano. Autor dygjuhësh, Taçi është edhe përkthyes i shumë titujve në shqip. Me romanin “Codice Kanun” (2016), është nderuar me Çmimin Montefiore. Pason trilogjia e leximit me romanet “Extra Time, vetja jote e dytë” (2019), “Extra Time, la tua seconda persona” (2020), “Një prani në ikje” (2020) “Una presenza che sfugge” (2021). Libri i tij “Liçeni në mes të detit” (2022) është nderuar me Çmimin Fishta 2022. Durim Taçi është fitues i Çmimit Kombëtar të Letërsisë 2021 me përmbledhjen e tregimeve “Nga një derë tjetër” (2021), botuar edhe në italisht, “Da un'altra porta” (2023). Jeton midis Tiranës dhe Bergamos (Itali), ku pat emigruar që në vitin 2000. Nga viti 2024 punon te Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Qendra e Studiumit të Arteve.



Antologjitë poetike nga poetë të një vendi të caktuar të botës, apo ato që përzgjedhin poezi nga vende të ndryshme, kanë qenë gjithmonë interesante për lexuesin, pasi sjellin me vete eksperiencën, këndvështrimet dhe përjetimet të reja. "Midis njeriut dhe zotit" e ka titulluar përkthyesi i saj antologjinë poetike e cila përmban 22 zëra nga poezia hebraike. Një titull që mban mbi supë një simbolikë shumë të thellë dhe duket sikur përkthyesi, nëpërmjet saj "sjell" për lexuesin një hapësirë të ndërmjetme - atë midis njeriut dhe zotit - si një vend ku mund të reflektohet dhe zhvillohet një marrëdhënie e njeriut me hyjnoren, që për të, ka qenë gjithmonë e pakufi.

Antologjia që ka mbërritur tashmë të lexuesit, (një lexuese po shkruan për të), është simbol i një pune plot përkushtim dhe profesionalizëm nga ana e Kafilajt, duke bërë që ndër duar të kemi një thesar, ku secili nga autorët, është një gur i çmuar. Një thesar që do të jetë kujtesë për brezat dhe për të argumentuar këtë pohim na mjafton shënimi i përkthyesit që në krye të herës: "Në kujtim të Rabinit Yisroel Finman (z'1) që aq shumë e deshi Shqipërinë". Shënim që simbolizon vlera të rëndësishme të saj, që shkojnë përtej një përmbledhjeje të thjeshtë letrare, si një nderim që i bëhet një figure të rëndësishme si Rabini Yisroel Finman, nderim dhe vlerësim i popullit të cilit ai i përket, atij hebraik.

Autori i kësaj antologjie, nuk synon të përpilojë një enciklopedi të Poezisë hebraike, siç ai shprehet në shënimin e parathënies, por të japë përmes saj, atë që ai e cilëson si "Esencën" e kësaj poezie. Antologjia është organizuar kronologjikisht dhe autorët e përzgjedhur përfaqësojnë periudha, lëvizje dhe rryma të ndryshme poetike. Shprehja "e para e llojit të vet" që e çel atë, dëshmon risinë dhe rëndësinë e saj, si arritje e një pune kolosale që përmbledh një hark kohor (2014-2024).

Për të 22 poetët, pjesë e kësaj antologjie, autori sjell shënime biografike përmes të cilave, lexuesi merr informacion për periudhën së cilës i përket, edukimin, formimin dhe profesionin e tyre, përveç emëruesit të përbashkët që i bashkon të gjithë: të qenurit poetë. Poezitë e përzgjedhura nga autori, janë ato që më mirë e përfaqësojnë secilin prej poetëve.

Duke iu rikthyer autorit të antologjisë në lidhje me periudhat, lëvizjet, apo rrymat e ndryshme që që përfaqësojnë poetët e saj, citojmë se pavarësisht të lartpërmendurave, *mini manivela që e lëviz këtë kalejdoskop shumëngjyrësh, është padyshim Shpirti hebraik, i cili shpërfaqet në krejt plotërinë e vet.*

Tematikat e trajtuara nga poetët e antologjisë janë nga më të ndryshmet. Përmendim ndër to, besimin në zot dhe lutjen si lidhje e shpirtit njerëzor me të. "Njeriu" simbolizon Qenien që përballon sfidat që jeta i sjell dhe mundohet t'u japë atyre kuptim. "Zoti" përfaqëson hyjninë, idealin absolut të cilit njeriu kërkon t'i afrohet, dhe ATY midis tyre - midis zotit dhe njeriut - është vendi ku shpesh lind poezia dhe arti, si një nga format më të arrira për të shprehur ndjenjat, emocionet, përvojat njerëzore, zhgënjimet dhe dilemat.

Nga Solomon ben Gabirol (1021-1070), vjen "Kantika e agimit", poezi në të cilën përkthyesi sjell me besnikëri temën e poezisë, duke dritësuar thelbin e saj, si një lutje që kthehet gati në një himn për zotin. Pyetjet: "Çfarë mund të bëjnë gjuha apo zemra? E ç'janë shpirti dhe forca në mua?", sjellin qartë forcën e shprehjeve filozofike dhe pyetjet e ruajnë forcën e reflektimit egzistencial të poetit. Gjuha e përkthyesit bën që poezia të vijë ngrohtë te lexuesi duke ruajtur një rrjedhshmëri të pasforuar,

Mbi antologjinë poetike "Midis njeriut dhe zotit", përkthyer nga Melsen Kafilaj

MIDIS NJERIUT DHE ZOTIT, QËNDRON POEZIA

Nga Teuta Dhima

natyrale, siç duhet të jenë vargjet që i përkasin meditimit dhe lutjes.

Njeriu, prej mishi dhe gjaku, dashuron, tundohet, vuan kur dashuria e tij nuk gjen konkretizim. Dashuria, në vargjet e kësaj antologjie vjen kaq ëmbël në vargjet e poezisë "Molla". Nga gati nëntë shekuj më parë ky poet i drejtohet të dashurës: "Gjiri yt pors kjo mollë edhe ngjyrë e saj/ngjyrë që zjarri dikur linte mbi faqet e saj". Simbolika e mollës në kulturën hebraike është shumëdimensionale, ajo është simbol i bukurisë, mirësisë, shëndetit dhe begatisë. Ndaj poeti gjirin e së dashurës së tij e krahason me mollën për të dëshmuar dashurinë dhe tërheqjen ndaj saj. Molla, duke i vënë në dukje, ngjyrën që është e njëjtë me gjurmët që lë zjarri në faqet e saj, bëhet simbol i tërheqjes dhe pasionit, i atij pasioni që nuk e lë të qetë poetin që prej ditës, kur prej të dashurës është ndarë.

Gati gjashtë shekuj më vonë, Baal Shem Tov (1698-1760), shëruesi i famshëm hebre (shënime të përkthyesit), vjen me poezinë "Dy shpirtra". Por kur dy shpirtra, fat-thënë të jenë së bashku, e gjejnë sho-shoqin. Është forca e dashurisë ajo që i bën ata që si një rrjedhë e vetme të çajnë përpara dhe nga bashkimi i tyre, një dritë tejet llamburitëse ngrihet lart. Është drita e shpirtit që dashuria i bashkon.

Adhurimi që njeriu ka ndaj krijuesit të tij nuk sillet në këtë antologji vetëm përmes lutjeve, meditimit, festimit të festave dhe traditave duke iu dhënë atyre vlerësimin e duhur, por ai vjen edhe në mirënjohjen për atë çfarë Ai ka krijuar. Në poezinë "Këngë gruaje" të poetes izraelite Esther Raab (1894-

1981), vargjet e saj kanë ruajtur edhe në shqip një ritëm të brendshëm dhe figuracion të pasur, meritë e padiskutueshme kjo e përkthyesit Kafilaj dhe fjalës së tij të zgjedhur. Vargjet vijnë si një falenderim, mirënjohje dhe si një deklaram i bërë me tërë krenarinë e mundur. Zëri i poetes vjen si në zë modern feminist që e vlerëson indentitetin e gruas, fuqinë, rolin e saj krijues, në familje dhe në shoqëri. "Dhe unë që jam rritur dhe dua të jem ajo vajzë/që vajton prej hidhërimit dhe që buzëqesh e këndon zë-lartë". Vargjet e Ester Raab janë si një ndjesi nostalgjike për t'u kthyer në kohërat e mëparshme. Koha sjell për gjithkënd një ndryshim të pashmangshëm, ndërsa poetja do të mbetet në kohën e emocioneve të thjeshta, ku si gëzimi dhe dhimbja shpreheshin me një lirshmëri, që vetë mosha e bënte të mundur. Vargjet mbartin sinjoretin e një gruaje që dikur ka qenë një vajzë, e një gruaje që kërkon të kthehet në lirinë dhe emocionet aq të çiltra rinore. Por me gjithë pjekuri e saj, ajo përsëri luan nën këmbët e krijuesit të saj, si një vajzë-fëmijë, si një krijese mirënjohëse që thur "Këngë gruaje". Të gjitha dashuritë njerëzore vijnë plot emocion në vargjet e poetëve hebraikë: dashuria për Tokën amë, dashuri për Jeruzalemin, dashuria e pakushte nënë-fëmijë. Të gjitha përvojat njerëzore dhe pohime mbresëlënëse si: "Një burrë në kohën e vet nuk ka kohë që të ketë kohë për gjithçka", sepse ai duhet të dashurojë e të urrejë në të njëjtin çast, dhe të mbledhë gurët që me duart e tij i ka hedhur.

Një teoremë gjeometrie, "Përmes dy pikash kalon veç një drejtëz e vetme" është titulli i një poezie të cilën na e sjell poeti

hebreo-gjerman, Yehuda Amichai (1924-2000), që sipas kritikës, është quajtur si një poet-filozof, i cili arrin madje që edhe eksperiencat e jetës së tij personale t'i kthejë në mesazhe universale për të gjithë. Ky koncept gjeometrik si titull i poezisë, ka marrë një kuptim metaforik dhe simbolik e nëpërmjet tij, poeti dëshiron të përcjellë emocionin e dashurisë dhe lidhjes së dy njerëzve, rrugëtimin e tyre, kufizimin apo lidhjen midis dy qenieve. Ajo çfarë e bën tërheqëse këtë poezi është që thjeshtësia e një koncepti gjeometrik që në vetvete është i prerë dhe i padiskutueshëm, shndërrohet në një simbol të fuqishëm emocional dhe filozofik. E për më tepër simbolika thellohet, kur këto dy pika nuk i referohen dy njerëzve që lidhen, por një planeti dhe një ylli që u martuan. Gjithçka mund të ndodhë në vargun e poezisë, por nëse ndalemi e mendojmë: a mundet të martohet një planet me një yll? Planetët dhe yjet janë larg njëri-tjetrit në univers, dhe ata rrotullohen rreth tyre në distanca të ndryshme, ndaj dashuria e tyre dhe lidhja në martesë, bëhet simbol i një dashurie të pamundur.

Vargu, "nganjëherë "Ne" është njëjës e herë të tjera shumë/ Ajme, ndonjëherë nuk e di më se çfarë është, përmban brenda vetes çelësin kuptimor të kësaj poezie ku në një lidhje dy njerëz, kaq të ndryshëm nga njëri-tjetri, herë do të jenë të vetëm dhe herë do të jenë së bashku, e herë nuk do të dinë më as vetë se çfarë është, kjo lidhje, kjo "drejtëz e vetme" që kalon mes dy pikash.

"Përkthimi nuk është vetëm çështje fjalësh, por duhet bërë e kuptueshme për lexuesin në gjuhën e të cilit po e sjell, një kulturë e tërë", shprehej shkrimtari dhe studiuesi i letërsisë, britaniku Anthony Burgess. Roli i përkthyesit si ndërmjetës kulturor, e vë atë përballë disa sfidave të cilat vetëm kur kalohen me sukses bëjnë që të kemi referenca kulturore të kuptueshme për lexuesin, i cili pasurohet me një kuptim më të thellë të kulturës tjetër. Shumë poezi reflektojnë përvoja kolektive si: besimin, dashurinë, humbjet, duke na ofruar kështu njohje më të thellë për historinë dhe përvojat e përbashkëta të një kombi. Duke i lexuar ato, hap pas hapi, kupton se filozofia e poezisë hebraike është tepër e thellë, e mbushur me kuptime të shumta që shprehin shpirtin, përvojat dhe historinë e një populli në lidhje me njeriun, natyrën dhe Zotin.

Telogu dhe Mendimtarë Abrahama Joshua Heschel (1907-1972), konsiderohet si një prej mendimtarëve dhe figurave religjioze më të shquara të shek. XX. Poezia e tij "Zoti dhe njeriu" është një ndër më domethënëset e kësaj antologjie, pasi marrëdhënia midis njeriut dhe Zotit është një lidhje e mbushur me dashuri, adhurim dhe përlulesi. Zoti shihet si krijues, udhërrëfyes për njeriun që ai vetë e ka krijuar. Ky raport poetik (pasi është titull i një poezie) dhe filozofik për atë çfarë sjell te lexuesi, mbetet universal pasi trajton të gjitha përgjigjet për pyetjet ekzistenciale përgjatë jetës, të cilën vetë zoti ia ka dhuruar njeriut.

Të gjitha çfarë shpreheja më lart, janë ngacmime të cilat m'i shkaktoi leximi i këtyre poezive të përkthyer. Përkthimi i mirë një poezie është një akt i vështirë, shumë e kanë quajtur edhe si një betejë të humbur, por emocionet që përjetova gjatë leximit të tyre, më bëjnë të mendoj se këtë betejë përkthyesi dhe autori i kësaj antologjie e ka të fituar. Në sajë të një pune të palodhur dhjetëvjeçare, përkthyesi Melsen Kafilaj, i ka dhuruar lexuesit shqiptar një antologji e cila përmban poezi të ndjera dhe që sjellin vlera të reja artistike, këndvështrime të ndryshme; një antologji që prek ndjeshmërinë e lexuesit, e fton atë të reflektojë dhe pse jo, e frymëzon. Sepse midis Njeriut (krijuesit) dhe Zotit (krijuesit të tij) ka një vend ku lind poezia dhe arti, si forma më e lartë e shprehjes së eksperiencave njerëzore.



Në Shqipërinë komuniste një roman mund të censurohej jo vetëm për arsye ideologjike apo letrare, por edhe sepse autori mund të bënte kërkime të karakterit onirik e psikologjik, shqetësimet e një gruaje, marrëdhënies me trupin e saj dhe kënaqësive seksuale, veçanërisht të një gruaje që do të mbetet e virgjër deri në fund të jetës. Ky fakt, sa i përket stilit, përbënte risi në panoramën e letërsisë shqiptare, e cila karakterizohej nga realizmi socialist, por sa i përket përmbajtjes, përbënte një tabu. Nuk kishte aspak rëndësi që protagonistja, njëfarë Penelope e nëntëqindës, i kishte qëndruar besnike gjatë tërë jetës një heroi të luftës kundër nazifashizmit, i cili kishte humbur jetën në kampin e Mauthausenit. Romani "Vera pa Kthim" i Besnik Mustafajt, i shkruar në vitin 1985, e pa dritën e botimit vetëm pas katër vjetësh, pasi ishte hequr çereku i tekstit. Por jo për shkakun e ideologjisë apo të tekstit. Autori i mori vesh arsyet e vërteta të censurimit të romanit vetëm në vitin 1991 kur, me rënien e komunizmit, e rimori në dorë përsëri varianti origjinal, me qëllimin për ta botuar tashmë të plotë. Këtë fakt ai e ka treguar vetë në pashënien e romanit që u botua për herë të parë në Itali, përkthyer nga Julian Zhara, për llogari të botimeve Bibliotheka (208 faqe, çmimi 21.00 Euro). Censura të çudit edhe më shumë, nëse marrim parasysh finesën e të shkruarit dhe të introspeksionit psikologjik me të cilin Mustafaj vendoset përballë personazhit të Sanës, protagonistes së romanit, e cila takohet përsëri me Gorin, të fejuarin me të cilin dëshiron më në fund të martohet dhe të provojë dashurinë fizike. Por Gori fillon të sillet në mënyrë të çuditshme. Ai fle në mënyrë të panatyrshme, është i zbehtë, ka frymëmarrje të ftohtë e mbi të gjitha, nuk djersin asnjëherë. Gjithashtu i rri larg marrëdhënies shoqërore, flet pak, sidomos në lidhje me vendin e mistershëm nga ku kishte ardhur dhe është vazhdimisht i zhytur në kujtimet e tij si dhe në leximin e veprave që kanë të bëjnë me luftën. Është aq i zhytur sa flet gjithnjë vetëm për të shkuarën.

Botohet në Itali romani i parë i Besnik Mustafajt, "Vera pa kthim". Shembull i pagjasë i prozës onirike e introspektive. Gjatë viteve '80 teksti u cungua sepse në faqet e tij një grua reflekton në raport me trupin e saj. Kjo gjë ishte kundër kanoneve të regjimit.

NË SHQIPËRINË KOMUNISTE SEKSUALITETI ISHTE NJË TABU QË I NËNSHTROHEJ CENSURËS

Nga Gianni Santamaria

Në fund të fundit, ky i rikthyer (revenant) nëpërmjet veprimeve të tij, shpreh njëfarë nguti. Pra nga njëra anë, pulsionet e asaj, nga ana tjetër misteri i tij. Përreth tyre, figura të rralla shfaqen në skenën e hotelit dhe plazhit ku të dy kalojnë pushimet në Durrës, i cili është pikërisht mjedisi i kësaj marrëdhënie të re që po përpiqet të shkojë drejt së ardhmes. Kur çifti shkon në teatër, ndodh një skenë katartike me tipare shekspiriane, një *mise en abyme*¹ ("e vendosur në humnerë") mes ngjarjes dhe paraqitjes së saj, që të çon drejt një fundi dramatik.

Në roman nuk mungojnë referencat ndaj ateizmit shtetëror si dhe barazisë së rrejtshme mes njerëzve, e cila u pagua me gjak. Por megjithatë narracioni mbetet pezull mes realitetit dhe ëndrrës duke na shfaqur një refleksim i thellë mbi jetën, dashurinë dhe vdekjen. Personazhet karakterizohen për më tepër edhe nga introspeksioni i një lirizmit të fortë. Dhe kjo nuk është rastësi. Në të vërtetë

¹ Në historinë e artit perëndimor *mise en abyme* (shqiptimi frëngjisht: [miz an abim; gjithashtu *mise en abime*) është teknika e vendosjes së një kopje të një imazhi brenda vetes, shpesh në një mënyrë që sugjeron një sekuençë të përsëritur pafundësisht. Në teorinë e filmit dhe teorinë letrare, i referohet historisë brenda teknikës së tregimit.

ky roman ka qenë prova e parë e Mustafajt në prozë, pas dy librash me poezi. I lindur në 1958-ën autori është njëri prej intelektualëve më të njohur të Vendlit të Shqiponjave, ku ndër të tjera ka shërbyer në poste të ndryshme politike pas rënies së regjimit si, ambasador në Paris, 1992-1997 si dhe ministër i Punëve të Jashtme, 2005-2007. Më pas u tërhoq nga politika për t'iu përkushtuar shkrimtarisë. Në pashënien e lartpërmendur ai shpjegon pikënisjen e romanit e cili frymëzohet nga një ngjarje e vërtetë. Bëhet fjalë për zbulimin e një të mbijetuarit në Mauthausen i cili merr vesh që një miku i tij nuk ka vdekur në datën kur e përkujtonin, por dhjetë ditë më pas. Një detaj i parëndësishëm në dukje. Por jo për të fejuarën, e cila për 40 vjet nuk kishte pasur asnjë marrëdhënie, duke u shndërruar në njëfarë "murgeshë komuniste". Me të dëgjuar lajmin, gruaja u pendua që nuk ia kishte dhënë të dashurit, në kujtimet e saj, ato dhjetë ditë të tjera jetë. Pikërisht këtu zë fill frymëzimi sendërtimin e kësaj veprë që autori e shkroi për tre javë. Në fund të fundit, autori përshkruan sistemin censurës të kohës, i cili nuk kurseu as emra të mirënjohur si, Ismail Kadare, Fatos Arapi, Petro Marko

dhe Dritëro Agolli, i cili kishte qenë edhe drejtues i Lidhjes së Shkrimtarëve si dhe anëtar i Komitetit qëndror të Partisë. Tre ishin nivelet e censurës. Niveli i parë kishte të bënte me prerje apo zëvendësime fjalësh dhe frazash, ose përshtatja e ngjarjes sipas linjave zyrtare, të cilat priren kah ideja e edukimit të popullit. Niveli i dytë sanksiononte "gabimet ideologjike" të cilat i hapnin rrugën shkatërrimit. Niveli i tretë nënkuptonte dërgimin e dorëshkrimit pranë Sigurimit, i cili ishte policia sekrete dhe kishte pasojë shumë të rënda për ndonjë autor fatkeq si, fjala vjen, arrestimi dhe dënimi për dhjetë apo më shumë vjet burg si "armik i popullit". Mustafaj ishte i qetë sepse tema e tij kishte të bënte me luftën antifashiste nacional-çlirimtare. Protagonisti ishte një hero i madh dhe në të njëjtën kohë ishte frymëzuar nga ngjarje reale të diktuar nga regjimi. Por jo vetëm kaq, edhe reagimet e atyre që e kishin lexuar dorëshkrimin, kishin qenë pozitive. Vetëm Kadareja, një njeri që "e shihte si askush tjetër hijen e rrezikut edhe përtej horizontit dhe e evitonte", e këshilloi ta fshihte dorëshkrimin dhe ta ruante me shumë kujdes në shtëpi. Shumë domethënëse është skena kur autori gjendet përballë redaktorit të shtëpisë botuese shtetërore i cili ia shqipton me zë të lartë fragmentet e dyshimta: "me një kantilenë të lodhur dhe të pakëndësishme, aq sa më dukej vërtet e çuditshme që kisha shkruar aq keq".

Një skenë që do të përsëritet shpesh për katër vjet. Në fund autori pranon që teksti të cunohet, madje romani do të jetë edhe kandidat për një çmim kombëtar. Por arrin të marrë çmimin e dytë, edhe pse, siç do ta zbulojë më vonë vetë autori, iemri i tij shte diskutuar si fitues kryesor i çmimit të madh. Anëtarët e jurisë ishin trembur nga "frika që një prozë kaq e dykuptimtë mund të tërhiqte vëmendjen". *Maturia komuniste* dhe frika e skandalit kishin ngadhënjyer përsëri. Por për fat, jo në mënyrë të pakthyeshme.

Përktheu: L. D.



ARCADIA EDIZIONI

Dir. Resp.: Marco Girardo
Tiratura: 96.480 Diffusione: 104.662 Lettori: 235.000

Rassegna del: 15/11/24
Edizione del: 15/11/24
Estratto da pag.: 19
Foglio: 1/2

Nell'Albania comunista la sessualità era un tabù da sottoporre a censura

GIANNI SANTAMARIA

Nell'Albania comunista un romanzo poteva essere censurato non solo per motivi ideologici o letterari, ma anche perché l'autore vi indagava con tratti onirici e psicologici i turbamenti di una donna riguardo al suo corpo e al piacere sessuale, in particolare una donna arrivata vergine alla fine della vita. Ciò rappresentava per lo stile una novità nel panorama della letteratura albanese, caratterizzata dal realismo socialista, ma nei contenuti toccava un tabù. Poco importava che la protagonista, una sorta di Penelope novecentesca, fosse rimasta fedele per tutta la vita a un eroe della guerra contro il nazifascismo, morto nel lager di Mauthausen. *L'estate senza ritorno* di Besnik Mustafaj, scritto nel 1985, uscì dunque solo quattro anni dopo, mutilato di un terzo. Non per ideologia o per la prosa. L'autore si rese conto dei veri motivi solo nel 1991, quando - caduta la dittatura - riprese in mano l'originale in vista della pubblicazione integrale. Lo racconta nella postfazione al romanzo, che esce in prima edizione italiana, tradotta da Julian Zhara, per le edizioni Bibliotheka (pagine 208, euro 21,00). La censura stupisce ancora di più, vista la finezza di scrittura e di introspezione psicologica con la quale Mustafaj si pone davanti al personaggio di Sana, la protagonista del romanzo, che riabbraccia Gori, il fidanzato con il quale vuole finalmente sposarsi e provare l'amore fisico. Gori manifesta, però, alcune stranezze: dorme in modo innaturale, è pallido, il suo respiro è freddo e soprattutto non suda mai. Poi evita contatti sociali, parla poco - soprattutto del misterioso luogo da cui è tornato - ed è di continuo immerso nella lettura di opere sulla guerra e nei ricordi. Tanto che parla sempre al passato. Infine, questa sorta di *revenant* dimostra nel suo agire una certa fretta. Da un lato, dunque, le pulsioni di lei, dall'altro il mistero di lui. Intorno a loro poche rarefatte figure si affacciano sulla scena dell'albergo e della spiaggia dove i due trascorrono una vacanza a Durazzo, ambientazione di questo ripreso rapporto che stenta a decollare sul futuro. Quando la coppia va a teatro, si verifica una catartica scena, dai tratti shakespeariani, di *mise en abyme* tra racconto e rappresentazione, che conduce al drammatico finale. Nel racconto non mancano riferimenti all'ateismo di Stato e alla tradita uguaglianza tra gli uomini, costata sangue. Ma la narrazione resta sospesa tra realtà e sogno ed è una riflessione profonda su vita, amore e morte. I personaggi sono inoltre caratterizzati da un'introspezione di intenso lirismo. Non è un caso. Questa, infatti, è stata la prima prova di Mustafaj in prosa dopo due libri di poesia. Classe 1958, l'autore è uno dei maggiori intellettuali del Paese delle Aquile, per il quale ha ricoperto importanti ruoli politici dopo la fi-

ne del regime: ambasciatore a Parigi dal 1992 al 1997 e ministro degli Esteri dal 2005 al 2007. Si è poi ritirato dalla politica per dedicarsi solo alla scrittura. Nella postfazione spiega la genesi del romanzo a partire da una storia vera: la scoperta da parte di un sopravvissuto a Mauthausen che un suo amico non era morto nella data in cui sempre lo si era ricordato, ma dieci giorni dopo. Un particolare apparentemente ininfluenza. Non per la fidanzata, che per 40 anni non aveva cercato altri uomini trasformandosi in una sorta di «monaca comunista». Alla notizia la donna si era rammaricata di non aver concesso all'amato, nei suoi ricordi, quei dieci giorni di vita in più. Da qui l'ispirazione per l'opera, scritta in tre settimane. L'autore descrive, infine, il sistema censorio albanese, che non risparmiava neppure nomi affermati come Ismail Kadare, Fatos Arapi, Petro Marko e Dritëro Agolli, che era addirittura presidente della Lega degli scrittori e membro del Comitato centrale del partito. I livelli di censura erano tre. Il primo consisteva in tagli o sostituzioni di parole e frasi o nel piegare la storia alla linea ufficiale, tesa all'educazione del popolo. Il secondo sanzionava gli "errori ideologici" e apriva la strada verso il macero. Il terzo comportava l'invio del manoscritto alla Sigurimi, la polizia segreta, con conseguenze durissime per

Peso: 23%

Telpress Servizi di Media Monitoring

Sezione: DICONO DI NOI

Në diktaturë, të gjithë brezat e poetëve, kanë viktimat e tyre, jo rrallë: si një "larje hesapësh" mes kolegësh, që, për inerci vazhdon edhe sot, sikurse e dëshmon Sadik Bejko në këtë rrëfim: "Unë, malësori, i idealizoj shkrimtarët atëherë. Njëri syresh ishte nga ata që e respektoja shumë, pinim gjithmonë kafe bashkë. Ishte dhe është shkrimtar i mirë." Edhe pse e ka pësuar prej "shkrimtarit të idealizuar", nuk bën marketing me vuajtjen. Përkundrazi, s' e honeps ndarjen e poezisë në: o pro diktaturës, o kundër saj, ngaqë kriteret jashtëletrare mbeten ende një arsenalë për të prishur imazhin e dikujt apo për të kurorëzuar dikë. "Më duket se që të dyja dalin në një qafë. Kurse letërsia duhet t'i kapërcejë qafat, të jetë e nisur nga një kohë për të shkuar përtej saj."-këshillon ai. Të tejkalosh kohën është më e vështirë se sa të ngrihesh mbi ambientin. I dashuruar me të gjithë forcën e burrit e mban kokën në drejtimin nga është e dashura, sikurse besimtari me fytyrën nga Meka dhe "kjo është si t'ia përdredhësh qafën malit". Kjo përdredhje e qafës së malit bën kontrast me ata, që tridheshin në zyra.

Poezia e Sadik Bejkos ka një fuqi meditative të trashëguar, nëse i referohemi rrëfimit të tij për gjyshen, e cila, "këtë punën e të folurit me vete e kishte aq të sajën, sa e merrje vesh edhe kur fliste pa zë...Kur errej, ajo dilte përballë malit dhe nuk e mbante më dallgën që e troshiste përbrenda. Fliste dhe fliste pa pushim. Për të thoshin se kishte roitur. Po mua nuk më dukej kështu." Dhe ja nipi: "Që fëmijë ecja mendueshëm. Gjyshi im nga nëna nuk ma donte këtë huq. Isha nja dhjetë vjeç, kur me ankim ia thoshte sime mëje: "Ky djalë yt nuk më pëlqen, vjen i menduar. Nuk do ta ketë jetën aq të lehtë. Nuk ka ngjarë nga soji ynë". Fjalë me doza profecie. Poeti i ardhshëm s' ngjau as nga soji i fisit dhe as nga lloji i artistit. Meditimi i trashëguar do shfaqet tek ai edhe si një refleksion. Sadik Bejko fillimisht u ngjit në malin e shenjtë, më pas u çua me përdhunë në hadin e minierës deri sa doli në dritë, duke u përlëshur me fatin.

Ngjitja në malin e shenjtë

Ngjitja në malin e shenjtë, në Baba Tomor, adhurua si fron perëndish nga Naimi dhe Çajupi, do nxit dhe tek poeti Bejko: ndjesinë e lartësismit. E ka për krenari që në vargjet e tij të jetë i pranishëm mali, relievi i thyer i vendlindjes. "Shtatëdhjetë vjet më parë të dy me babain jemi ngjitur në majën e malit të Tomorit. Kemi ecur me këmbë ditën në vapë, muzgut të mbrëmjes e mugullimës së agut. Në nisje kurbanin ma vunë mbi shpinë... Sikur donin të më thoshin, se në këtë udhë nga ne të katërt më i rëndësishmi ishte kurbanit." Fati i kurbanit mos do përsëritej tek ai në kohën, kur po kërkoheshin "kokat e turkut"? Dilema: "Do të më pranonte mua zoti i Tomorit? Isha i pastër? Para ca javësh kisha dashur të vjedh dardha, por nga frika e të zotit të mallit që na diktoi, pantallonat i kisha lagur. Isha i pastër?" (Në kohën e "pastërtisë së figurës", atëherë kur çmohej virgjëria, kur brezi ynë preferonte këmbësorë e bardhë, gjithsesi zor se i shpëtoje njollosjes. Të ndoturit e bën pis këtë vend. Një kulak i shpallur e nxinte fisin, pavarësisht partizanit me yll të kuq.) Në kthim, kujton poeti, kurbanit për Baba Tomorin duhej ndarë me të tjerët, këtë radhë jo si sakrificë, por si bamirësi. (Kur dikush varej në trikëmbësh, pas ekzekutimit turma turrej të merrte një copë nga litari i të varurit, ta kishte si hajmal.) "Na jepni pak mish Tomori"-ishte thirrja që do i shoqëronte dhe kurbanit ndahej me të gjithë ata, që ndeshnin gjatë rrugës. "Mund të mburresha se kisha qenë në Tomor... por babai... më tha: "Mos fol, ne e bëmë për vete, jo për ta shitur gjatë!"-e mbyll rrëfimin poeti Bejko, duke i kthyer fjalët e të atit në

Poezia e Sadik Bejkos

Në thellësitë e vuajtjeve mund të jetë dhe lartësimiti yt

Nga Fatbardh Amursi



një kredo morale. Në asnjë rast krenarinë nuk e degradon në mburrje. Mediton si gjyshja, shfaqet si i ati dhe i kërcënuar nga fati i kurbanit. "Vetëm në largësi mund të kuptosh/sa larg mbi të tjerët ngrihet një mal./Nuk kanë kaluar as dy ditë dhe po kuptoj/se ato pak ditë me një vajzë/ngrihen si Everesti mbi të gjitha ditët e mia./Mjafton vetëm dy ditë/për të dashur gjithë jetën një grua."-lartësohet ai përmes dashurisë. "Dimri, i penduar që ende s' ka marrë hak./bën të ikë e rikthehet më i vrazhdë", ku secili i vetëm kërkon Krishtin e lodhur, ndaj: "Bën udhë pa truall nën këmbë/...Thur gjyshen në lecat e mbrëmjes." Pse nga largësia mund t' i kuptosh lartësitë? Tutje nga Anadoli e panë Baba Tomorin Naimi me Çajupin dhe shkruan për malin e shenjtë si të ishin banor të tij. "Po të mos ishte shkolla, librat,/unë do të isha atje, në fatin tim,/në malësitë e mia të djeshme."-shkruan ai, duke lënë të kuptosh se librat janë bërë shkak i largimit të tij nga vendlindja. (Librat të ftojnë të njohësh botën, varfëria të endesh nëpër botë.) Ndodh që libri të fundos dhe dy pashë nën dhë, sikurse i ndodhi dhe poetit me librin e parë.

Zbritja në minierë

Meqë flitet për galeri personazhesh, Aparatçikët e dërgojnë poetin galerive të minierës, më gjasa, në kërkim të heronjëve. Për njeriun e lartësive ky lloji dënimi nënkupton poshtërimin, por, kur mendon që Aristofani dhe Virgjili janë të vetmit që kanë vizituar hadin, i takon poetit që ndëshkimin ta kthejë në "privilegj"? "Në minierën e qymyrit në Memaliaj atëherë kështu punohej: gjunjas, këmbadoras, rrëshqanas. Kam parë aty dhe të vvarë, dhe

të sakatuar përgjithmonë. Djem fare të rinj. Miniera ishte vend për fatkeqët. Herë-herë, si për ta ngacmuar rrezikun, për t'i shkuar së keqes gjer në pikën më të fundme, futesha me vetëdashje në vendet më të zeza të minierës, aty ku mund ta paguaja me kokë." Ty të rishfaqet historia e kurbanit, por, këtë radhë: ata që donin mish nga Tomori, do merrnin prej tij vargje si këto: "Çdo natë hyj në barkun e territ./Kamarja e zezë, e ngushtë, mezi më nxë:/barkas, brinjaz, këmbadoraz, djersitshëm/pikëz nëpër fill merimange, në pa rrugë,/në pa dritë, në pa gjurmë, në pa zë." Ndonjëherë: rroposje dhe groposje zor se dallohen.

Në atë kohë Driteroi botoi librin poetik "Shtigje malesh dhe trotuaresh" me një titull sinjifikativ. Ndërkohë nga shtigjet e maleve zbritën shumë poetë, thua se po përsëritej historia e përtizanëve që zbrisnin nga malet fitimtarë, por, jo të gjithë iu gëzuan trotuareve. Sepse: "Ne jetojmë në një qytet rrëshqitës/Tmerrësisht rrëshqitës, tmerrësisht të gurtë/Jashtë kohe, dhe mode, dhe feje./Ky është vendi i thyerjeve, i rrëshqitjeve/I nëpërkëmbjes, i pështymave gri./Me ç'guxim guxon, njerëzon ti?" Si mund ta përballje gjithë këtë mbrapështi paranojakësh? (Sa e sa gjeneralë u pushkatuan, u burgosën e u internuan për shkak të "teorisë së rrëshqitjes"? Kadare shkruan për "Sokakun e të marrëve", ku pak të rrëshqiste këmba do përfundojë në çatinë e fqinjit.) "Imzot Hammurabi, mua plakun e përvojtur/pse më nxore nga shpella ime,/nga budallallëku im pse më nxore?"-dhe këto vargje i shkruan ai që prej disa vitesh zvarrej nëpër galeritë e minierës: "Njerëzit këtu janë me nga një bodrum të zi,/me nga një hambar terri mbi shpinë dhe nën tru." Rreziku i zhbërjes është

eminent: "Dhe diçka ikën, ikën, më vidhet,/ nga gjumi im vidhen dëshirat,/si zogjtë që u vidhen çerdheve të tyre.../E nga unë, që nuk kam kurrëfarë pasurie/diçka vidhet." Pak ju duket të të vjedhin vitet më të bukura të rinisë? "Njerëzit /bien nga shpellat në bodrumin e vetes,/për ta s'ka më nënë, mik e të dashur,/janë më të ftohtë se një gur,/më të thatë se një dru." Rënia në minierë shoqërohet me rënie në shpellë, në bodrum. Rreziku i një shkretimi kërcënon shoqërinë. Ngurtësia e asketëve kërcënon me ngrirje artin, ndaj poeti merr përsipër një mision, që s' ia jep askush veçse vetëdija e tij. "Kështu zogjtë/i shpëtova nga mpirja,/nga uji i ndënjur në pellg,/nga gurët e thërrmueshëm,/nga myshku i lodhjes/te drurët pleq." Rrëfen një episodë jo pa domethënie: "Një herë bashkë me një moshatarin tim kemi ngrirë në tufanin e borës, por punëtori i mirëmbajtjes së rrugës, na gjeti shuk në anën e xhadesë, ndezi zjarr e na solli në vete." Mos vallë këtë rol luajti dhe Kadare, duke iu gjendur në zgrip të jetës? "Po bëhesha gati ta lija poezinë, nxitja e Kadaresë më mbajti në punë." Njeriu që s' është mësuar me malet, nuk i ndruhet as rrezikut që mund t' i vijë nga miqësia me detin. (Miku i tij poet, Thanas Dino, e kishte pësuar nga një fik deti.) Pluhuri i zi i qymyrit bie dhe mbi fletën e bardha të letrës, duke jetuar "ditë pa të diela" dhe "javë pa të kremte", sikurse hëna vozit në lumin e tij të pikëllimit. Por, trishtimi i tij nuk është ngjitës, ngaqë s' është dekurajues. Për dikë që bie në dashuri thonë se atë e ka zënë qymyri. I mjaftojnë vetëm dy ditë për të dashur gjithë jetën një grua. Ndaj, kur së shohes i kërkuan ta ndante, ajo u suall ndaj tij si një mbretëreshë, ndaj i ka me hak këto vargje: "Gruaja ime fytyrëdashur.../...përtej vajzërisë sate pa halle/...s' e prisja që mbi vargje t' më binte rrufeja,/të binte sëpata." (Kur mbreti Zog po përgatiste arratisjen, ambasadori amerikan i ofroi Geraldinës mbrojtje në ambasadë, por ajo iu përgjey: "Do ndjek fatin e burrit tim.") Nuk është rastësi që në kujtesën e poetit kanë mbetur këto vargje, kënduar kur dasmorët bëheshin çakërçejf: "Buza jote pak e qeshur/Më mbajti mua në shpresë." E kishte zënë qymyri, por jo ai i Memaliaj.

Dalja në dritë

Në vitin 1990 Sadik Bejko shkruan poezinë "Lirimi i deleve", shoqëruar me shënimin: para se të liroheshin të burgosurit nisi çlirimi i kafshëve shtëpiake me lejimin e tyre me të ashtuquajturin "tufëzime", ndërkohë që ujçërit u kthyen në barinjë. Ka kurajon të thotë dhe në demokraci se "bota



e ligësisë nuk është vetëm komunizmi". Kur përballja me fatin duket si një betejë e fituar, i kërkon dikujt që ta pajtojë me veten. Pasionet s'janë më vullnete të ndrydhura. "Atëhere ankthi s'është turp./ pafuqia s'është turp./mjerimi i vetes s'është turp/ndershmëria s'është turp asnjëherë./ vetmia, budallallëku/pasuri të tmerrshme, të flakura në erë." Por "një re e vogël sa një sandale vajze", e josh si të jetë këpuca e Hirushes, se malsori, që i idealizonte shkrimtarët, udhëhiqet nga parime të larta morale, sikurse ai shprehet në një intervistë: "Në letërsi duhet të jesh i ndershëm. Sa më shumë të mundesh." Vagabondi Esenin që bridhte lule më lule, jo vetëm ai, në poezi ishte më i moralshëm nga besnikët e kauzave të rreme. Po kështu dhe Lasgushi ynë, duke heshtur, ishte më esnaf nga ata që e qepën gojën nga frika. "Arti duhet t'ia mësojë njeriut përlëshjen me fatin, me vdekjen", shkruan poeti Bejko, duke patur për kundërshtarë dalëzotësat. (Tabelat "Rrezik vdekje" vihen aty ku ka rrezatim radioaktiv dhe jo në ndeshjen me demat.) "Në rini je i djegur për të qenë në kohë... për të qenë një çikë modern. Por libri nuk më solli fat...do të shkoja në minierë, minator galeri. Për gjashhtë vjet nxirrja qymyr guri. Pa të drejtë botimi."-rrëfhet ai, duke qenë njëherësh qortues me ata, që abuzojnë me lirinë e të shkruarit. Spekulumi me zotërimin e teknikave të të shprehurit, duke e tepruar me figuracionin, sipas tij, mbart rreziqe, ndaj ndërmer një akt ndërgegjësimi në dobi të artit. Abuzimi: "Fillon me errësimin, me shtimin e figuracionit. Me atë që "moderniteti" e kërkon pak të sofistikuat poetin etj, etj. Po deri ku? Deri ku duhet shkruar, që mos ta dëmtojë poezinë. Dhe le ta themi se një prijje e tillë, në emër të asaj që është "moderne" edhe e ka prekur kthjellësinë. Tek unë dhe tek të tjerët." Që të hysh në një bodrum a në një minierë duhet të kesh me vete: o një pishtar, o fener, u elektrik dore, o llambë karbiti. Galeritë e errëta të minierës ia kthyen në armik terrin. Errësimi pa kriter i poezisë, për fat të keq, stimulohet nga disa "ekspert arti", që të kujtojnë "modën në fshat" apo lesh xhami. Teleskopët po kapim pamje nga universi, ne s' shohim asgjë dhe hiqemi se po zbulojmë Amerikën?! I shqetësuar mos po e tepron me errësimin, abstragimin, sa për kollaj e kanë politikanët të ankohen për "terrin informativ", shkruan vargjet: "Mbrëmja ha tinëz./Kafshon tej qafa malesh,/korijet, varganin e kodrave, udhët.../Mos bën lojën e pemëve ky plak,/që kujtojnë se zhduken dhe shfaqen në ag?" Madje, poeti Bejko qorton Sadikun se ka botuar poezi më shumë se ç' duhet. Sipas tij, ia vlejnjë vuajtjet, sakrificat në emër të artit, qoftë dhe me një libër të vetëm. Nuk është fjala as për librin e parë "Rrënjët", që nuk i solli fat, as për të fundit të botuar në italisht dhe shqip nga Mimoza Pulaj, jo pa jehonë, por, për ato poezi, që i japin atij ofiqin poet. (Feliks Arver përmendet në historinë e letërsisë frënge vetëm për poezinë "Shpirti im s' ka sekrete, jeta ime s' ka mister" kushtuar së shoqes së Viktor Hygoit, të cilën ai e dashuroi pa ia shfaqur ndjenjën askujt.) "Sa të plas, t' më marrë dreqi, merrmë ti, të paktën./prekmë ku s' lejoj askënd."-shkruan ai, duke besuar se poeti është një siluetë shëtitëse e dashurisë. Për t' u bindur lexoni monologun e një murgu, i cili njësoj si gjyshja e tij do fjaloset me vete, duke këshilluar: "Rrugës së madhe s'ia del tej me urrejtje." Ndërsa vetë shqipton qartë fjalë prej të urti: "Jeta na vë përpara një fat që duhet ta përballojmë... Në thellësitë e vuajtjes mund të jetë dhe lartësimi i njeriut." apo: "Nuk ia dilja dot jetës me qejfmbetje dhe me mërirë. Aq më keq me hakmarrje. Fali dhe shko tutje." Ndaj është krejt i besueshëm kur thotë se në poezi ka regjistruar veç jetën e tij. "Ec, o i dashur, ec, i thua vetes./Rruga u lodh, ti nuk u lodhe."

Fragment nga biografia "Nëna ime Jolanda"

MAMAJA DHE NE VAJZAT

Nga Prof. Dr. Klara Kodra

Mamaja kishte vendosur me ne vajzat (me mua dhe me time motër, Etelin), që nga fëmijëria e hershme, një frymë afërsie dhe dialogu.

Ajo luante me ne, duke u bërë si të thuash, edhe vetë fëmijë, duke dramatizuar përralla, duke rikrijuar personazhe përrallash me anë të kukullave tona, luante gjithashtu lodra me letra bixhozi ose lodra në bazë enigmesh.

Nga ana tjetër, ajo fliste me ne, sikur të ishim të rritura, duke na rrëfyer kujtime nga e kaluara e vet në Itali e në Shqipëri, duke na treguar gjithashtu vepra letrare dhe duke iu përgjigjur pyetjeve tona.

Ajo kishte qepur për ne një shumëllojshmëri kukullash prej stofi vërtet të mrekullueshme me nuse me vello, princër dhe princesha, zana, zezakë, arushë, mace, gati një minigjithësi krijesash që mishëronin për ne botën e përrallave.

Ajo kishte krijuar midis nesh një frymë aq demokratike sa kur një ditë ime motër, atëherë adoleshente, guxoi ta pyeste a kishte dashuruar dikë tjetër para babait (për babanë e dinim që e kishte marrë me dashuri) nuk u zemërua, as u skandalizua (e përfytyroj me frikë çdo të kishte ngjarë me ndonjë prej hallave tona a shoqeve të mamasë, edhe italiane sikur të ishin).

Vërtet që mamaja u zu ngushtë dhe iu përgjegj motrës "jo" me vendosmëri. Vërtet që ishte skuqur e tëra, po s'tha asnjë fjalë të ashpër.

Madje, më vonë ajo na porositi që kur të binim në dashuri, t'ia thoshim asaj të parës, kështu që ajo të bëhej ndërmmjetëse midis nesh dhe babait.

Ajo shfaqej kështu mjaft e përparuar dhe as nuk i sillte në mendje martesat e përgatitura nga familja që në atë kohë ishin të zakonshme dhe që sigurisht gjyshja dhe halla e madhe do t'i pranonin. (Më kujtohet akoma se si i hapi sytë e llahtaritur kjo e fundit kur unë, për ta ngacmuar, i thashë se do të martohesha me dashuri).

Mamaja përkundrazi nënkuptonte se zgjedhja e shokut të jetës do të na lihej neve, po sigurisht me miratimin e prindërve.

S'do ta harroj kurrë, kur një djalë më foli për herë të parë në rrugë, kur isha vetëm pesëmbëdhjetë vjeç, kthehesha nga shkolla dhe kisha lënë takim me babanë, i cili kur më pa me këtë djalë të panjohur, u nxe dhe zuri t'i fliste atij me rreptësi (ai djalë i bëri ballë si munda duke i thënë se edhe vetë kishte motra dhe e kishte parasysht respektin ndaj vajzave).

Më vonë babai m'u kthye mua duke më thënë me një ashpërsi që s'e kishte përdorur

kurrë, se për asnjë arsye s'duhet të flisja me njerëz të panjohur.

Mamaja kur e mori vesh, për çudi, e mori me të qeshur (e ndjej ende zërin e saj: "Klara, paske pasur sot një kavalier!") dhe s'thuhet dot se sa e lehtësuar e ndjeva veten.

Jolanda, sigurisht, sillte ndër mend takimet e para me djaloshin e pashëm nga Shqipëria për të cilin, në fillim ajo dinte shumë pak, gati asgjë.

Kur isha fëmijë dhe adoleshente, në disa raste ajo më dukej tepër e rreptë, po në fakt ajo ishte vetëm kërkuese.

Një nga ato raste ishte kur ajo më kërkonte të isha e përpiktë në shkollë. Përpikmërinë ajo e kishte në gjak, sikur të mos ishte italiane, po gjermane. T'i ngjante vallë në këtë pikë gjysh Albertos? Për këtë s'di asgjë (fundja, gjyshi s'ishte vetëm inxhinier, po edhe skenarist, pra, artist dhe dihet mirë se çfarë nami u ka dalë artistëve në këtë pikë).

Ajo që është e sigurt dhe që më ka mbetur në kujtesë janë zgjimet që ajo na bënte çdo mëngjes kur duhet të shkoja në shkollë dhe zëri i saj i ëmbël, po edhe i rreptë, zinte vendin e orës me zile që s'e kishim.

Nga një anë mamaja tregohej e dhëmsur dhe e kujdesshme, madje mund të thuhet se më urrente (ma sillte në shtrat filxhanin me kafe elbi), nga tjetra më nxiste që të mos vonohesha në shkollë.

Po në përgjithësi fëmijët s'e kanë ndjenjën e kohës, aq më tepër një fëmijë që, si unë, synonte të bëhej poet.

Koha më dukej e mbushur me çaste interesante, që s'kishin pikën e lidhjes me vajtjen në shkollë (të vështruarit në pasqyrë, soditja nga dritarja e luleve, e pemëve apo e ndonjë aeroplani në fluturim e sipër).

Mamaja, në ato çaste bëhej nervoze: Shpejt, shpejt se iku ora! Shpejt se do të fillojë mësimi! Çudi që je aq e qetë!



Si rezultat, shkoja në shkollë gjysëm ore para se të fillonte mësimi (te shkolla "Vasil Shanto" që atëherë ishte gjimnaz, më vonë te "10 korriku") i lutesha shërbyeses së shkollës që të më linte të futesha në klasë dhe hapja ndonjë libër për të "vlarë" kohën.

Në vitin e fundit të gjimnazit ndërrova stil për deri sa kisha ndërruar edhe shkollën dhe kisha vajtur te "Çajupi" që ishte larg nga shtëpia, kështu që duhej të merrja autobusin.

Tani i bëja të gjitha gjërat me vrap, dilja nga shtëpia pa ngrënë fare mëngjes, me bukën e mbështjellë në gazetë, rendja për të kapur autobusin dhe për t'u futur në mes të turmës së njerëzve.

Po tani ishte fjala për një shkollë që e kisha zgjedhur vetë, prandaj s'duhej të rrezikoja të më qortonin.

Më vonë, kur mora maturën dhe nisa të ndiqja leksionet si studente, ndryshova prapë, kësaj radhe për keq, fillova të vonohesha kastile, për shkak të mendimit të çuditshëm që kisha për lirinë e cila, sipas meje, u takonte, patjetër, studentëve, po këtu nis një kapitull tjetër, edhe i jetës sime, edhe i marrëdhënieve të mia me mamanë, për të cilin duhet folur më gjatë.

Mendimet e mia rebele për lirinë që duhet të kishin studentët të cilët sikur i paraprinë lëvizjes studentore të 1968-ës që do të ndodhte shtatë vjet më vonë dhe, për më tepër në Itali e në Francë, i sollën mamasë disa shqetësime për të cilat tani më vjen shumë keq.

E gjora, mama. Kur fillova të ndjek studimet për letërsi dhe lashë prapa konfliktin me mësuesin e fizikës që donte të më linte në klasë dhe për pak më la pa marrë maturën, kishte shkruar për mua një poezi ku shfaqte shpresën se tani problemet e adoleshencës do të merrnin fund. Ajo s'e dinte që ato probleme sa kishin filluar.

Libri i ri i Ahmet Shqarrit është një botim Luksozi Shtëpisë Botuese "Morava". Brenda një kohe të shkurtër, ai pati një jehonë të gjërë dhe pritje mjaft të ngrohtë nga lexuesit.

Ky është një libër i vecantë, autobiografi, por edhe pasqyrë e një periudhe 80-vjeçare, ku marrin jetë në formë kujtimesh spontane, dhjetra ngjarje, situata, personazhe të njohur, të vërtetë, me emër e mbiemër. Për nga dëndësia është si një roman, jo fikcional, sic janë tërë romanet e botës, por tepër real, shkruar me plot frymëzim dhe dashuri. Kjo, të kujton fjalët e Dritëro Agollit, pedagog e me pas mik i autorit: "Dashuria dhe arti nuk bëhen me urdhër, ashtu sic nuk bëhet me urdhër tështima".

Libri "Kur ke çfarë të kujtosh" duket sikur është shkruar me një frymë. Rrjedhshmëria e stilit origjinal në të shkruar, të rrëmben e të merr me vete deri në faqen e fundit.

Është meritë e autorit, që ka ditur të ndërthurë e të nxjerrë bukur në pah vlera të vecanta të jetës njerëzore, në kuptimin më të gjërë të fjalës. Në libër "mbretëron" dashuria për vendlindjen, për familjen, për shokët, miqtë dhe kolegët, për profesionin e për marëdhëniet me Punën.

Sot vlera të tilla po humbin, po harrohen.

Peqini, magji e fëminisë

Avdyl Frasheri thotë: "Vendlindja duhet, jo pse është e madhe apo e vogël, por sepse është e jona."

Ahmet Shqarri përshkruan me pasion dhe përkushtim të vecantë qytetin e tij të lindjes, Peqin. Ndoshta faqet më të bukura të librit i kushtohen fëmijërisë e, direkt apo indirekt edhe qytetit, ku u rrit.

Këtu gjen një rrëfim plot ngjyra, pamje, ngjarje dhe imtësi që të mbeten në mendje. Janë aq të gjalla kujtimet, sa cdo lexuesi, që ka lindur e jetuar në gjysmën e dytë të shekullit të kaluar, i sjellin ndër mend jetën dhe vendlindjen e tij me bukurinë, me vecantitë e ngrohtesinë njerëzore të atyre viteve, por edhe me varfërinë e skajshme, ashpërsinë e sistemit e padrejtësitë e shpeshta. Autori përshkruan me detaje të imta qytetin, lojrat fëmijore me topa lecke, kinemanë e vjetër, ditën e verës, tellallin e qytetit, arxhiun me kafshën e tij të madhe, pazarin tërë gjallëri e jetë e deri tek pjekja e gjelave të detit të Peqinit, aq të njohur edhe sot në mbarë vëndin. Sipas aktorit tonë të madh Reshat Arbana, kur shkruan për librin thotë: "Tek fëmijëria e Ahmet Shqarrit në librin e tij, në një farë mënyre unë shoh fëmijërinë time. Do të dëshiroja shumë që, kështu thjesht, me stil të bukur dhe të qarte, të shkruaja edhe unë kujtimet e mia..."

Një jetë që rrjedh e bukur dhe e qetë për autorin fëmijë, rrethuar me një dashuri të pamatë nga prindërit, vellezërit dhe motrat, por edhe nga të afërmit, shokët dhe miqtë. Për të, Peqini ishte kryeqyteti i botës, vëndi me magjik që mund të ekzistonte, i njëjtë me vendlindjen e secilit nga ne, që është rritur në ato kohe: "...Nuk dua të habis askënd me këto kujtime...por fakti që shumë gjëra të asaj kohe, që unë e brezi im i kemi kaluar, tashmë ngajjnë si të një bote tjetër, pak si realizmi magjik i ndodhive që përshkruan Gabriel Garcia Marquez, aq më tepër që atë botë magjike nuk e shoh të rrethojë fëmijët e sotëm, më bën që ti sjell ndërmend tani..." (F. 38)

Sipas antropologut tonë të shquar Prof. Perparim Kabo, ky libër "...është një magji antropologjike...jeta dhe organizimi i saj, marrëdhëniet ndërnjerëzore, epokat, kulturat, aventurat individuale, veshjet, ushqimet, natyra, fëmijëria, një mrekulli më vete. Gjithçka ka shumë dritë, etos njerëzor aq të dritë, pathos aq të ndierë dhe logos krahinor dhe shqiptar..."

Dhe me pak meditim, përshkrimi i njerëzve në RTSH është një histori kronike mes punës, arritjeve, frikës dhe ndjenjave...edhe pse me pak rrjeshta, gjithësecili prej tyre ka "mbretërimin" e vet. Dritën, hijet, punët e mira, punët e liga, dhe kontrasti dritëhije antropologjike vjen si një kaleidoskop njerëzor...pak histori por shume të verteta.

Gjithçka si në utopi e ngrohtë...që jeton përtej së keqes..."

Njeriu dhe familja

Po jetojmë në një kohë te cuditshme, ku flitet me të madhe për prindin nr. 1 dhe

Libri i ri i Ahmet Shqarrit "Kur ke çfarë të kujtosh"

Një udhëtim mes mallit dhe dashurisë njerëzore...

Nga Ylli Pepo

prindin nr.2, ku familja nga vater e ngrohtë e dashurisë më të ëmbël që merr njeriu, po kthehet në target numërorësh, gati po kërkohet të robotizohet.

Ky libër është një antidot me vlerë, për të kuptuar se çfarë është familja e vërtetë. Si ajo ku je rritur, po njësoj edhe ajo, që gjatë jetës, e ke krijuar vetë.

E them me plot gojë, libri i ri i Ahmet Shqarrit është një himn për familjen. Autori e ka kryefjalë të librit mardhënien mes pjesëtarve, dashurinë prindërore, ku babai dhe nëna janë të pazëvendësueshëm. Nëpërmjet penës, të mbushur jo me bojë, por me një mall të pashuar vjen nëna, Muma, e dhembshur dhe e shtrenjtë, ku sakrificat e dhëmbja janë fillimi e fundi i detyrës nënësore. Babai me shëmbullin dhe punën e lodhshme është pjesa më e rëndësishme e mozaikut familjar, skalitur "gur për gur" si dëshmi e thelbit të edukatës, dashurisë për punën e të qytetarisë së brezit që vjen më pas.

Po me të njëjtin kujdes e përkushtim, autori shkruan për familjen të cilën me burrimin e kalimin e viteve e krijoi vetë. Sic thotë Dostojevski "Shpirti, dashuria, Zoti njihen dhe ndihen nëpërmjet zemrës, jo mendjes. Arsyeja është një vegël që drejtohet nga zjarri shpirtëror"

Faqet për bashkëshorten, dy vajzat dhe mbesën, Mabelin janë shkruar me zjarrin shpirtëror. Ja vlen ky zjarr kur flitet për Engjëllushe Shqarrit, që sot është përkthyesja më e mirë e gjuhës angleze në gjuhën shqipe. Njohëse e shkëlqyer e të dyja gjuhëve, ajo ka sjellë në shqip, kryevepra të letërsisë angleze dhe vecanërisht asaj amerikane, thesare të vërtetë të letrave botërore. Edhe dy vajzat, Klejta dhe Marsi, kanë një jetë të pasur aty ku jetojnë, në Itali dhe në SHBA, pasojë e arsimimit dhe edukimit, e shembullit prindëror.

Puna, shoqëria dhe njeriu

Faqet të tëra të librit i ze me të drejtë ajo që është thelbi i jetës së njeriut: Puna, mësuesit, kolegët e shoqëria.

Fituesi i Oscar-it, regjisori dhe aktori i madh italian Roberto Beninji shkruan: "Mund të mbyllni sytë për gjërat që nuk doni të shikoni, por nuk mund të mbyllni zemrën për gjërat, që nuk doni të ndjeni..."

Dhe zemra është e hapur për të përmendur emra tepër të njohur nga të gjitha fushat e jetës e të veprimtarisë shoqërore, që kanë pjesë në rrugën e jetës së autorit. Këtu rol

të vecantë, padyshim, ka luajtur profesioni i autorit. Gazetar i mirfilltë prej 57 vjetësh,(jo pak!), Ahmet Shqarri ka njohur e takuar figura të mëdha të vëndit e te botes. Përshtypjet e bisedat me ta kane zënë një vënd të merituar në libër.

Duke filluar me pedagogët e më pas miqtë e tij, të mëdhenjtë e letrave shqipe Ismail Kadare, Dritëro Agolli e Jakov Xoxa apo shkencëtarët e shquar të gjuhës Shaban Demiraj, Henrik Lacaj, Anastas Dodi, Remzi Pernaska etj. e deri gazetarët Hamit Borici, Agron Cobani, Petrit Kumi, Ismet Bellova, Besnik Dizdari e shumë të tjerë, emrat e të cilëve i gjeni në libër.

Vënd zenë edhe shokët e rinisë, që më pas u bënë figura të njohura të krijimeve letrare e artistike. Te tillë si Xhevahir Spahiu, Thanas Qerama, Zhuljana Jorganxhi, Paulin Selimi, e të tjerë janë personazhe reale, të përshkruar me vërtetësi dhe dashuri të madhe.

Koha, hapësira dhe njeriu

"Kur ke çfarë të kujtosh" është një libër me 240 faqe. Ai ka nxënë, pa asnjë sforcim, 80 vjet jetë, (jo vetmi, si romani i Markezit) por një jetë tepër të gjallë dhe aktive, plot ngjarje dhe njerëz, të njohur e të panjohur, që vinë në libër si një mozaik, ku secili është një gur i vogël për të plotësuar tablonë e një epoke të tërë. Sipas studiuesit poliglot Albert Karanxha: "...Ky liber i jepet në dorë lexuesit për ta udhëhequr në një udhëtim eksplorimi të jetës... Në fillim, tek mahnitja e fëmijërisë, tek formimi i të riut, lexuesit gjejnë gjëra të përbashkëta, por në vazhdim ai futet në hapësira ku HYRJA u rezervohet vetëm individëve me vlera të veçanta. Megjithë vendosjen e çvendosjen e shpejtë dhe e papërcaktuar e "pjesëzave" të kaleidoskopit ku vërehen figura nga më të çuditshmet, realitete që me historinë e tyre i shërbejnë jetës duke ditur të mbajnë drejtimin e rrugëtimit drejt së mirës... Në faqet e librit dhimbshëm ndjehet përshkrimi i jetësimit të Shqipërisë kur prindërve shembullorë si LALA, të detyruar të luftojnë nën atë absurditet u prishet e u shkurtrohet jeta..." E është një kohë e mbushur me ulje e ngritje të shumta, me vite të ngjeshur me gëzime, të papritura të këndshme, por shpesh dhe të hidhura, me shqetësime, e halle. Por mbi të gjitha me punë, sic shkruan një filozof i njohur Henry Èard Beecher: "Njeriun nuk e vret puna, por shqetësimet".



Ahmet Shqarri nuk ka ndjerë kurrë lodhjen, kur gjërat që bënte ju shërbenin njerëzve, publikut me të gjërë të mundshëm, sic është ai sportiv. Sic shkruan gazetari i njohur i radios dhe i televizionit Timo Luto..." është një rrjedhë jete me ngjarje pa fund që mbulojnë me plot të panjohura dhe dinamizëm, pothuaj gjithë globin...Fëmijëria është befasia me e bukur e librit, ku e gjitha kalon si në një film, plot mall e nostalgji për prindërit e tij të mirë, për shokët dhe qytetin e lindjes, Peqin, që megjithëse një qytet i vogël, kishte që ne hershmërinë e tij, një Kala' e Kulle Sahati, Kinema dhe pajtore për të udhëtuar dhe ku verës vallëzohej allafrënga!.. Me kete liber, Ahmet Shqarri pasuron historinë e jetës sone shqiptare, ne nje fushe me mjaft intensitet dhe ndjeshmeri..."

Vetvetiu në libër ka hyrë një hapësire shumë e madhe. Sepse i tillë ka qënë edhe objektivi i profesionit të tij. Si gazetar ai ka lëvizur në katër kontinente. Përshtypjet dhe takimet me personalitete botërore zenë një vënd të vecantë, që nga legjenda e futbollit gjerman Franz Beckenbauer e deri tek gazetarët e shquar italiane Bruno Vespa e Sandro Ciotti. Por edhe piktori ynë i madh Ibrahim Kodra, per të cilin ka botuar ndoshta shkrimin me te bukur për të.. Me nje stil tërheqës, flitet për qytete të mëdha e të vogla që nga Neë Jorku deri në Stalingrad e Soci, nga Pekini, Londra e Parisi në Tunizi, Kajro e Dubai. E është një hapësirë aq e gjërë sa i jep librit një dimension të vecantë, tepër tërheqës dhe interesant.

Ahmet Shqarri nuk është vetëm një gazetar sportiv. Asnjëherë nuk ka qënë vetëm i tille. Natyrisht në fushën e gazetarisë sportive ai ka dhënë, një kontribut të madh, të cmuar e të rrallë, si askush tjetër.

Themelues i shumë programeve e rubrikave sportive në radio dhe në televizion, komentator e opinionist i ngjarjeve më të mëdha sportive në vënd e në botë për afro 60 vjet me rradhë ku shkelqen në mënyrë të vecantë emisioni radiofonik i drejtperdrejtë "Nga njëra ndeshje në tjetrën", që mund ta quaj pa frikë si gur themeli dhe hapi i parë i lirisë së shtypit në vëndin tonë. Me të drejtë, faqe të tëra i kushtohen në libër këtij eventit, që, për kohën, theu shumë tabu e pengesa teknike e gazetareshe, të qëna e të paqëna.

Por, edhe pse thelbësore, kjo është vetëm një pjesë e jetës dhe e veprimtarisë së tij.

Ahmet Shqarri është edhe një analist i ngjarjeve shoqërore, kulturore dhe politike, skenarist filmash, ku ka fituar edhe cmime ndërkombëtare (në Milano, në Pekin dhe në Jakutsk të Rusisë, 100 km. larg Polit te Veriut), ideator, drejtues e moderator i një sërë të madhe programesh televizive, autor i shumë shkrimeve, të botuar në gazetata e revistat e shumta, të djeshme e të sotme, dhe, së fundi, edhe autor i dy librave me vlera tepër të vecanta për historinë e sportit shqiptar, por edhe për historinë e Radio Televizionit tonë të 60 vjetëve të fundit.

Librin e tij të ri "Kur ke çfarë të kujtosh" ka nje ndërthurje të bukur e plot kuptim të të dyjave.

Si një kineast i vjetër, gjithmonë kujtoj një thënie të regjisorit të madh italian Vittorio De Sika: "Nuk ka filma të mirë dhe filma të këqinj, ka vetëm filma të dobishëm dhe të padobishëm". Kjo mund të thuhet edhe për librat: "Nuk ka libra të mirë e të këqinj, ka vetëm libra të dobishëm dhe të padobishëm".

Libri i Ahmet Shqarrit "Kur ke çfarë të kujtosh" është një libër shumë i dobishëm.

Për çdo moshë, për këdo.


Kontaktin e parë me pikurat e artistit Krist Dimo, e kam patur ndërsa endesha virtualisht nëpër faqet e Facebook-ut. Kovid sapo kishte filluar dhe i mbyllur në shtëpi, si e gjithë bota, vrisja kohën duke u kotur nëpër rrjetet sociale. Sapo e vura re, më tërhoqi në radhë të parë stili abstrakt, minimalist, por herë herë edhe figurativ i këtij artisti tepër interesant durrsak. Krejt kurjoz, fillova të thellohesha tek vepra e tij piktorike. Herë herë, tek i vëreja, më dukej sikur po gjendesha përpara ca vizatimeve naive bërë nga një fëmijë, ose përpara atyre pikurave rupestre nëpër shpellat parahistorike, por kur i vëzhgoja me kujdes, atëherë ndihej qartë se ato ishin të medituara thellë, nga një artist tejet i përgatitur dhe tepër i kujdesshëm. Ato më shtynin të meditoja mbi nevojat më të thella shpirtërore që ka njeriu. Dukja e tyre naive, pra, nuk ishte veç një trill. Kur thellohesha, aty ku unë mendoja se gjithçka ishte një zgjidhje e thjeshtë, e pamenduar, linja të hedhura ashtu si nëpër gjumë, sikur të zhgaravisnim për të kaluar kohën, në të vërtetë fshihej gjithmonë një mesazh filozofik, një gjendje emocionale e mirë menduar, një dialog i thellë me vetveten. Gjurmët që Krist Dimo lë mbi telajo, janë sa origjinale aq edhe të shumë interpretueshme. Jane sa në dukje 'naive' po aq edhe të koklavitura dhe të "rrezikshme", apo të 'vështira' për t'u kapur, ndonjëherë. Ndaj, punët e këtij artisti, kanë nevojë për një përgatitje intelektuale, për një rimodelim shijesh, kanë nevojë siç shprehet ai vetë, për emancipim. Një emancipim, si në formën e shprehjes, të cilën ai e ka arritur, mbas vëzhgimesh të gjata dhe të thella, po ashtu edhe në përthithjen e mesazhit. Tek ai e 'shëmtuara' bëhet estetikisht e bukur, 'naivja' bëhet meditimi i thellë, 'thjeshtësia' transformohet në sintezë. Silueti i tij i shqetësuar shndërrohet gati në një ankth ekzistencial. Thjeshtësia, ironia dhe origjinaliteti, janë vetëm tre nga tiparet kryesore që unë vë re në veprën e tij.

Zgjidhjet e tij estetike me sfondet e zeza, të bardha, krejt të thjeshta, linjat e hedhura në një zbrazëti plot enigma, pikëpyetjet, gjëgjëzat me ngjyra; nuk japin përgjigje, por e shtynë shikuesin të futet në reflektime, të meditojë, të lodhet për të kapur esencën, thelbin e domethënjes. Kristi punon me atë pjesë të ndërgjegjes së tij e cila nuk mund të konkretizohet, as të deshifrohet me fjalë. Ajo i drejtohet shtresës së pandërgjegjes. Aty lind, aty zhvillohet, aty ndalet gati me këmbëngulje. Është ajo zona e ëndërrës, e imagjinatës, e intuitës, lënda bazë e shqetësimeve të brendëshme, ku pulsionet e artistit hidhen direkt mbi telajo dhe transformohen në një meditim të thellë mbi vetminë bashkëkohore, kaosin, deformimin e saj pse jo, edhe shpirtëror.

Ai don të flasë thellë mbi njeriun dhe e arrin atë. Arrin të evidencojë pjesën më të errët të qenies dhe të gjendjes njerëzore,

Një ekspozitë e artistit durrsak Krist Dimo në sallën e Kryeministrit

nga Artur Spanjolli



e cila është vetëm një degëzim në pemën tematike të artistit Dimo. Pemë, ku thelbësorja, trunghi pra, është kërkimi i pandërprerë i tij filozofik mbi ekzistencën.

Duke u marrë vetëm me figurën njerëzore ai don të ndalet tek dialogu-monolog që artisti bën mbi fenomenin jetë dhe e bën këtë në një mënyrë disi të pandërgjegjshme, ku ai arrin të denoncojë atë shkatërrim 'moral' jo vetëm të vlerave tradicionale, por edhe të vlerave të vetë qytetërimit të sotëm. Parregullsia

e formave, antikonformizmi i linjës në serinë e portreteve të Dimos, tregon qartë shpirtin e sotëm, frymën bashkëkohore. Kjo shumëllojshmëri profilesh psikologjike, shpall gjithashtu edhe dështimin e vetë njeriut. Duket sikur, njeriu i Dimos, sillet në një qark të mbyllur, të errët, ku shumë pyetje mbeten pa përgjigje, shumë përgjigje nuk janë të nxjerra nga pyetjet racionale, por nga intuata e tij artistike; ku shumë kërkime nuk të shpien asgjëkund dhe shumë hulumtime dështojnë. Por dështimi i njeriut të Dimos, është dështimi

i vetë njeriut, ndërsa orvatet të gjejë të vërtetën e tij. Dështimet e Dimos në planin ekzistencial, duke u ndalur dhe duke reflektuar mbi fatin e njeriut të sotëm, janë dështimet hulumtuese të një artisti, i cili nuk pret konkluzione, zgjidhje. Ai veç konstaton, vëzhgon, vë në dukje, atë çrregullsi, kaos, shqetësim që është edhe magma e brendëshme e krijesit. Linjat e tij plot zhdërvjelltësi, janë rebele. Ato nuk respektojnë as anatomicën e natyrës, as ligjet e fizikës. Janë linja të cilat kanë një domethënie shpirtërore. Deformimet e Dimos, janë akti i parë i rebelimit të artistit, i cili ndjek humorin e brendëshëm, ndjek pulsionin e emocioneve të tij. Interpreton pra njeriun, pasi e ka hulumtuar atë thellë dhe me kujdes. Ai, siç e thashë, nuk jep zgjidhje. Ai nuk është filozof me paketa të gatshme filozofike i cili pretendon të zbulojë të vërtetën. Ai me siluetat e tij provokuese, veç ngacmon dhe nxit reflektimim. Tek linjat agresive të figurave, tek sfondet e thjeshta dhe të errëta, tek ekspresiviteti i tyre shpesh i pakapshëm, qëndron edhe limfa jetësore e vërtetësisë së artit të tij. Është një art, ky i Dimos që komunikon direkt me pandërgjegjen, një gjuhë që i drejtohet emocioneve, ndjenjave, iracionales. Ai është një hulumtues i mprehtë i vetmisë, i braktisjes, i boshit të madh të njeriut. Tek vepra e tij mungon njeriu i Madh, i cili mbizotëronte me rregullat tradicionale trashëguar nga paraardhësit e tij. Këtu na vjen njeriu i shekullit tonë. Njeriu me misteret e tij, njeriu kompleks, njeriu i cili e ka humbur fillin dhe nuk orientohet dot, pra, ku ai e ka humbur edhe strukturën e tij. Do të bëja një analogji me tregimin e Franc Kafkës "Metamorfoza". I pari shkrimtar i cili me antenat e tij të mprehta vëzhguese, ka kapur kllapinë, ankthin, tmerrin dhe frikën e njeriut modern i cili do të shfaqej më pas. Jo rastësisht, tek vizitoja muzeun e Franc Kafkës në Pragë, gjeta disa vizatime të gjenit nga Boemja, të cilat, përnjëherësh më kujtuan tablotë e artistit durrsak në fjalë. Tek tabllotë e tij, unë gjej njeriun skllav të teknologjisë, të një moderniteti dhe konsumizmi, i cili ja ka marrë frymën krejt. Gati gati, skllav i një lirie aq të madhe që ai nuk është ndoshta në gjendje as ta zotërojë, as ta kuptojë dhe as ta përdorë atë siç duhet. Por gjithashtu, skllav edhe i një boshi të madh. Një bosh intelektual, që Dimo e ka perceptuar me shqisat e tij prej artisti.

Ai me artin e tij na vjen fuqishëm, drejtpërdrejtë. Dimo ka arritur të ketë një stil krejt origjinal, të tijin. Një stil që aludon, provokon, thellohet, mediton, ëndërron. Një stil plot pulsione jete, ku Dimo filozof me ngjyra dhe linja, na flet me poezinë e tij. Një poezi minimaliste, gati e padeshifrueshme, por gjithmonë e pranishme dhe e aftë të na nxisë në reflektime.

Ekspozita është hapur me 11 janar në COD, salla qendrore e kryeministrit.



Mes shumë botimeve dhe levrimit të Mdisa gjinive letrare, Stefan Çapaliku (1965) rigjen "fillin e tretun" të poezisë. Fillon pikërisht me të, në vitin 1993, me vëllimin "Asgjë më shumë se kaq s'ka ndodhë", për të vijue me "Kohë e ndalur" (1994) dhe "Fjalë për fjalë-Word for Word" (2000).¹

Së fundmi, rrëfen të jetë gjendë i rrethuem nga përmbajtje të reja e të ketë asistue pamundësinë e mosshkruesjes së një vëllimi të ri poetik.

A mund të jetë njeriu i këtyre vargjeve ndër ma të brengosunit e mesit tonë?

Stefan Çapaliku ka kohë që s'pushon. Ndjek karrierën plot energji. Boton pa ndalje. E fundit herë, për momentin: "Camera obscura". Në promovim ai i "detyron" spektatorët të sillen kryeposhtë për të pa nga kamera e tij. Ndërsa vazhdon jehona e vëllimit poetik, nuk i dihet se në ç'pikë ndodhet botimi tjetër. Frena – gaz, ç'ndryshim kanë! Çapaliku e kërkon lavdinë dhe këtë e zgaqë. Gjithashtu ia persërit vetes me pauza të konsiderueshme ndërmjet: "Gjithçka është e lejueshme!" "Por gjithçka nuk ka hije!" "Gjithçka është e lejueshme!" "Por gjithçka nuk ndërton!"². Megjithatë katërsh bahet se e len të veten pa e çue në vend. Ai e ka nda mendjen për t'ia trazue plogështinë oborrit. Mund të jemi krejt jashtë loje, të mos e kuptojmë fare, t'i heqim edhe vërejtje. Me në mend fushatat e tij vetëpromovuese veri-jug & mbrenda-jashtë, kur e takojmë dhe e përballim me këtë, s'vonojmë të lëkundemi. Ndrysh nesh, ai ka një vetëdije tjetër në lidhje me ambicien, çastin, ngenë, kolonën vertebrore etj. Ai e din se mundësia nuk mbetet mundësi. Deri spijuni i lagjes s'e ka ma shëndetin e dikurshëm.

spijuni i lagjes sime
ishte një burrë i shkurtër
i shëndoshë
viente pak nga kolisteroli
dhe pak nga glicemia

spijuni im i lagjes ishte
i ushqyem keq
ai kurrë nuk pati mundësi me ba
gjimnastikë
me hy në një palestër

spijunit të lagjes sime iu desh
ma kalue netët jashtë
me përgju në të ftohtë

spijuni i lagjes sime vuen
edhe nga reumatizma
ai s'mund ta veshë lehtësisht xhakëtën
dhe as ta vendosë pistoletën
aty ku nuk shihet³

Duket se autori ka mësue t'i numërojë ditët për të fitue një urti gjithnji e ma në zhdukje. Ka gjasë që njeriu i 69 poezive (mes tynë 1 poemë), megjithëse ndër ma të përmbushunit, të jetë ai që dhemb. Tjetërkush, i të njëjtit qytet, ka qenë "trishtimi i botës"⁴.

I mbushun me dhimbje

ndej një dhimbje
pa përmbajtje
si të ishte një simfoni
dhe ndjehem idiot
i lanë vetëm në fushë
i lagun nga të gjitha shinat e botës⁵

¹ Të gjitha poshtëshënimet i referohen daljes së parë nga shtypi të këtij vëllimi (Enti Botues "Gjergj Fishta", 2024), përveçse ku tregohet ndryshe.

² Përk. Filipaj, S. *Bibla* (1 Korintasve 10:23). Tiranë, 2011.

³ Camera obscura V (f. 127).

⁴ Rreshpja, F. *Në vetmi* (poezi të zgjedhura), f. 120. Tiranë, Arbëria, 2004.

⁵ F. 81.

Variacione mbi temën "Camera obscura" të autorit Stefan Çapaliku

Nga Arben V. Shala

(K)apaliku asht një brengë, një sheshpërplasje, një "Death Race" (2008), një sirenë alarmi nate që s'di ku fiket, një platformë idesh pa fund mes ditësh me numërim, mes shqiptarësh pa durim kur duhet pritje, tek hahen me vete rrasë kthinës së aeroportit, për t'u thirrë disi me emën, për të fundit herë.⁶

aeroporti asht i mbushun
me njerëz që vrapojnë që ecin që rrinë
unë hy te ata që vrapojnë
se vi prej shqipnie
e si t'mos jem me ngut

shkoj në Palermo
gate a83 në fiumicino

do doja shumë
që të isha të paktën te ato që ecin

⁶ Finibus terrae (f. 119). Shprehja latine fjalë për fjalë do të thotë "në kufijtë e tokës". Termi tregonte zonat ma të largëta periferike të Perandorisë Romake, që shtriheshin deri në kufijtë e njohur gjeografikë të asaj kohe.

As që ia lejon vetes të mendojë se mund të jetë mes atyne që rrinë, ndjekin një flash mob tek shpaloset papritmas, rivizitohen nga dy fjalë me të cilat janë përcjellë te pragu e tretën paksa, por pa rrezikue. Sikur ai të habitej aq sa t'i ikte fluturuesi, ok; por ai edhe do të rendë, edhe s'do të kapë gja. Sepse se ç'ka një lloj fati historik shqiptar që e gjurmon. Një sistem që e njeh menjëherë. Ai asht vonë, për rrjedhojë vrap; ai turret, për rrjedhojë se ndien shallin që i bjen (plus shurra që jo vetëm i vjen, por i duhet edhe ta mbajë).

një altoparlant
më thërret emnin
signor kapaliku
mister kapaliku

vrapoj sa mundem
gate a83 asht fundi i botës

Autori asht vetë një shumëfluturimsh,
me ma shumë ikje se paraqitje, një fund bote
ku me të vërtetë bota, jonë, merr fund.



pa orë

se unë jam një stacion
ku kalojnë pa fund
ide
andrrime
brenge
prapë ide
ndonji koncept
apo projekt
ndoshta

unë jam një stacion pa orë muri
pa kohë të matshme
pa tabelë oraresh
prandaj në kokën time
idetë përplasen me dëshirat
brenge me pamundësitë

unë jam një sirenë alarmi
që gjithë kohën ulëret
jam një gjysëm dritë e gjysëm terr
që rrotullohet e rrotullohet
e s'di me u ndalë⁷

nothing to declare

nuk e di a duhet të ndaloj
për të deklarue
se kam vetëm dhimbje
kujtime
se jam i mbushun
me boshllëk
se jam përplot me marrzi
se ndjehem duke plasë dëshirash

apo të kaloj ngarku me to
pa i thanë askujt asgja
nëpër shtegun e vetëm
që më kanë hapë⁸

Ai pëlçet e përplaset me një vend të qetë me ngjarje mungesën e saj⁹. Nga se? Nga një padije e gjanë; prandaj s'i mbetet veç me u riinstalue në kapsulën e një trupi të ri¹⁰. Mbase pa e kuptue as vetë, ai nuk po kërkon aq me shkruie libër-libër-libër, sa me u ba vetë një - liber. Dhe libri vargshëlbus mund të jetë ky trup i ri.

du një trup në të cilin të fshihem
ku të mos munden me më gjetë
një trup që të mos munden me më prekë
një trup që ta kenë frikë

Poezia e tij vjen me një PA të madhe. Një tematikë e larmishme, grupue nën 10 tituj, që përshkohet nga një fill mungese. Pa, si parafjalë dhe element fjalëformues, e shpeshpërdorun sa e nënkuptueme, asht për bamëse e vazhdueshme e landës së parë, viktima e shkrepjes së rradhës, e kundërta e andrrës¹¹. Pa, sepse mbizotnon paplotësia, përkryhet papërsosunia. Mungojnë: gjendje dhe realitete, njerëz e fjalë bazë të dashnisë, kohë e vëmendje, orientime e data, shkarkime e lehtësime, diç hyjnore e njerëzore, shpresë dhe fat, krena e kthime, përshëndetje e fishkëllima, kujtesa e kallëzime. Kështu ti je mes të mbeturve,


⁷ F. 10

⁸ F. 42.

⁹ Indulgjencat e reja (f. 48).

¹⁰ Një trup (f. 7). Kjo poezi nuk ndodhet rastësisht e para.

¹¹ Androj (f. 9).



kategoria: të pamundunit. Dhe vendi asht shumë i qetë, aq horizontal, me ca puls tek-tuk, me ngrohje, mësue me mungesën e vet.

Çapaliku asht i pranishëm kur merren mungesat, por dita e tij asht përplot mekje e mbytyje, myk e ndryshk¹². Dita e tij e re asht shumë e vorfën, i vjen fundi menjherë. Tue mos tregue asgja prej saj, ia ke përmendë tana randësinat¹³. Dhe vjen fill e nesërmja, gjithmonë e hane¹⁴ ose dita ma e vështirë e shekullit për shkodranët. Po, dita e tij mundet me nisë ma trime jashta shpijet, ndër dhoma hoteli, ku tavani të thithë drejt një vetëvrasje ideale¹⁵. Dita ka shans të lexohet sa ç'mund të lexohen prej nesh sytë e të smundit. Imbushun në dhimbje, ai edhe këtë e ka pa përmbajtje. Në vendin e tij edhe mungesës i përtohet të mungojë. Nji prehje së cilës askush nuk i vdes¹⁶. Të vjen që edhe sezonën turistike ta lexosh zezonë (nuk e di nëse kjo ndodhë dhe me ju, të dashtun lexues)¹⁷.

Kjo mbetet cilësia e të sotmes së tij. Por shikoni në daçi të djeshmen; edhe ajo pa formë¹⁸. Po kështu e nesërmja; nuk i qitet as qenve¹⁹. Të vetmet të qeshuna të saj janë ato o prej hallit, o prej pijes. Sikurse nuk ka mort pa gaz, nuk ka as shkodranë. Bashkëqytetarët e tij s'e kanë ndalë gazin në ditë ma të këqija se kjo, teksa në dopion nr. 4, shiu fillon e bjen me emna²⁰. Mes mungesash të shumta nuk ka si mungon sarkazma. Notat maxhore numërohen me gishta në këtë album fotopoetik, tek tenton me "vra" (fotografue) dikë e del selfie. Dhe për kulm dikush i propozon edhe me dashtë kë me dashtë:

ai do që unë ta lëpij yllin e kuq
në vend të organit seksual femnor²¹

Autori e mban lexuesin afër në këtë rrugëtim të mbrendshëm, përjetim origjinal, njohje të vetvetes. Tashma i ka dalë doret e i asht ba deri autor. Autori fillestar vjen aq personal, ia ndien frymarrjen, me lirizëm të përkorë. Rrallë abstragon në përhumbje të largëta, ku të mbetesh pa sinjalistikë. Vargjet janë të rrjedhshme, pa sforcime dhe kjo asht një e njoftun e arritun me kohë në prozën e autorit. Ka zgjedhë t'i shtypë shkronjat të gjitha të vogla dhe pa asnji pikësim në to, por shpejt mësohesh dhe nuk të përshtyp gjatë. Çuditëse se si aq lehtë u kaloka nga një sistem sistematik betoni tek një pa rend, ku të gjithë janë të barabartë, por jo në fakt. Dirigjimi i nëntëshëm ban që ritmet të përkojnë e kjo lot rol. Kjo mund të jetë meritë ose vetëm e autorit, ose e të gjithëve shqiptarë për t'i dalë zot kaosit me "na e len ne at punë".

Nuk përdoren fjalë të rralla, fjali të gjata me tepër nënënditje e as togfjalësha e struktura të ndërlikueme për të gjuajt nalt e me shasme. Shkrimi nuk vjen me zor, çfarë tregon se ky stil të shprehuni nuk asht larg mënyrës së komunikimit natyral të autorit me letër dhe njerëz në përditësi. Fshahet randë, me delikatesë. Nganjherë mund të nxjerrësh një wow! Vini re p.sh. ç'efekt krijojnë përshkrime pa peshë e pa të ardhme, por që i shohim për herë të parë në letër, si në fillim të botës (ajo qe "me këmbë të zbulueme poshtë një fustani blu..."; djali "nxori krahët e vet jashtë dhe mbylli dritaret"). Provo vetë ta lexosh në kontekst²². Për mjaft arsye këto krijime mund të shijohen me andje nga një spektër i gjanë lexuesish, nga elitari deri diku tek profani.

Autori mbetet natyral, e ka afër koshin për artificet, me inteligjencë shmang

reklamimin e vetvetes bezdisëse për të ngritë fjalën. Pikë e fortë janë asociacionet, loja e ardhjes bashkë në mendje dhe imagjinatë e ideve të caktuara në një superçast të vargut.

Autori nuk ia lejon vetes të përfitojë lehtë nga ndonji epërsi a fortësi e gegnishtes. Nuk apostrofon për të ngranë zanore mbas interesit aty për aty, duke demonstrue ksisoj kontroll të forcës, ndërsa reflekset e motit mbeten ("derisa t'mund e shpluhnosim").²³ Ka komoditetin e ramjes në fashë në një koine gjuhësore që jep e merr ma së miri, por s'ka kohë me teorizue për këtë, sa ma fort me e përdorë si në "Camera obscura".

Nji mision me kohë i autorit asht ai i të qenit dëshmitar i epokës, me mujtë me plotësue vakumet e trashëgueme nga brezat, tue konsolidue një traditë për të ardhmen. Pra, në emër të memuarit "shkrueje atë që nuk duhet të harrohet".²⁴ Qoftë edhe si ndjesi, përveçse fakt. Mund të na befasojë ende Platoni tek pohon se "poezia asht ma afër të vërtetës njerëzore sesa historia". Prandej:

du ta dëshmoj jetën time
si dhe kur ndodhë²⁵

Përndryshe "franz jozefi" im zhduket për një natë të një dite pa datë²⁶. Dhe askujt si bjen ndërmend. Sepse pikërisht po fokusonim të shtrenjtën tonë frymarrje teksa "ditët e pushimit kishin diçka prej ushtrie"²⁷. Gjithçka, gjithçka tjetër kishte ma randësi.

nuk e di pse imagjinoj që
ishulli im vdiq ditën kur
njerëzit nëpër botë qenë të habitur
se marinsat amerikanë
patën vra osama bin laden
se kish shpërthyer pranvera arabe
se estonia zyrtarisht adoptoi
monedhën euro
se mori fund referendumi
për pavarësinë e sudanit
se india fitoi kupën e botës në kriket
se festivalin e european e fituen
kangtarët nga azerbajxhani
se dha dorëheqjen
presidenti hosni mubarak
se tomas tranströmerit iu dha çmimi
nobel

Ku ishe ti kur vdiq "franz jozefi" yt? Ky "franz jozef" asht dhe qyteti yt, dhimbja e tij, dinjiteti në mos për jetë, të paktën për një "vdekje të përsosun".²⁸

Ky "franz jozef" asht edhe vetë thithja e jetës tande, tragjikja finale. Një libër - trup i ri - ku përmbrenda asht shkruar emni - u dashka për të gjithë, në këtë vend, në këtë ditë.

Shpresojmë "negativi" i këtij botimi të sillet mbarë. Sepse kjo asht gjendja. Ju flet Shkodra:

lumturia nuk ndjehet mirë
durimi po nxitohet
besniku tradhëtoi
kujtimin e çmendit harresa
gëzimi po rri trishtueshëm
fitimtari humbi pjesën e parë
shpresa vdiq e para
mos kujto se të harrova
pikë

çelikut i vrasin këpucët
soses i erdhën ato
pikë²⁹

27.12.2024

²³ Në bodrum (f. 106).

²⁴ Allende, Isabel; Zinsser, K. William. *Paths of Resistance: The Art and Craft of the Political Novel*, Houghton Mifflin Harcourt, 1989.

²⁵ Pa orë (f. 10).

²⁶ Requiem për Franz Jozefin (f. 36). Në nder të Franc Jozefit I të Austro-Hungarisë, hartografë austriakë i vunë emrin e tij një ishulli të vogël në grykë të Bunës (1870). Ishulli nuk eksizton nga viti 2011.

²⁷ Babiloni heshti (f. 26).

²⁸ Camera obscura I (f. 121).

²⁹ Shishe në det (f. 39).

¹² Kjo ditë (f. 88).

¹³ Dhe Zoti fali një ditë të re (f. 54).

¹⁴ Duke pritë të hanën (f. 56).

¹⁵ Dhomat e hoteleve (f. 15).

¹⁶ Rapsodia hungareze (f. 60).

¹⁷ Atdheu gatitet për sezonën turistike (f. 34).

¹⁸ E djeshmja ime (f. 90).

¹⁹ Dita ime (f. 87).

²⁰ Te klubi përballë (f. 30).

²¹ Dikush do me ma kthy kryet mbrapsht (f. 115).

²² Kujtim feminije (f. 108).

Shkëputur nga 'Libri i Gjyshes'

SADIK QAKA

'gjyshja nuk thotë asgjë'...

ujt teposhtë, djali përpjetë
ujt teposhtë, djali përpjetë
ujt teposhtë, djali përpjetë
gjyshe,
a e din çka janë liqenet lumore?

*
në dërrasë vizaton një lum që
përkulet
ai thotë: një liqen lumor është një
liqen
në formë të grepit
që krijohet kur kthesat e mëdha të
lumenjve
ndahen nga shtrati kryesor
*SI FORMOHEN LIQENET LU-
MORE?*
kur lumi rrjedhë nga bjeshkët në
një fushë
ku toka është prej baltës së butë
lumi formon kthesa të mëdha të
quajtura *GJARPËRIME*
kjo për shkak të fenomenit të
EROZIONIT
ku rrjedha e lumit
pra uji në lëvizje
gërryen tokën e butë

*
lumi duket
si një gjarpër
që lëvizë andej këndeje
por nëse rrjedha
gërryen një kthesë tepër të lakuar
lumi krijon një udhë të re
të drejtë
nji liqen lumor është një lum që
nuk lëvizë
nji lum i braktisun
zorra qorre e lumit, e hequr

*
ai thotë: gjyshe
nji koleg në oslo
më ka treguar për një tjetër lum
përmes projekteve të infrastruk-
turës
dhe proceseve të modernizimit
është ndryshu shtrati i lumit
lumi është çu në vende
ku nuk ka rrjedhë më herët
nevojitet vetëm një përmbytje
dhe lumi vërshon shtëpitë
gjen shtratin e vet të vjetër
nevojitet vetëm një përmbytje
dhe lumi kthehet në shtëpi
gjyshja nuk thotë asgjë



Po sidomos ata të dy lëshuan klithma të vogla admirimi, kur ai, mes punëve të tij, u tregoi një pikturë të madhe të një vajze lakuriq.

- Bah, ç'femër!

Sytë e tyre përpinë me lakmi çdo centimetër katror dhe ai, për një çast, provoi një ndjenjë të keqe dhe deshi ta mbështillte përsëri pëlhurën, por ata iu lutën ta shikonin edhe pak. Pëlhura ishte shtrirë në dysheme dhe ata nuk e pyetën më për asnjë kureshtje nga jeta jashtë shtetit, por vazhduan të përpinin me sy vajzën e re, që kishte ulur kokën e menduar mbi supin e saj të djathtë dhe ishte e gjitha e freskët dhe e bardhë.

- Ishin të bukura të gjitha modelet? - pyeti njëri.

- Si të qëllonin, - u përgjigj ai i mërziur dhe ndezi një cigare. Pastaj u afrua te dritarja dhe vështrroi përjashta se si binte shiu i imët, duke formuar gropa të vogla në oborrin e shkretë.

Ata qëndruan dhe pak dhe, duke vështruar flokët e tyre të lyer me brilantinë e të lëpirë, ai ndjeu edhe më shumë mërzi dhe shokët e fëmijërisë iu dukën më të largët se kurrë.

Njëri, ai që kishte lënë mustaqe, e pyeti për një artist kinemaje, po piktori nuk e kishte dëgjuar atë emër dhe në sytë e tjetrit kaloi një nënqeshje habie. Pastaj e pyetën për diçka tjetër dhe ai u mërziur edhe më shumë. Me sa duket, ata e kuptuan dhe u ngritën.

- Do të dalësh, besoj, - tha ai me mustaqe, - në klub na gjen çdo natë, te bilardoja.

- Po, po, - tha piktori.

Dolën nga porta e vogël e oborrit, me çadrat e hapura dhe piktori vazhdoi të vështronte se si pikat e shiut të imët binin në oborr, te hauri i vjetër mbuluar me letër sere dhe mbi mbulesën prej llamarine të pusit me çikrik.

Kur u kthye, pa valixhet e hapura dhe në dysheme pëlhurën gjysmë të mbështjellë të vajzës lakuriq.

Duhet ta ndreq disi dhomën, mendoi. Kjo do të ishte studioja e tij, megjithëse qe e vogël, ishte e qetë dhe e këndshme, me dy dritaret, ku e ëma kishte vënë vazo me lule mbi parvazet e gdhendura.

Vendosi në mes të dhomës kavaletin dhe pastaj vari përballë dritareve dy pëlhura të tij. Pikturën e madhe të vajzës e vari në murin tjetër dhe një copë herë trazoi valixhet dhe renditi librat në një raft.

Pastaj u ul në një shezlong përballë dritares dhe po vështronte shiun. Nga kuzhina dëgjohej zhurma e enëve dhe e heqlave prej druri të nënës e të motrës. Trokitja e tyre nëpër shtëpi ishte një zhurmë kaq e njohur për veshin e tij. Kjo ishte për të si një mors i fëmijërisë, që i rikujtonte një tok gjërash të harruara. Ishte po ajo trokitje e vjetër e heqlave të nënës dhe trokitja e mëvonshme e së motrës, që ai i dallonte gjithmonë nga njëra-tjetra dhe, megjithëqë nuk ishte i prirur ndaj tingujve si ndaj ngjyrave, vuri re menjëherë një ndryshim: ato të nënës ishin bërë më të ngadalta dhe më të shkoqura, kurse në trokitjet e së motrës ndihej një bujë dhe një shpeshti e fshehtë, e panjohur, që ai nuk e kapte

ISMAIL KADARE

Nudo

Tregim



dot mirë, por e ndiente.

Ja, po vjen nëna, mendoi, duket që është lodhur nga vitet, po vjen të më thërrasë për të ngrënë drekë.

E ndjeu se si dera e dhomës u hap pas tij dhe tani nëna do t'i thoshte frazën e vjetër, po aq të vjetër sa e gjithë kjo shtëpi: "Eja të hash, dreka u bë gati."

Po, ishte koha dhe një minutë më parë babai kishte hyrë në oborr, duke mënjanuar çadrën te porta dhe, me siguri, tani lante duart.

Nuk e kuptoi ç'e shtyu, ndoshta, vonesa e frazës së zakonshme të nënës apo, ndoshta, ndonjë gjë tjetër dhe ktheu kryet dhe buzëqeshi. Nëna ia kishte ngulur sytë e mahnitur pikturës së madhe të vajzës lakuriq. Ai u ngrit dhe eci nëpër dhomë.

- Ç'është kjo leshprerë, mor bir? - pyeti nëna.

Ai qeshi dhe i ra supeve, duke e shtrënguar në njërin krah.

- Gati është dreka, nënë?

- Po, - tha ajo me një zë të hutuar pak dhe e vështrroi djalin me dhembshuri. E njihte mirë këtë vështrim të nënës së tij. Madje, e njihte më mirë, sesa trokitjen e heqlave të drunjtave të saj. Ajo e vështronte kështu kur ai ishte i sëmurë apo i mërziur, apo kur kishte ndonjë hall. Dhe tani e vështrroi pikërisht kështu, sikur po e pyeste: "Ç'pësove, mor bir, mos je gjë sëmurë?"

Pastaj e vështrroi prapë pikturën në mur dhe doli.

I bëri përshtypje nudoja, tha ai me vete, duke ndier të njëjtin vështrim të nënës në tryezë, po s'ka gjë, do të mësohet. Po hanin në heshtje dhe babai tek-tuk thoshte ndonjë fjalë, si zakonisht, nga jeta në zyrë, kurse e motra dukej që s'e kishte mendjen atje. Sytë e saj ishin bërë të avullt dhe nuk

vështronte më drejt, po diku anash.

Ndoshta, ka ndryshuar kështu që kur është fejuar, tha ai me vete. Po nuk kuptohej ishte e gëzuar apo jo për fejesën. Sytë e saj ishin si qelqi i fotoaparitit kur nuk është në fokus. Sidoqoftë, kishin një shprehje të veçantë dhe ishin të qartë në turbullimin e tyre.

E vështrroi për një kohë të gjatë të motrën dhe pastaj tha ngadalë:

- Ke dëshirë të të bëj një portret?

- Kam, - u përgjigj vajza.

- Mirë, do të ta bëj ndonjë ditë. Si e do, me ngjyra vaji apo me tush?

- Si të duash ti.

- O Perëndi, - murmuriti nëna dhe desh i ra luga nga dora.

- Ç'ke, nënë?

- O Perëndi, - murmuriti ajo prapë. Pastaj filloi të mblidhte pjatat, babai shkoi të shtrihej, ndërsa motra po pastronte tryezën.

Ai po e ndiente se babai e vështronte tani pak si ndryshe dhe në shikimin e tij, bashkë me dhembshurinë, përzihej herë-herë një shprehje pezmi.

- Nga shkaku i kësaj pikturë që ke varur në mur, - i tha një ditë e motra. - Atyre nuk u pëlqen që ti je marrë me një gjë të tillë dhe aq më tepër që e ke varur në mur.

- Ashtu? Po ajo është punë e shkollës, të gjithë ashtu bëjnë.

- Po ku e dinë ata?

- Aha, prandaj babai nuk hyn kurrë në dhomën time.

- Ai më ndaloi dhe mua të hyj këtu, - tha motra.

- Ashtu?

- Ata janë shumë të shqetësuar, - përsëriti motra.

- Marrëzira, - tha ai. - E ç'u duhet atyre se ç'kam varur unë në mur?

- Nuk është vetëm aty puna, po,

sidoqoftë, bota mund të flasim, nuk është mirë.

- Cila botë? Ç'i hyn në punë botës se ç'kam varur unë në mur!

Ajo nuk foli dhe përsëri uli sytë e saj të turbullt, të bukur.

- E di? - tha ngadalë. - Kjo bisedë është bërë edhe në shtëpinë e Seitit dhe atyre nuk u pëlqen kjo gjë.

- Ç'hyn këtu shtëpia e Seitit, ç'hyn këtu i fejuari yt?

- Po ata e morën vesh këtë gjë të dielën, kur Xhixhia kaloi pas buke përpara dhomës tënde dhe dera ishte e hapur, - tha vajza. - Për drej, ajo e pa dhe, siç duket, ka treguar ç'ka parë.

- E pastaj?

- Seiti tha se kjo nuk ishte gjë e mirë dhe nuk e mbaj mend ç'tha tjetër, po foli gjatë.

Ai ndezi një cigare dhe e ndiente që po bëhej nervoz.

- Po ti, ç'i the?

- Ç't'i thosha? Asgjë!

- Shkrepëse mizerje, - murmuriti ai, duke ndezur cigaren.

Kaluan ca çaste në heshtje.

- Ti e do Seitin? - pyeti ai papritur.

Vajza uli kokën dhe vështrroi një copë herë qilimin, pastaj e ngriti dhe sytë e saj ishin më të turbullt se kurrë.

- Jo!

Kurse zëri i saj, në kundërshtim me sytë, ishte i vendosur dhe ai e ndjeu se ajo që thoshte ishte e vërtetë dhe se motra e tij kurrë nuk e kishte dashur të fejuarin.

- Po pse u fejove, atëherë?

Ajo nuk u përgjigj.

Ai rrinte në shezlong dhe sytë i shkuan te piktura e madhe. Qëndruan një copë herë kështu, në heshtje, asaj i vinte turp të ngrinte kokën e të shihte vajzën lakuriq, ndonëse, kur ishte vetëm në shtëpi, e kundronte shpesh.

Kurse ai e vështronte pikturën dhe, papritur, iu kujtua nata kur e kishte takuar vajzën modele rastësisht në tramvaj dhe ishte hera e parë që e shihte të veshur, madje, të veshur trashë. Kjo kishte ndodhur disa muaj pasi kishte bërë pikturën dhe që atëherë ajo nuk pozonte më. Ai qe gëzuar shumë që ajo ishte e veshur dhe që nuk pozonte më. Dhe binte një dëborë e tillë, e bukur, e ngrohtë...

- Ç'të bëja? - tha papritur motra, duke ngritur sytë nga qilimi. - Duhet të fejojesh me një njeri, apo jo? Si mund të kundërshtoj? Ti e di ç'bëhet po t'u kundërshtosh atyre.

...Kurse, kur e puthi te hyrja, atij iu duk se po puthte diçka të njohur dhe mendoi se ishte më e lehtë t'i puthje, sesa t'i vizatoje buzët e saj...

- Apo jo? - tha motra. - Ti nuk më dëgjon?

- Më fal, s'e kisha mendjen. M'u kujtua diçka.

- Ty gjithmonë se ç'të kujtohet, dinak.

Ata qeshën me gjithë zemër fare kot dhe ai tha papritur:

- Shkojmë në kinema?

- Shkojmë! - gati sa s'bertiti ajo nga gëzimi. - Unë vdes të shkoj me ty në kinema.

Tek ecnin për krahu, ajo çuquriste pa pushim. E ngacmonte për vajzat e atjeshme, e pyeste a kishte ndër mend të

fejohej, së fundi, i tregoi se, kur ai i kishte thënë se donte t'i bënte një portret, prindërit ishin tmerruar, ngaqë kishin kujtuar se do ta pikturonte nudo...

Dëborë po binte në oborr flokë-flokë dhe pullazi i haurit nuk dukej më i zi. Ai vështronte flokët e dëborës mendueshëm. Dera e oborrit u hap dhe që pas saj ai pa se si hyri hoxha me të shoqen. Xhybja e vjehrrit të ardhshëm të së motrës dukej edhe më e zezë në fundajën e dëborës.

E diel e mërzitshme, mendoi. Duhet të gjej ndonjë shkak të dal për drekë. Kush rri me ta në një tryezë. Po çudi, pse nuk erdhi dhe Seiti. Ai vinte gjithmonë të dielave për drekë me ta. Sa i zi dukej hoxha në dëborë.

Mendoi diçka dhe qeshi me vete.

Do të acarohen, tha me vete, por unë do t'ia tregoj vetëm motrës.

Mori një letër të bardhë dhe filloi të bënte skica. Pastaj u ngrit, veshi pallton dhe doli.

- S'është mirë të ikësh, - i tha nëna.

- Kam punë, nënë.

Dëborë vazhdonte të binte e thatë dhe e pastër dhe në çdo kënd rrugice femijet kishin zënë pusi dhe gjuanin kalimtarët. Ai luftoi me topa bore me një grumbull vocërrakësh dhe e ndjeu veten të gëzuar. Në Shtëpinë e Kulturës gjeti shokët e tij të rinj, me të cilët shoqërohej kohët e fundit, dhe të gjithë bashkë shkuan në kafene, në qendër të qytetit.

Kur u kthye, ata kishin ikur. Dëborë kishte pushuar dhe në shtëpi ishte qetësi. E ndjeu se kishte ndodhur ndonjë gjë e vogël, nga ato qindra ndodhitë e vogla të mërzitshme, që mbushnin shtëpinë e tyre në ditët e gjata monotone.

- Dëgjo, - i tha babai, ndërsa ai po zhvishte pallton. - Dua të bisedoj me ty. - Fol, baba!

Nëna bënte çorape dhe e motra hekuroste mbi tryezë. Ai vështronte se si vajza provonte hekurin e nxehtë duke lagur gishtin në gojë, me atë lëvizjen e saj të pandryshueshme.

- Bota flasin, - tha babai i ngrysur.

- Nuk të kuptoj, baba, ku e ke fjalën.

- Jo, ti më kupton ku e kam fjalën, - tha me zemërim babai.

- Nuk të kuptoj.

- E, pra, po ta them, e kam fjalën tek ajo... që ke varur në mur.

- Ah, po.

- Kështu nuk bën, more djalë. Nuk bën të marrësh kështu nëpër këmbë prindërit e tu dhe nderin e familjes. Hiqe atë djall nga muri!

Piktori nuk u përgjigj menjëherë, sepse e ndiente se po nxehej dhe nuk donte të grindej me babanë.

- Nuk e heq, - tha.

- Bota flasin, - vazhdoi babai, - dhe njerëzit kanë të drejtë të flasin. Ata mendojnë shumë gjëra dhe kanë të drejtë. Të afërmit e Seiti nuk po na vijnë më për vizitë.

- Ashtu? - tha piktori. - Aq më mirë.

- Ty aq të bën, sigurisht, po duhet të mendosh për nderin e familjes dhe mos harro se ke dhe motër.

- Ç'punë ka motra me pikturën time?

- Në qoftë se ke vendosur të marrësh nëpër këmbë emrin tënd, së paku,

mendohu për të ardhmen e motrës sate, - tha babai.

- Tani po e marr vesh, - tha piktori. - Sigurisht, ka llapur ai hoxha.

- Së paku, fol më me nderim për një burrë të ndershëm, të shkuar nga mosha, së paku, përpara motrës sate.

- Nuk dua që në punët e mia të fusin hundët hoxhallarët, këta paçavure, këta...

- S'ke turp, - thërriti babai.

- Nuk kam turp.

- Me babanë tënd flet kështu ti, i pahair, ti që të kam ushqyer me bukë dhe, për se pa, për një kurvë të huaj?

Nëna zuri kokën me duar.

- Ju të gjithë i bini fyellit të hoxhës.

- Haram e paç bukën time! - ulëriu babai dhe ai nuk e dëgjoi më se ç'tha tjetër, sepse doli duke përplasur derën dhe hyri në studio. U ul në shezlong dhe nisi të vështronte dëborën e madhe dhe të qetë përjashta. Një sorrë e zezë kishte qëndruar mbi çikrikun e pusit dhe çatia e haurit dukej krejt e bardhë nga dëborë.

Nuk të duan, tha me vete, duke iu drejtuar pikturës, ç'u ke bërë që nuk të duan?

Ne po shkonim rrugicës së ngushtë, mbështjellë të dy me pallto, si dy qyqarë.

- Përveç këtyre, mendoj të paraqes edhe një akuarel, - më tha piktori.

- Kur mbaron afati i paraqitjes për

ekspozitë? - e pyeta.

- Për dy javë, por unë pothuaj i kam përfunduar të katra punët. Dua të marr mendimin tënd, sidomos për njërin.

Unë nuk i njihja rrugicat e këtij qyteti të vogël, ndonëse ishte hera e dytë që po vija aty me shërbim.

- Ja, këtu, - tha piktori. Shtyu flegren e një porte dhe hymë në oborrin e vogël të shtëpisë përdhese. Një vajzë e hijshme po rrotullonte çikrikun e pusit.

- Motra ime, - ma paraqiti ai.

Kaluam mesoren dhe hymë në studio.

- Ulu, - tha dhe më tregoi një fron.

Në studio ishte ai çrregullimi i zakonshëm, i gjallë, që mua më pëlqente gjithmonë dhe ndihej era e ngjyrës së freskët. Të mbështetura pas murit po thaheshin dy telajo që, siç dukej, ai i kishte përgatitur një ditë më parë. Muret qenë mbushur plot me piktura dhe skica të varura gjithkund.

- Njëra është kjo, - tha ai, duke më treguar një nga pikturat ku qe vizatuar një hoxhë, që ecte me kujdes mbi dëborën e bardhë. Unë u ngrita dhe u mënjanova pak për ta parë më mirë.

- Më pëlqen, - thashë, - megjithëse nuk marr vesh shumë nga piktura. Po më pëlqen, ngaqë ke mundur ta përfytyrosh hoxhën si një njollë të errët...

Ai po bëhej gati të më tregonte pikturat e tjera, kur mua më shkuan sytë në mur te një pikturë e madhe e një

vajzë, që ishte e mbuluar me një perde basme që nga gjinjtë e poshtë. Koka e vajzës ishte e anuar pak nga e djathta dhe sytë i kishte drejtuar mbi supin e saj të bukur, e menduar.

- Po këtë, - i thashë, - pse e ke mbuluar?

Ai buzëqeshi me një buzëqeshje të përmbajtur dhe tundi kryet.

- E ka mbuluar nëna. Është një histori e gjatë.

Dhe më tregoi si kishte ndodhur.

Ndëzëm nga një cigare dhe qëndruam një copë herë pa folur.

- Ishte njëfarë "kompromisi", - tha, duke qeshur. - U lodha nga grindjet dhe, më në fund, i thashë nënës ta mbulonte me perde, sepse për ta hequr nga muri nuk desha në asnjë mënyrë. Mos kujto se e bëra për nostalgji që nuk e hoqa nga muri, po nuk desha të dilte fjala e tyre.

Ne vështruam të dy vajzën me perde dhe papritur na hipi një gaz i papërmbajtur. Filluam të qeshnim me zë të lartë, duke thirrur: "O ç'vete!"

- E pastaj?

- Pastaj çdo gjë pak nga pak erdhi në vend të vet. Tani, disa kushërinj pleq, që nuk na vinin, na vijnë përsëri dhe njerëzit flasin më pak.

- E habitshme kjo gjë, - thashë. - Megjithëse...

- Çfarë? - tha ai.

- Megjithëse mendoj se edhe ti je treguar pak mendjelehtë.

- Pse?

- E ke marrë pak si tepër seriozisht gjithë këtë punë.

- Nuk të kuptoj, - tha ai.

Unë nuk e kisha të lehtë t'ia shpjegoja.

- Ndonëse ti ma theksove shumë anën klasore të kësaj çështjeje, kam parasysh hoxhën, - thashë unë, duke qeshur, - prapë mendoj se me prindërit e tu mund të tregohesh më pak parimor. A mundet njeriu të tregohet kaq parimor me nënën e tij, duke e ditur se si ka jetuar dhe ku ka jetuar ajo për gjysmë shekulli rresht?

- Ndoshta ke të drejtë, - tha ai mendueshëm. - Por ja, unë, më në fund, u binda, e mbulova atë përgjysmë.

- Kam përshtypjen se je bërë pak mizantrop, - i thashë, duke ndërruar bisedën. - A është e vërtetë?

- Si të them? - tha ai. - Jam pak i veçuar nga njerëzit, kjo është e vërtetë. Ti e di, çështje karakteri.

Ne qëndruam një copë herë pa folur.

- Ajo i shqetësoi shumë ata, - tha, duke vështruar pikturën, sikur donte t'ia pohonte asaj se sa shumë i kishte shqetësuar të gjithë.

- E, megjithatë, ishte vetëm një pikturë, - thashë.

Nuk foli dhe thithi cigaren.

- Por tani çdo gjë po shkon si më parë, - përsëriti, - dhe për motrën u bë më mirë që u nda nga i fejuari. Nuk e donte fare dhe për të u bë më mirë që ndodhi kështu.

Në kuzhinë u ndien dy palë heqlash druri dhe vajza lakuriq vazhdonte të mbante kokën të mënjanuar pak mbi supin e djathtë dhe sytë e saj ishin të menduar. Ajo dukej qesharake mbuluar me atë futë prej basme.

Tiranë, 1961



DHE MBRAMJA U UL

dhe mbramja u ul
me duer në prehën
si plakat dikur në derë të oborrit
rreth vedit i mblodhi orët e harrakatuna
nëpër ditë
u fryu gërvishtjeve dhe djegieve
grindjeve u këndoi një kangë pajtuese
pluhurin e shkundi prej fjalëve të mira
mandej nxori pe e gjypanë me arnu
çka mundet me u arnu

dhe mbramja u ul
me duer në prehën
tem

QERSHOR NORDIK

*
netët që nuk erren
janë premtim të një jete tjetër
së cilës nuk i vjen radha kurrë
hypë në karroca qielltare
parakalojnë dhe përshëndeten
me rrahje flatrash
që lanë mbas vedit
një pluhun luleblinit që m'i gicilon hundët
e më shtyn me u teshë
"Shndet! Shndet!" qeshen prej së nalti
netët që nuk erren
flatrojnë gazmore mandej drejt nadjes
përçafu me atë jetën teme tjetër
së cilës nuk i vjen radha kurrë

*
gjelbërimi i tërbuem
në ngut me lulëzu
sa pa u kthy bora
ta shpon lëkurën
si gjypana të imta

vjollcat e vonueme
u përzihen nëpër kambë
margaritave të hershme
e të rinjtë u gulfojnë shpive
për hundësh

papritmas edhe unë
unë që pallton e dimnit
nuk e mbyll kurrë në raft
edhe unë zgjohem
me sy të shkruem

E ZGJAS HUNDËN DREJT QIELLIT

e zgjas hundën drejt qiellit
dhe thith retë e verës
fjolla fjolla i përpj
mbush mushknitë
me avuj të avulluem
në toka të largta
prej kënde
kohnash tjera
që tash nuk janë ma kund
përveçse në flegrat e hundës
teme

KJO ASHT KANGA E MJELLMËS
KRAHËMBLEDHUN

kjo asht kanga e mjellmës krahëmbledhun
në akullin që këtë dimën
nuk u ngri

kanga që s'përhapet por si bryma që nuk ra
shtëllunga shtëllunga i rrin
përmbi

tingujt i ka të lidhun me pejna të gjatë
balonash tabake që nuk u lëshuen
në qiell

veç iu strukën poshtë pendëve
si fletë të librit që nuk u shkru
këtë vit

VËLLIMI POETIK FITUES I
ÇMIMIT KOMBËTARE PËR LETËRSI 2023ENTE LA TABAKU
Qeramikiana
poezi

se kjo asht kanga që rrin pezull
shtëllunga shtëllunga
e lidhun me pejna balonash tabake
për një mjellmë me krahë të mbledhun
mbi akullin që këtë dimën
nuk u ngri

kjo asht mjellma
ky duhej me qenë akulli
të tjerat janë
mit

KUR MUEJI VJEN NË DITË TË FUNDIT

kur mueji vjen në ditë të fundit
dhe të struket në prehën
si mica e shtëpisë dikur
nuk mbetet tjetër veç me ia lëmu
kryet
me ia shtru ditët e kërlëshuna
me përkëdhelje të buta
të mësueme herët
kur micat ishin lojë
dhe me i këndu nën za
një kangë të vjetër sa bota

se sa ka jetë ka shpresë
mandej me e lanë me u kotë
me hundën e ftohtë mbështetë
në ty

KTHEN

kthen
terri kthen
vjen një kohë dhe i hap
orët e dritës
e vetë tërhiqet qosheve
të sahatit

kthen po
nëpër të njëjtën fushë
të njëjtët akrepa
të njëjtën kurdisje
kthen e ia rreh minutin
dritës

kthen
terri kthen
unë hidhem pupthi
cepave
të zemberekut
të tij

U KTHY BORA

u kthy bora
pikërisht atëherë
kur dheu po i hapej do fijeve të verdha
që ndoshta kishin ndër mend me u ba
lule
një lepur i egër i zgjuem para kohe
s'e gjen ma strofkën dhe struket në vedi
gëzofi i murrmë zbardhet
zbardhet
zbardhet

u kthye bora
kthen gjithmonë
kujtesa flen thellë
në gropa të errëta

NGRI-SHKRI

çdo borë e re që bjen
bahet borë e vjetër
shkrihet mandej
deri në borën e re që bjen
dhe bahet borë e vjetër
kamba humbon kajherë
në borën e re
dhe rrëshqet pa mend
në borën e vjetër
se çdo borë e vjetër
nën borë të re
bahet akull i ri
mbi akull të vjetër
shkrihet mandej
prapëseprapë
dhe prapë
edhe sonte
prej mallit

ZHBAHEN TË GJITHA UDHËT

dalkahdalë zhbahen të gjitha udhët
grimcë për grimcë e shkrin dheun ky shi
dhe ziftin
dhe gurin
gjithshka e shndërron në ujë
të zi
të paktën të shionte
të pikonte
të -onte disi
por bjen
rreh
më tret
ky shi

POEZIA NUK I KA TË GJITHA
PËRGJIGJET

poezia nuk i ka të gjitha përgjigjet
(për fat të keq!)
nuk asht si mësuesja e klasës së parë
as si ajo e klasës së fundit
poezia shkon në shkollë
vetëm sepse i duhet me mësu
me shkru

poezia nuk i njeh të gjitha përkëdheljet
nuk asht si puthja e dashnisë së parë
as si e asaj të fundit
poezia emocionohet
vetëm sepse i duhet
një titull

poezia nuk del në luftë
nuk asht si arma e njeriut të parë
as si ajo e ma të fundit
poezia derdh gjak
vetëm sepse i del gjumi
etshëm

poezia më kundron
ndërsa e lidh shtrëngueshëm
për shkronja:
ti nuk i ke të gjitha përgjigjet
as përkëdheljet
as armët
(për fat të mirë!)

ENTE LA TABAKU

qeramikiana



OnufriPoezi

Nuk mund të rri pa thënë me krenari se Tirana dhe Bostoni kanë një lidhje të hershme mes tyre. Një lidhje të lashtë, gati në kufijtë e së pabesueshmes, për të cilën historia e shkruar, çuditërisht, ka heshtur.

Por para se të nis t'jua rrëfej këtë, nuk e quaj ndonjë mëkat të lëshohem pak caste hergjele në livadhet e historisë.

Në vitin e largët 1614, kur u themelua Tirana, Bostoni, që më pas do të quhej vendlindja e Revolucionit Amerikan, ishte, as më shumë e as më pak, një vend i humbur, i zhytur mes tri kodrave, që me pak dashamirësi mund të llogariteshin si male – *Trimountain* – dhe, për më tepër, ishte ende i papagëzuar me një emër që t'i bënte nder. Me sa duket, banorët indianë të atij gadishulli të vogël, të paktë e të paditur, u përfshinë në luftën për mbijetesë me ethet e verdha e nuk ia patën ngenë t'i gjejnë një emër, derisa një eksplorues anglez, kapiteni John Smith, e thirri atë New England, me shpresën që të tërhiqte aty sa më shumë anglezë. Ky emër nuk u prit mirë apo, siç thuhet, nuk ngjiti te vendësit.

Pak vite më vonë një anglez tjetër, kolonialisti tashmë i kamur Isaac Johnson, "i shembi" tre malet (*Trimountain*), që me pak dashakeqësi mund të quheshin kodra, dhe e quajti vendin Boston, për nder të qytetit ku pati jetuar në Angli.

Deri këtu kam thënë gjëra të njohura, të cilat historia ua ka mësuar brezave njerëzorë dhe tani së fundi edhe inteligjencës artificiale.

Edhe unë në atë grazhd kam ngrënë e vazhdoj të ha, prandaj as më shkon nëpër mend që ta përmbys, por kam të drejtën të dyshoj. Unë e di mirë se e shkruara – kam parasysh letrën – është e rrezikuar nga zjarri, uji dhe historianët, ndaj shtyhem të mendoj se është gabim që shprehjen "Fjalët i merr era, e shkruara mbetet" ta marrësh për aksiomë. Këtu nis edhe dyshimi im se emrin e Bostonit e paska vënë ai farë Isaac-u që përmenda më sipër.

Kjo deklaratë dikujt mund t'i duket provokim dhe të më akuzojë se me një gur synoj të vras historinë e t'i mbaj anën gojëdhënës. Unë kam vetëm një armë për ta hedhur në erë këtë akuzë dhe kjo është modestia, së cilës për çdo rast ia lë një fishek në gojë. Prandaj ju pyes ju dhe veten: kush jam unë që të trimërohem e të ndeshem me aksiomat?

Nga ana tjetër, unë di se jo rrallë fjala është si virusi, përhapet nga goja në gojë dhe prek turmën. Kur e gjen atë me imunitet të rënë të trurit, mund të kthehet në epidemi dhe atëherë nuk ka armë e ilaç që t'i bëjë derman, sepse dihet që harresa – armiku i saj i vetëm – është individuale dhe jo kolektive.

Dhe pas këtij lehtësimi në ndërgjegje, mendoj se erdhi çasti të flas për lidhjet e hershme të Tiranës me Bostonin. Edhe në këtë rast historinë e shkruar e lanë gjunjët dhe qitapët e saj zunë myk. Njerëzia, ndryshe nga unë, u ushqyen në grazhdin e gojëdhënave dhe fjala erdhi revan deri te ne, duke e mbajtur legjendën gjallë e rrëfimin të freskët sikur ngjarja të jetë një ëndërr e parë mbrëmë në mesnatë.

Ju mezi prisni që unë të marr përgjegjësinë e vërtetësisë së fakteve për rrëfimin e mëposhtëm, por ju ftoj edhe një herë të zhgënjeheni, pasi nuk do ta bëj këtë. Jo nga ndonjë frikë. Thjesht nuk



JANI MALO

Nga Tirana në Boston

Tregim

e quaj të ndershme t'i rrëmbej autorësinë atij që ma rrëfeu. Edhe pse unë nuk po i hap thonjëzat, jeni të lutur t'i merrni ato me mend.

Një i ri i pashëm e flokëkaçurrel nga fshatrat e Tiranës – nëse atëherë ekzistonte Ndroqi, andej duhet të ketë qenë, për shkak të afërsisë me portin – u nis nga Dyrrahu në drejtim të Venedikut, për të vazhduar më pas për në Egjipt. Qëllimi i deklaruar i këtij udhëtimi ishte të shpinte atje një thes me fara shalqiri, me shpresë se kjo lloj tregtie do ta bënte të pasur. Ngjarja duhet të ketë ndodhur rreth 400 vjet më parë, pikërisht kur Sulejman Bargjin Pasha themeloi Tiranën, por askush nuk na thotë nëse udhëtimi i djaloshtit shqiptar ishte pjesë e ndonjë misioni sekret të themeluesit të Tiranës, apo thjesht aventurë e një kokëkrisuri axhami. Një gjë është e sigurt, i riu shqiptar nuk shkonte për të marrë pjesë në betimin e presidentit amerikan, për arsyen e thjeshtë se Xhorxh Uashingtoni, Presidenti i parë i Amerikës, donte edhe tre shekuj të lindte.

Për shkaqe që nuk i thotë kush, djali nga Ndroqi, pasi u nis nga porti i njohur i Gadishullit të vogël Ballkanik, la pas Venedikun dhe në vend që të mbërrinte në Egjipt, udhëtoi drejt Kontinentit të Ri, për të përfunduar në një liman të vogël të një gadishulli tjetër edhe më të vogël, në Massachusetts.

Udhëtimi që i gjatë, i lodhshëm e i mërziqshëm, por nuk është qëllimi i këtij rrëfimi ta përshkruaj atë me hollësi e as të gjej ngjashmëri me të Kristofor Kolombit. Veçse nuk mund të rri pa thënë se pikërisht për të hequr mërzinë, i riu shqiptar u propozoi bashkudhëtarëve të tij ta kalonin kohën me një lojë që për

ta ishte e panjohur, por mjaft e përhapur në Shqipërinë e asaj kohe. Bëhet fjalë për lojën e nëntëshit apo, siç quhet rëndom, të yçit me nëntë. Disave iu duk zbavitëse. Djali, ngaqë nuk kishte ku t'i gjente gurët për lojën, nxori nga thesi që kishte me vete një grusht me fara shalqiri. Askush nga udhëtarët nuk kishte parë dhe nuk ua kishte idenë "gurëve" me të cilët po luanin.

Çdo gjë shkoi mirë e bukur derisa i trazoi urat një kinez rronokop, i cili jo vetëm i njohu farat, por ia ngriti nervat shqiptarit deri te kaçurrelat, duke thënë se farat e vogla e kishin origjinën nga Kina. Djali i dha një shpullë kinezit. Nuk di të them nëse e bëri këtë për sedrën e lënduar apo sepse ai u prishi lojën, por është fakt se aziatiku i tmerruar – u zverdh apo jo nuk e dëshmon askush, për shkak të ngjyrës së përhershme të fytyrës së kinezit – u fsheh në hambarin e anijes. Ajo që ka rëndësi është se yçi me nëntë u pëlqeu të gjithëve dhe e bëri shqiptarin e ri të preferuarin e vaporit. Ai zuri miqësi të ngushtë me një italian të ri, që thoshte se kishte studiuar për jurisprudencë në Universitetin e Bolonjës.

Po aziatiku, si mola, nuk hoqi dorë. E kujtoi përsëri origjinën e farave të shalqirit sapo doli nga hambari kur vaporit po ankorohet në liman dhe udhëtarët po bëheshin gati të zbrisnin. Atëherë shqiptari nuk u mjaftua me një shpullë, por e mbërtheu kinezin për gryke dhe e hodhi në det. Për fat të mirë, ai shpëtoi pa u mbytur, por autoritetet e limanit nuk e lanë me kaq. Improvizuan aty për aty një gjyq për shqiptarin. Duket se nga telashet e shpëtoi pikërisht italianin, i cili e mësoi të thotë para 'gjykatësve' se e hodhi në det kinezin, pasi kuptoi

qëllimin e tij të mbrapshtë të ardhjes në Amerikë, përhapjen e etheve të verdha.

Kuptohet, amerikanët qysh atëherë nuk falnin askënd që synonte t'i bënte keq Amerikës, siç edhe ishin njëllot të rreptë në doganë, ku e kalonin gjithçka në vrimë të gjilpërës. Shkurt, edhe pse i shpëtoi paq dënimit, rioshit nga Ndroqi iu sekuestrua thesi me fara shalqiri, i cili përfundoi atje për ku ai nisi kinezin, në det, ngaqë askush nuk dinte çfarë ishin ato që kishte brenda.

Dua të bëj këtu një parantezë të shkurtër, por pa e këputur fillin e rrëfimit nga fati i heroit. Ajo që desha të them është se ky nuk është rasti i parë që historia tregohet mospërfillëse me individin. Emri i këtij njeriu humbi, udhëtimi i tij nuk u përshkrua në asnjë roman aventurash, bëmat e tij nuk u përjetësuan në asnjë film të Hollywood-it të mëvonshëm, madje as pasardhësit e tij, me sa di unë, nuk përfituan shtetësi amerikane e as trashëguan pasuri a pension nga Amerika zemërgjerë.

Unë, nga ana ime, mendoj se sot, katër shekuj më pas, ai djalë meriton më shumë vlerësim në vendin e tij, pasi qe shqiptari i parë që kaloi Atlantikun. Edhe vetëm kaq do mjaftonte për të mbushur me krenari e gëzim një popull të vogël si yni, që e ka në gjak emigrimin. Sa për amerikanët, ata i mirëkuptoj pse nuk ngritën qoftë edhe një përmendore në nderim të shqiptarit. Ata në shekuj i ka munduar një ndjenjë e përzier turpi dhe faji për atë që i ndodhi djaloshtit sapo këmba i shkeli sterenë e Kontinentit të Ri.

Duke e quajtur të konsumuar parantezën dhe për të mos lënë shkas për pyetje të lojit 'përse ky djalë duhet vlerësuar kaq shumë', po e them prerë dhe troç: Sepse ishte ai që i vuri emrin Bostonit! Të tjerat, në mos janë spekulime, duhen marrë për broçkulla.

Si ndodhi kjo? Më të duruarit nga ju, që arritën deri në këtë pikë të rrëfimit tim, do jenë edhe më të fituarit. Do e mësojnë të vërtetën brenda pak radhëve.

I gjendur në mes të katër rrugëve, i papunë, pa një cent e pa njohje, djaloshi zuri të endej kuturu. Befas një ditë gjeti nëpër xhepa ca fara shalqiri. Ishin ato me të cilat patën luajtur yçin në vapor. I nxori nga xhepi dhe pa ndonjë shpresë, por me inat i flaku përtokë diku në një djerrinë buzë lumit.

Kaluan disa muaj dhe, për çudinë e tij, i riu – të mos harrojmë se ishte tironi safi nga Ndroqi – vuri re se nga farat kishin mbirë e ishin rritur bimë të shëndetshme, të cilat e kishin mbushur djerrinën me kokrra larushane shalqiri. Nuk e zgjati fare, këputi ca prej tyre dhe doli në rrugët e qytetit për t'i shitur.

Thërriste: Boston i omël, boston katuni me t'ik truni! Hajde boston, boston!

Vendësit habiteshin sa nga kokrrat e mëdha e të panjohura për ta, aq edhe nga gjuha e çuditshme që po dëgjonin. Ah, harrova të them se shqiptari kishte fjetur ku kishte mundur, kishte ngrënë ç'kishte gjetur dhe nuk kishte mësuar asnjë fjalë nga gjuha e vendësve.

Thuhet se djalin e morën për të marrë, por u pëlqeu shalqiri që ai shiste. Ishte shumë i ëmbël. Po më shumë ua kënaqi veshin fjala 'boston'. Ajo u ngjiti në kokë siç ngjit në gishta lëngu i shalqirit.

Dhe ia dhanë për emër qytetit të tyre. Boston.

23 mars 2024

NATA NË KOPSHT

Mbi gardh, gonxhet e reja të trëndafilut po mbyllen për të kaluar natën pranë një kërmilli që mbart mbi shpinë shtëpinë me arkitekturë gotike, pranë një pylli të vogël mullagash.

Xixëllonjat lëshojnë dritë duke i dhënë një madhështi urbane gardhit që po mbështillet me natë.

GJENDJE E VERDHË

Kur tufa e zogjve iku fluturim pashë portretin tend rrëzuar mbi hapësirën e të verdhës së pafundme, ndieva cicërimat të më mblidhen në grykë dhe qava trishtimin e plepave në muzgun, ku tulipani bie erë hënë.

Thinjat e verdha të lulediellit me kokën ulur i tregonin orën udhëtarit imagjinari mbi një kalë pluhuri që hingëllinte në një gjuhë të verdhë.

Pashë qiellin e pikturuar me zogj Fushën, plepat, hënë me erë tulipani, pluhurin, kalin dhe një biçikletë të vjetër harruar në rrugë sapo Van Gog pikasi portretin tënd të verdhë prej luledielli.

REKUIEM

Tek ecja bregut të lumit pashë qiellin ngjyrosur me gri e qava me ngashërim si shëlg.

Peshkatarët gjuanin me një rretë argjendi që zbriste ngadalë duke pikturuar katrorë në ujë.

Në kuadratet e këmishës time u pikturuan peshq të bardhë atëherë kuptova se unë isha vetë lumi bri te cilit një shëlg, po qante si burrë.

E VERDHA PËRMBYS

Një herë kur shkoja hapësirave të muzgut Pashë lulediellin përmbys tek qante me lotë të verdhë trishtimin e dritës dhe ndieva kumtim e perëndimit.

Kujtova se dielli s' ka për të ardhur më në viset biblike me det dhe re që më mësuani se e kuqja e ndezur nis nga e verdha e lulediellit që psherëtin përmbys sapo një vijë imagjinare shfaqet në kufirin e ditës me natën kur ngjyrat bien në letargji.

Një luledielli qan me lotë të verdhë fatin e saj me sytë nga rruga që të çon në qytetin që s' e ka parë kurrë, veçse në ëndërr, netëve kur ajo dremet si një plakë mbështetur mbi bastun.

Fshiva lotët dhe pashë gishtërinjtë pikturuar me të verdhë.

PIKTURA E HIJES

Kur u gjenda brenda një ikone në muret me erë qirinsh ndieva lotin e parafinës tek rrokullisej nën tingujt e një rekuemi.

Qava fatin tim

MARASH MIRASHI

Pylli i verdhë i parafinës

Poezi



në murin e shkruar me dritë prej syve që digjnin lutje.

Kur dola nga magjia e ikonës pashë murin e pikturuar me hijen time si një qiri fillikat që jep shpirt.

KATRORE DHE ROMBE

Jam fija e perit me të cilën qëndis dhimbjet. Filli kalon tej dritares gotike të gjilpërës, në anën tjetër të një kambriku të bardhë mbi të cilin pikturohet mozaiku i dhimbjes me katrorë dhe rombe të vegjël.

ERA E KRIPUR E HINGËLLIMAVE

Në fundin e ujit gaforrja shtyn një guaskë mbi shpinën e kalit të detit. Hingëllimat pushtojnë një pyll koralesh që mban vesh trokun e lagur.

Një kandil pluskon dritë duke u dhënë ngjyrën e kuqe peshqve që ende kujtojnë se janë të bardhë.

Kur çel dita guaska e gjen veten në breg, mbi rërë ku pikturohen gjurmët e kalit dhe fryn një erë e kripur hingëllimash.

MIRAZH

-Në kujtim të mikut tim poet Tonin Kaçaj-

Dua të mbledh një tufë me lule por këtu është shkretëtirë dhe pranë nuk ka një oaz. Përtej është fantazma e një klithme si Morricone dhe një fikus që e ka pirë gjithë ujin.

Qaj fatin prej rëre në mbretërinë e kafenjtë ku fle harmonika që i kam rënë dikur në Golgotën time.

Një mirazh është përtej por nuk kam fuqi ta mbërrij, atëherë pikturoj mbi rërë shputat e mia dhe i nis për të zbuluar oazin.

PËRMBYS

Jam fija e barit rrëzuar përmbys nga tehu i kosës në duart e burrit që vallëzon në kopsht.

Kur u ngrita ndieva aromën që vinte prej lules së mpiksuar në gjakun jeshil të barit.

Pashë shpinën e kostarit në ikje dhe kosën që linte pas vragat e një pengu si tatuazh.

PARAFINË

Qirinjtë që pata fikur dikur janë ndezur prapë. Brenda meje digjet një pyll i bardhë parafine me tymin që pikturon një katedrale.

Një flakë e zbehtë u bën dritë kthinave të mia me aromë spangoje të djegur.

DEGUSTIMI

Gjithçka ishte e heshtur si një katedrale në shi ende pa rënë këmbana me tingujt e verës që luan vals në peisazhin gotik mbi vozën që dikur ka qenë një pishë të cilës i blatojmë imagjinatën e një hardhie për të hyrë në gotën që e mban në dorë një burrë i gjatë, symbyllur.

NOMADE

Kam qenë dikur një filiz në duart e romit me të cilin ai bëri një bilbil. Ndryshe nuk do të isha një fishkëllimë mbi lagjen nomade, ku arixhofkat parathënë fatin e shëlgjeve që krihen në lumë në ujin e kthjellët, ku hëna ndrin rrugën e romëve të mirë kur dalin brigjeve duke lypur ëndërra.

Kam qenë dikur një filiz në duart e romit me të cilin ai sajoi një ëndërr me një tingull të ëmbël, si bilbil.

REKUIEM

Kujtesa ime, një lapsë plumbi pikturon kambanoren e vjetër dhe një qiri që beson se filli i spangos thotë lutje me një ngjyrë të zbehtë flake që përkundet si velë.

Kthej lapsën përmbys dhe fshij pluhurin mbi antikitetin tim që bie erë gomë.

LOTËT E KUQ TË TRËNDAFILIT

Kur nëna e la për herë të fundit oborrin ndieva përballjen e hardhive, pashë lotët e kuq të trëndafilut në verandë, e im atë që besonte se jeta e tij kish qenë një shije e thellë parfumi të kuqrrëmte, si perëndim.

Ndieva meshën e trëndafilave dhe një puhizë ere që u mësonte dallëndysheve Ave Marinë.

Pashë për të fundit herë fytyrën e bukur të nënës, me petale si zemra të vogla, tek dilnin nga fryma e tim eti si e vetmja mënyrë që ai kish zgjedhur për t'u ndarë me dashurinë.

MURGESHA DANIELË

Rigat e shiut bien si nokturn i Shopenit mbi barin ku vallëzon Daniela kur bie kambana duke zgjuar nga gjumi retë e bardha që vijnë çdo të diel në meshë.

AKUARIUM

Dy peshq të kuq notojnë në detin kubik nën sytë ëndërrimtarë të maces që pret baticën që s' ka për të ardhur asnjëherë.

GRUAJA ME FURKË

Reja ka zbritur mbi furkë nën sytë e gruas që tjerri një fill prej shiu që përhapet dyshemësë duke pëmbytur fantazinë e maces që luante dikur me një lëmsh i cili nuk i ngjante ujit.

VINJETË PËR SHTËPINË E VETMUAR

Era e detit pikturon pëllumba mbi çatinë si një perëndim Santorini me oxhakun që kujton se është një mulli me helika, si akrepa ore që e kanë humbur sensin e kohës, në hapësirën mes ujit dhe ajrit, ku askujt nuk i nevojitet të dijë nëse dielli po lind apo po perëndon.

VAJZA NË KOPSHT

Perëndimi lyen me ar ullinjtë e rruazave në qafën e vajzës që mbledh fruta të verdhë në një shportë thurur me bishtaleca.

Fijet e barit ngjiten lart për të parë nga vjen një puhizë që u fryn trëndafilave në fustanin e vajzës që vjel perëndimin në kopsht.

parfumin e barit ku qyqja do të luajë pas pak orkestralen madhështore të vetmisë.

HINGËLLIMA TË KUQE

Hingëllima pikturon në ajër një kalë të brengosur për fatin e kalorësit që ka iku me trok ne antikitetin e patkonjve. Era u fryn jeleve duke i dhënë madhështi hingëllimave që shkojnë e mbyten në lumë.

Re të kuqe zbresin nga qielli dhe kullotin barin e mbetur të dimrit.

FARUK MYRTAJ

I fundmi që do lerë Amerikën...

Tregim

U bëmë në një mendje, si shokë të Red Ermenit, për ta ngushëlluar në kafenenë ku takoheshim zakonisht, jo në shtëpinë e tij. Nuk i kishim bujtur më parë, për gëzim që, sipas zakonit të vendlindjes, s'ishte e udhës t'i shkonim në të keq.

Ngushëllimi gjithnjë i vështirë është, aq më shumë për një vëlla më të vogël, por në këto orë na vijnë në ndihmë histori humbjesh të tjera. Prej tyre rrëfjmë më të përshtatshmet për rastin, jo gjithnjë më të dhimbshmet. U kanë ndodhur të tjerëve, por ngushëllojnë gjithë kënd.

"Ngaqë janë të emigruar në troje të askujt, këta këtu sikur nuk shfaqin lot. Rrëfjmë momente të gëzuara të tyre, me të sapo lkurin. Dhe nuk e kanë keq..."

"Nuk qajnë me oi-oi dhe ligjërime si ne," tha i treti në ngushëllim.

"Edhe te ne kështu po bëhet...", shtoi Red Ermeni, që prej Andej vinte.

Të tre kishim hyrë në një moshë kur për vdekjen flitet si për jetën dhe unë thashë që, si vëllazëri, edhe pse kishim jetuar në tri katër qytete në vendlindje dhe në dy-tri shtete mërguar, vetëm në fshat të babait kishim varre. Tjetri sikur po ndjehej i pa-tokëzuar kur iu desh të pranonte, me zë, se nuk ia kishin arritur dot t'i bënin bashkë të vdekurit.

Në moshën ku kemi hyrë, flasim kollaj për sy-mbylljen dhe këmbëjmë versione çdo herë të tjetërta ku do prehem! Kujtojmë njeri-tjetrin se, me terezi, duhet tua themi edhe fëmijëve, ku! Ngaqë atë të madhen, ikjen gjallë nga dherat tona e kishim përballuar, ikjen tjetër, symbyllurën, e marrim ngoje duke qeshur, vërtet ky që jeta si rreke e përjetshme ta dhuron.

Ngaqë ne të tjerët kishim të rëndë fjalën si ngushëllim, mori përsipër Redi të fliste, si kurrë më parë aq gjatë. Mbase në fillimet e njerëzimit, kur i ndodhën vdekjet e para, dhe ai ende s'fliste, për të ngushëlluar i ishte dashur të nxirrte fjalët e para.

Red Ermeni po thoshte se, së pari pas shtatë vjetësh mërgim, i ishte dashur të kthehej detyrueshëm në vendlindje. Nuk mund të zinim vend këndeje ku kishim ardhur, duke i pasur prindërit larg. I ngrita të dy në krahë dhe me krahë avioni i solla në Amerikë. Babai ndërroi jetë sa erdhi këtu, dhe ne të gjallëve që po na besohej se po bënin vend këtu, nuk na shkoi ndërmend ta kthenim andej nga ku sapo e kishim sjellë. E mbajtëm vdekur në Amerikë.

Pak kohë më pas u bë shkak nëna, për kthimin tjetër Atje. Ndryshe nga babai, ajo kishte kërkuar ta linte Amerikën vdekur. Kjo pjesë bote, e lirë pafund, po aq e rrëmujshme sa e lirë, për të mbase u ishte premtuar ne, bijve, por jo asaj, as plakut të vet. Fjala si amanet s'vihet në mëdyshje:

"Do më ktheni në fshatin e varisit", kishin qenë fjalët e fundit të saj.

'Varisi' ishte i shoqi, babai ynë. Atje ku kishte hyrë nuse, ajo ishte toka premtuar asaj! Edhe pse vet 'varisi' ishte 'fshetur' me dëshirë të vetë në dherat e Amerikës, si të ëndërronte ende.

Na dukej se e kishin bërë me fjalë: të afërmit tanë në Vendlindje ta kishin njërin, dhe ne këndeje në Amerikë, të kishim tjetrin prej tyre. Pra, që të mos u mungonin të dy palëve, prindërit ndanë varret. Mëdyshja u thellua kur ndërroi jetë vëllai.

Kishim ardhur për të vdekur në Amerikë? Ëndërruam të mbërrinim gjallë a vdekur dhe këtu s'po na rrihej dot vdekur?

"Nëse ndonjë ditë, kush e di, vendosni të ktheheni, i fundmi që do lërë Amerikën, të më marrë me vete edhe mua!", kishte thënë babai, i sigurt se vetëm kjo s'kishte pse ndodhte.

Këto fjalë të tij ua kishim thënë edhe njerëzve tanë në Ermen. Edhe xha Nezirit, kushëritit të babait. Si shenjë që në kishin aty, në Ermen. Le të bënim ne, sikur ishim në Amerikë!

"Do vij edhe unë te varrezat...", ua kishte përsëritur djemve Nezir Shamo, kur mori vesh se po shkoja me trupin e tim vëllai, vazhdoi rrëfimin Redi.

"Ku kërkon të vesh, ti o njeri. Ti as dëgjon, as shikon!"

Kukuriska e së qeshurës së bijëve sido si mbërriti te veshët e dobësuar të atit të tyre.

"Nuk e qorton kush 90 vjeçarin pse nuk shkon në varreza!"

"Një ditë, do shkoj vet atje!"

"Do të çojmë në krahë ne, baba!"

Iu qasën dhe e puthën te kryet, si bust antik.

"Dua të vete sot. Dua të më çoni ju. Dua ta shikoj djalin!"

Bijtë e tij nuk dyshonin: ai s'e dinte në varrimin e kujt kërkonte të shkonte. Dinte vetëm mbiemrin, si kushëri i babait tonë, dhe ne ishim të tërë 'djemtë e tyre', edhe pse kishim kohë pa u parë, sa s'kujtoheshim mirë kur. Mërgimi kishte plasur si epidemi që sqaste vaksinë.

Unë sillja vëllain të prehej në vendlindje, se ende rrojmë në transin global: vendin e jetës e ndërrojmë, por jo varrezën. Të tërë varroseshim në vendlindje. Në fakt, vendlindja si shkuarje në varrezat kishte mbetur.

"Dua të vij të shikoj djalin..." kishte ngulur këmbë xha Neziri.

Djali që donte të shihte isha unë. Ma rrëfyon të bijtë, kushërinjtë e mi këtë bisedë.

"Do shikosh Redin?! Ti ke dhjetë vjet që nuk shikon, si do ta shikosh atë?!"

Ta merr mendja që e sollën në varreza, të mos u mbetej pek, por edhe të mos e mërzhitnin.


Ta shihje se si më takoi, xha Neziri, si m'i prekte flokët, mjekrën, duart i dridheshin por më merrte për qafe, më vinte kryet në gjoks, si prind që s'ngopet me erën e birit të vëllait të vet, babait tim, që nën tjetër sipërfaqe prehej dhe... s'i mbante dot lotët.

"Mos u mërzhit, hë bir! Ndaj ngula këmbë të vija, të kërkoja ndjesë për prishjen e radhës për ardhjen këtu, të mos mungoja edhe unë, ku mungon vëllai im-babai juaj, për birin..."

U pamë sy-më-sy me kushërinjtë.

"Oh të keqen xha Neziri juve...!"

"E shikoni që e pashë djalin. E pashë edhe një herë! Po de, e kisha edhe vet frikën mos nuk do ta njihja, por e njoha, në erën e birit e ndjeva!"



ISTREF HAXHILLARI

Karmençita

tregim

Kurrë nuk pandehu ta zaptonte trup e shpirt një grua, si kjo spanjolle e zjarrtë me Ksytë pis të zinj. Asnjë femër e vendit të tij buzë Adriatikut nuk e robëroi. Luante, i vërtiste majë gishtave, shpërfillte braktisjen e fustaneve. Tani ngeci në leshrat ngjyrë ari dhe kurmin e derdhur të Karmençitës së bukur.

Natë për natë grisinin terrin me të puthura...

Vogëlinë e nanuriti vegimi i Nonos, gjyshit të pasur hijerëndë, që la amanet ta pagëzonin me emër latin nipin e parë. Zonjat sqimatore të qytetit krenoheshin me tufat e luleve importuar nga Spanja prej firmës *Meliati*. Lufta, fundi tragjik i Nonos, e zhyti në mjerim familjen. Bredhjet nga një vendbanim në tjetrin, përndjekjet, burgosjet i shoqëruan në vite.

Ëndrra shumëvjeçare e martesës u venit.

Serdi kapërceu ndër të parët kangjellat e ambasadave natën trazuar me shi dhe erë. Rrugëve të Barcelonës zvarriti ëndrrën e gjyshit, që papritmas doli nga mjegulla. Shitja e buqetave të vogla nëpër trotuare dhe strehë dyqanesh e çoi te sipërmarrja fitimprurëse e luleve natyrale. Jeta mori kuptim, po martesë u largua më shumë, tashmë për shkak të moshës së shtyrë.

Karmençita hapi dyert e shpresës.

Nono u martua përsëdyti pesëdhjetë e tetë vjet, ai ishte katërmëdhjetë më pak dhe jetonte në vendin e lirë ku moshë s'përbënte kurrfarë pengese.

I propozoi një mëngjes prilli në shtrat.

- Ç'na duhet martesë? - refuzoi, - mirë jemi kështu.

- Dua fëmijë prej teje.

- Nuk më ke për atë punë.

E kotë ta zgjaste. Iu nënshtrua si çdo teke tjetër.

Krisja erdhi rrufe në qiell të hapur. Goditja e përpiktë.

- Kam ftohtë, - i tha disi e bezdisur, e lodhur, - dil pak.

I ngriu dora nën sqetullën e parfumuar, një rrymë e akullit e drodhi së brendshmi. Nuk deshi ta besonte. Nuk mundej.

- Çfarë nuk shkon?

- Dua të rri vetëm, - u përgjigj me zë tjetërsoj.

Fatmirësisht filloi e mbaroi në kufijtë e një pasditeje. Behën sërish ledhat, puthjet, loja e trupave të lakuriqtë.

E mendoi lajthitje e aq.

Në të vërtetë asgjë nuk ishte si më parë.

Erdhi vonë atë natë. Hapi dritaren, derdhi shikimin mugëtirës, u zhyt në botën e vet të errët, pa pikën e dëshirës.

Instinkti ia kthjelloi trurin: Spanjollja fshihte tradhtinë.

- Ik! - i tha.

Ajo u afrua, i vuri kokën në sup, e mbështolli në krahë. Format po ato, marramendëse, të papërballueshme, sytë bosh si një humnerë. E zhveshi, futi kokën gjinje të njomte buzët e thara. Nga thitha e majtë e përqeshën dy njolla të freskëta si koka nepërkash.

Sytë iu errën, gjaku i pa shprishur i dheut të tij e goditi në tru.

Ajo nuk e kuptoi, përkuli qafën, mbylli sytë. I hapi kur thika i ndau kokat e nepërkave.

Pastaj i mbylli për të mos i hapur më.

Ende nuk kishte aguar, një gri e mekur varej dritares si perde e tejdukshme, pas së cilës avitej drita.

Edhe pse lindte një ditë tjetër, gjithçka vdiste.

* Më 23 prill 2010, në Ditën Botërore të Librit, tregimi u vlerësua me çmimin "Don Kishoti" nga Ambasada e Spanjës.



Poeti polak Zbigniew Herbert, në poezinë e tij *Raport nga qyteti i humbur*, na njeh në pamje të parë me një realitet historik sa polak, aq edhe botëror, në mos universal. Bëhet fjalë për rrethimin e një qyteti. Faktet e ndryshme historike dhe jeta e vetë autorit na bëjnë të supozojmë se qyteti në fjalë ndodhet në Poloni, dhe duke qenë se poeti e botoi poezinë në vitin 1983 në Paris, gjasat janë që flitet për Poloninë e viteve 1980-1981, e "rrethuar" nga të huajt dhe në gjendje lufte.

Megjithatë, leximi i poezisë na bën të mendojmë që Herberti nuk kufizohet vetëm te ky rast apo vetëm te kjo çështje, apo më saktë, e tërë ajo që lexojmë mund të jetë maskë e asaj që poeti vërtet do që të përçojë. Polonia ka kaluar edhe rrethime të tjera qytetesh. Madje, mund të mos kemi të bëjmë thjesht me një qytet. Mund të mos kemi të bëjmë as vetëm me një objekt konkret. Si poezi moderne, ajo sugjeron, nuk deklaron haptazi. Duhet të depërtojmë më me kujdes për të kuptuar të fshehtën e poezisë.

jam tepër plak që të ngjesh pushkën dhe të luftoj si të tjerët – më ngarkuan për mëshirë rolin modest të kronikanit shënoj – një zot e di për kë – historinë e rrethimit

Vëmë re që poezia është e ndërtuar nga këndvështrimi i një plaku, të cilin e kanë caktuar të jetë kronikan i rrethimit, dëshmitar i realitetit me të cilin po përballen. Toni na vjen pesimist, teksa plaku na tregon habinë e tij në lidhje me detyrën që i kanë ngarkuar. Pse dhe për kë do duhej dëshmuar rrethimi? Si ra, si nuk ra qyteti, ç'rëndësi do të kishte për njerëzit se ç'ndodhi me qytetin? Problemi i kujt është ky qytet i cili, edhe nëse nuk bie tani, do të mposhtet nga ndokush tjetër në të ardhmen, qoftë mposhtësi një armik apo vetë koha?

Siç e trajtuam pak më lartë, mund të mos jemi duke dëshmuar thjesht një rrethim. Rrethimi i qytetit nga të huajt mund të jetë rrethimi dhe/ose sulmimi i njeriut dhe shpirtit të tij nga forca të jashtme shqetësuese e kërcënuese.

lypsat me qenë i saktë por nuk di kur nisi sulmi dyqind vjet më parë në dhjetor shtator a ndoshta mbrëmë ndaj të gdhirë këtu të gjithë janë të sëmurë me humbjen e ndjenjës së kohës

Pasigurinë në lidhje me fillimin e rrethimit dhe kohëzgjatjen e tij mund ta shohim në dy këndvështrime: sipas njërit, kuptojmë që ngjarje të tilla janë më se të zakonshme dhe të shpeshta në historinë e njerëzimit sa edhe kronikani e ngatërron rrethimin e tanishëm me të tjerë të mëparshëm; sipas tjetrit, këndvështrim ky pak më introspektiv, nevoja e përhershme e njerëzimit për t'u vetëmbrojtur e për të mbijetuar e ngushton vetëdijen, aftësinë kuptuese njerëzore, brenda vetëm këtij impulsi, vetëm brenda këtij instikti mbijetese, sa çdo gjë tjetër kthehet në dytësore.

Para rrezikut të vdekjes (ndokush mund të thotë edhe para rrezikut të zhdukjes jo vetëm individuale, apo siç mund të jemi mësuar të themi, "të tharjes së farës"), frika nga të mosqenit dhe nga e mosnjohja e asaj që na pret vret çdo ndjesi dhe ide tjetër dhe njeriu humb kështu lidhjen që kishte deri pak më parë me aspektet e shumta të realitetit. Është si në ato rastet kur njeriu po kalon një sëmundje dhe nuk i intereson asgjë më shumë sesa të shërohet sa më parë. Çdo gjë tjetër, qoftë edhe më e rëndësishme apo qoftë ajo diçka që mund ta lumturonte njeriun, e humbet rëndësinë e vet përpara kësaj manie.

Kronikani (poeti) vazhdon e mban shënim shkurtimisht faktet e ndodhitë e çdo dite sikur të ishte duke mbajtur shënime mbi gjëra të rëndomta, siç mund të ishte

ZBIGNIEW HERBERT – KRONIKANI RRETHIMIT APO DËSHMITARI I FATALITETIT?

nga Noel Boci

qarkullimi i mallrave, prodhimet ditore në industri, etj. Nuk mund të themi që trajtimi tejet objektiv dhe jonjerëzor i veprimtarive njerëzore në kohë fatkeqësie nuk është i qëllimshëm nga poeti. Një teknikë e tillë e ndihmon poetin të denoncojë dehumanizimin e shoqërisë njerëzore, ku individët nuk janë më qenie njerëzore, por mjete pune, gurë shahu që përdoren nga "të mëdhenjtë", misteriozë e të heshtur, për përfitimet e tyre. Ata nuk kanë emocione, ndjenja, ide, mendime... vetëm veshë për të dëgjuar urdhrat dhe krahë për t'i zbatuar ato. Jo më kot poeti, nën petkun e kronikanit të vjetër, "justifikohet":

*u shmangem komentareve përmbaj
emocionet shkruaj për faktet
më duket se vetëm ato vlerësojnë në
trëgjet jashtë shtetit*

Individualja, subjektivja, bota e brendshme e njeriut... ato e humbin vlerën në sy të botës. E ç'i duhet botës ç'bëhet brenda mendjes dhe shpirtit të njeriut për aq kohë sa ky njeri nuk i nevojitet për asgjë më shumë se plotësimi i detyrimeve konvencionale? Madje në raste të tilla është mirë që ky njeri ta zhdukë emocionin, të mos e lërë të depërtojë tek ai. "Sa më pak njeri të jetë njeriu, aq më i dobishëm është ai" thotë Bota. Shpërfillja e mëparshme që i drejtohej fatit të qytetit të rrethuar, tani i drejtohet njeriut të tjetërsuar (shpesh të sendësuar).

Kjo nuk mbaron me kaq. Gjurmët e këtij "korruptimi" të qenies vihen re në vazhdimësinë e ekzistencës kolektive të qenieve. Me tone ironike, në poezi shkruhet:

*por me një krenari të madhe qejfi ma
kish t'i rrëfej botës
se falë luftës kemi edukuar një varietet të
ri fëmijësh
fëmijët tanë nuk i duan përrallat luajnë
veçse me vrasje
në ëndërr dhe zhgënjendërr ëndërrojnë për
supë bukë dhe kocka
krejt si qentë dhe macet*

Dehumanizimi ka hyrë thellë në ekzistencën e qenieve njerëzore sa bëhet pjesë e trashëgimisë. Përthithja dhe brendësimi i sulmeve të jashtme nga qenia "e rrethuar" përcillen herët a vonë te secili prej nesh, boll që të jemi mjaftueshëm të ekspozuar ndaj sulmeve dhe terroreve tjetërsuese të botës së gjërave, dhe në mënyrë të pavetëdijshme ato kthehen në një domosdoshmëri për të mbijetuar në horrorin e përditshëm. As qenia më e pafajshme nuk i shpëton këtij fataliteti, duke na kujtuar heronjtë e tragjediive klasike, të cilët vuajnë për mëkatet e paraardhësve të tyre.

*mbrëmjeve ma ka ënda të bares kufinjve
të Qytetit
përgjatë sinoreve të pasigurta të lirisë
sonë*

Përherë e më shumë bëhet e kuptueshme që qyteti i rrethuar qenka në të vertetë një metaforë e njeriut modern të shqetësuar e plot ankth në një botë problematike më shumë se thjesht një qytet i rrethuar nga armiqët. Ky njeri mundohet sado pak të lirohet nga klima mbytëse që e "rrethon" ngado, por kjo duket se ndodh "mbrëmjeve", pra në fshehtësi, larg të tjerëve, thellë në nënvetëdijen njerëzore...

*rrethimi vazhdon aq gjatë armiqët si
duket ndërrohen
asgjë të përbashkët nuk kanë përpos
babëzinë për vdekjen tonë
(...) ngjyra e flamujve të tyre ndërrohet si
pylli në horizont –*

Luftërat, rrethimet, pushtimet, diktaturat... kjo mori gjak-dhe shpirtderdhjesh ka vazhduar e do vazhdojë. Jo më kot ka lindur shprehja "Historia përsëritet". Ndryshon forma, por jo përmbajtja. Në thelb është përherë njeriu ai që përfundon i humbur dhe i vuajtur, në pamundësi të ngrejë krye përballë absurditetit që zotëron në Botën e Objekteve. Jo më kot poeti shkruan që

paqëndrueshmëria e rëndomtë e gjendjes shpirtërore zgjidhet ende prej fatit. Ne flasim për fatin si rregullator të jetës së njerëzve sikur të ishte një entitet abstrakt i gjendshëm vetëm në mitologji apo në veprat e letërsisë klasike. Megjithatë, duket se pesha e fatit mbi jetën tonë qenka më e madhe nga ç'mendonim, gjersa dukuri të tilla vazhdojnë e përsëriten kundër vullnetit e mirëqenies së njerëzimit (ose më saktë, shumicës së tij, popullit të thjeshtë e të mashtruar prej "rrethuesve").

*ata s'e kanë përjetuar rrethimin e gjatë
sa përjetësia
ata që i ka pllakosur kubi janë prorrë të
vetmuar*

Kronikani-poet na njeh edhe me anën tjetër të medaljes: me "rrethuesit", armiqët. Duket se edhe ata pak njerëz të plotfuqishëm që marrin në duar fatet e njerëzve, duke i parë këta njerëz si asgjë më shumë se gurë shahu në lojën e tyre, janë vetë viktimat të një fati akoma më të madh se ata, i cili u qëndron si kob mbi kokë e i tmerron me rrezikun e humbjes së pushtetit. Të mos harrojmë se edhe ata qenë pjesë e "të rrethuarve" më parë, dhe dehumanizimi i tjetërsimit i vazhdueshëm i shtyu që qoftë edhe grimca më e vogël e pushtetit që u ra në duar t'i kthente në "rrethues", si shenjë hakmarrjeje ndaj jetës që u përgatiti fati më shumë sesa vetja e tyre.

*dhe nëse Qyteti bie dhe dikush do
shpëtojë
ai do ta bart në vetvete Qytetin udhëve
të syrgjynit
ai do të jetë Qyteti*

Ideja e parë që na krijohet nga këto vargje është ajo e ruajtjes së kujtesës së një të kaluarë që qe dikur e gjallë; ideja e dëshmisë së asaj që ekzistoi, në luftë të vazhdueshme me harresën. Problemi nuk është vetëm humbja e kujtimit apo idesë së një qytetërimi apo kulture, por e kujtimit të një populli që ndoshta nuk është më, por që dikur bënte një jetë po aq normale sa ajo që bëjmë ne sot e kësaj dite, para se ta pllakoste fati i errët.

Në një këndvështrim tjetër, na sugjerohet edhe ideja se thuasje gjithmonë është dikush që detyrohet të mbajë peshën e asaj që ka kaluar masa e gjerë. Nga njëra anë përgjegjësi, nga ana tjetër vuajtje. Në thelb, përherë sakrificë. Diçka e tillë na kujton Krishtin, si ai i mbajti në vetvete mëkatet e tërë njerëzimit dhe si imazhi i tij na kujton pikërisht absurditetin e ekzistencës njerëzore.

U dashka përherë që dikush të gjendet në kufi mes të qenit shpëtimtar e t'u bërit kurban, të mbajë përgjegjësi më shumë nga ç'është parashikuar, të mbajë njëherazi fatet e të gjithëve, ide të cilën do e gjenim edhe tek autori grek Niko Kazanxaqis, veçanërisht në romanin e tij *Krishti kryqëzohet përsëri*. Autori lëshon thirrjen:

Po mbushen gati dymijë vjet dhe hala... hala po të kryqëzojnë. Kur do të lindësh, o Krisht, që të mos kryqëzohesh më, e të rrosh midis nesh me shekuj?

Poezia mbyllet me vargjet:

*e shohim në fytyrë zjarrin dhe urinë dhe
vdekjen
dhe atë mënxyrën e mënxyrave – fytyrën
e tradhëtisë
Dhe sall ëndrrat tona janë të pamorta*

Ëndrrat e pavdekshme për të cilat flet poeti kanë të bëjnë me atë kujtim të zymtë që qëndron mes kufijve të vetëdijes dhe nënvetëdijes; atë kujtim që e jeton çdo individ e çdo popull e të cilin e trashëgojmë pafundësisht brez pas brezi; atë kujtim që ngelet plagë e përhershme në shpirtat e njerëzve.

Kështu, ajo që në fillim na u duk thjesht kronikë apo raport i një qyteti të rrethuar del që është dëshmi e një realiteti të trishtë të një historie të pambarimtë.



Apartamenti im është në një ndërtesë të vjetër prej druri, ndërtuar kushedi sa vjet më parë, vetëm njëkatëshe, me dy pjesë të ndara, përkarshi, struktur mes disa shtëpive gjysmë të rrënuara ku askush nuk jeton më. Imagjino tre kasolle të vjetra të cilat tanimë do të kishin rënë po të mos mbanin njëra-tjetrën dhe do ta kuptosh për çfarë e kam fjalën. Hapësira ku jetoj përmban një dhomë tatami, një kuzhinë të vogël me sobë teke dhe një dush që pikon. Depo nuk ka. Nga pas, hapësira për të nderur rrobat zihet e tëra prej kondicionerit dhe duket sikur muri i mbrapmë i shtëpisë sa vjen e më afrohet.

Ka qenë më para një grua e cila jetonte në hapësirën ndanë times, atëherë kur unë u zhvendosa këtu, por zyra e pronave të patundshme nuk ma thoshte emrin; pllakën në derë e kishte bosh e të zverdhur nga dielli dhe nuk kemi folur asnjëherë. Ishte buçko, me flokë të gjatë e të çrregullt, veshur përherë me të njëjtat roba dhe, jo se unë jam ajo që duhet ta gjykoj, por le të themi se nuk i kishte punët mirë me higjienën personale. Askush nuk i vinte për vizitë. Sa herë e shihja, diçka në qëndrimin e saj të kërrusur më thoshte se ose ishte apatike për jetën, ose ishte e dërrmuar, ose ishte dorëzuar, ose mbase të gjitha bashkë.

Kishte këtë tik: Kur kyçte derën pas vetes, nuk mund të mos e provonte dorezën, sërish e sërish, pa mundur ta pranonte se ishte kyçur. Kuisja ishte aq e dhunshme saqë, herën e parë kur e dëgjova, isha e bindur se një njeri i frikshëm ishte shfaqur për të marrë një borxh, por jo: ishte thjesht ajo. Sa herë dilte nga shtëpia, desh' shkëpuste derën nga menteshat, dhe gjithë kjo shkulje la çarje të dukshme në mur, mes derës së saj dhe times. Por, duhet ta them, e kuptoja pak se si ndihej. Kur isha më e re, kam kaluar një periudhë gjatë së cilës i laja duart aq shumë saqë copa e sapunit praktikisht më zhdukej ndër pëllëmbë.

Ndonjëherë vija veshin te muri mes nesh.

Kishte ditë kur mund të dëgjova një televizor në sfond, por kurrë ndonjërin prej tingujve që dikush mund të presë. Dhomat tona ishin imazhe të pasqyruara të njëra-tjetrës (ose kështu kuptova te zyra e pronave të patundshme), të ndara nga një mur i hollë dhe ndonjëherë, për shembull, po të isha duke larë enët, pyesja veten mos vallë edhe ajo po bënte të njëjtën gjë në të njëjtin çast, në anën tjetër të murit, por kthyer këndeje nga unë, jashtë rrezes time të shikimit. Dhe kështu, kur ndihesha sikur jeta po më mbyllej brenda vetvetes, shpesh më godiste fakti se komshia ime më e afërt ishte një grua së cilës nuk i dija as emrin. Tek kthehesha në shtëpi nga puna ime *part-time*, sytë, po t'i ngrija prej rrugës së zymtë ngjyrë gri që shtrihet larg në horizont, do të zinin dy dyert tona të rrënuara, të përflakura nga perëndimi i diellit, dhe kështu do të mendoja si ishim si binjake, të dyja, të plakura dhe të vetmuara njëra pranë tjetrës. Kur njëra prej dyerve, e paaftë ta përballojë gjithë këtë, më në fund do të përpihej nga zjarri, si do ia dilte tjetra të mbijetonte? Diçka rreth këtyre ndjesive përgjerohej që të bashkëndahej. Imagjinoja veten duke trokitur në derën e saj, por isha e frikësuar mos nuk do të mundesha ta shprehja veten ashtu sikurse duhej, çka më bënte të dëshiroja të mund të komunikoj me trokitje. T'i tregoja se si jeta ime nuk kishte marrë rrugën që unë doja. Se si asnjëherë nuk dukej sikur mund të bëja diçka ashtu sikurse duhej.



Se si nuk ia kisha dalë të ruaja atë që për mua do të thoshte gjithçka. Dhe mbi të gjitha, sa e dërrmuar isha nga gjithë këto ndjenja që po më derdheshin ngado. Sikur vetëm të mund ta vija në dijeni.

Në pranverë, nata binte para sesa bota të bëhej shumë blu për t'u duruar. Ditën kur lashë punën time part-time, tekta arrita në shtëpi me një kokë plot me mendime rreth moshës time, punës së ardhshme që do të gjeja, parave që do të më duheshin para se të vdisja, pashë gruan duke qëndruar mes dyerve. Meqë nuk po provonte dorezën, dukej se sapo ishte kthyer në shtëpi. Paçka se ishin bërë katër vite që jetoja aty, kjo ishte hera e parë kur ishim aq pranë njëra-tjetrës, pa një mur ndërmjet. Atëherë një aromë

më ngacmoi hundën, aromë e tillë që më tregoi se nuk kishte bërë dush prej ca kohësh. Në ankth, e përshëndeta me kokë. Ashtu bëri edhe ajo. Në ato dy sekonda që u pamë sy më sy, vura re se lëkurën përreth syve e kishte të errët dhe të lagët. Kur kishte filluar shiu?, mendova, tërësisht konfuze. Por atëherë ngrita kokën. Nuk po binte shi. Ajo po qante. Flokët e yndyrshëm i ishin ngjitur pas ballit të rrudhur dhe emocionet plot shqetësim që mbante në turinjtë e varur më mbetën të ngulura në kujtesë. Fjalët m'u shfaqën në mendje, por isha e paaftë t'i thosha, jo më të formoja një fjali. Aq keq sa ndihesha, më duhet të ikja; sikur dikush po më zbrapste me bërryl. Duke ngatërruar çelësat nëpër duar, ia dola të



çelja derën dhe të hyja brenda. Për shumë sekonda, pashë nga syri magjik, por nuk e kuptoja dot në ishte aty jashtë apo jo.

Pas kësaj, nuk kishte asnjë mundësi të qetësohesha. Teksa nata shtriqej përpara, e vura veshin shumë herë në mur. Por nuk dëgjova gjë, dukej sikur asgjë nuk vinte nga matanë. Piva ca ujë, u shtriva përmbi futon, fik e ndiz televizorin, në një përpjekje boshe për ta hequr mendjen, por kjo ndjesi e vazhdueshme shqetësimi po rritej e bëhej më e fortë. Vura sërish veshin në mur, por nuk dëgjova asgjë. Pse nuk i thashë dot diçka? Ajo kishte qenë duke qarë. Të paktën, mund t'i kisha dhënë një nga topthat me mish që kisha marrë në pazar. Kishte qenë duke qarë. Një mendim i errët më rrëshqiti në mendje: Mbase mund të kthehesha në njeriun e fundit që e kishte parë. Atëherë mendova për time ëmë, herën e fundit kur kisha parë atë, dhe gishtat më prekën fytin. Por njerëzit nuk është se thjesht zhduken, kështu si pa gjë fare. Duhet kohë, shumë kohë për t'u zhdukur gjithë pjesët e tyre që ke mbajtur brenda vetes. Megjithatë, tekta ato tkurren, të tjera pjesë të tuat zmadhohen dhe në një pikë, gjithçka çfarë ke pasur më para zhduket.

E hoqa veshin nga muri dhe bëra dorën grusht. Puls i po rrihte si i çmendur. Mora frymë thellë, u përpoqa të qetësohesha dhe pashë derën e saj të më materializohej para syve, aty, në murin e pisët mes dy apartamenteve tona.

Trokita, mu në mes të tij, ngadalë, dy herë. Tak tak, atëherë ndalova për një çast para se ta bëja sërish. Dy trokitje. Këtë herë pak më të forta. Sërish asnjë përgjigje. Njëllor si më parë.

Kështu e tërhoqa futonin ngjitur për mur dhe ashtu kalova gjithë natën. Idiote, i thashë vetes. Tani, ka të ngjarë që ajo të jetë larguar për diku e të mos kthehet më kurrë. Dhe, edhe sikur të jetë akoma aty, mbase nuk të dëgjon më. Por vazhdova trokitjet – tak, tak – duke pritur një çast para se ta bëja sërish. Pas kushedi sa kohe, më zuri gjumi dhe pata ëndrrat më të çuditshme, me këto modele dhe forma shqetësuese dhe ndërmjet tyre, pata kohë të trokisja edhe ca herë.

Dalëngadalë, duhet të kem rënë në një gjumë të thellë, sepse më zgjoi drita e mëngjesit. Shtriqja krahët dhe trokita sërish, sikur të vazhdoja aty ku e kisha lënë në ëndërr. Por atëherë, pas një çasti, dëgjova diçka. Ishte një e trokitur, vetëm një, që vinte nga ana tjetër. U ngrita, pulita sytë dhe ngjesha veshin në mur. Isha e sigurt se e kisha dëgjuar, e dija se kisha dëgjuar një trokitje. Nuk isha e sigurt ama nëse po më thoshte Çkemi, më çave kokën apo Çkemi, faleminderit apo Çkemi, ndalo të lutem, apo të gjitha këto apo diçka krejt tjetër, por isha e sigurt se ajo më ishte përgjigjur me një trokitje të sajën. Tërësisht e sigurt.

Duke e nxjerrë gjithë ajrin nga mushkëritë, mbuloja kokën me çarçaf, por ishte mëngjes. Koha për t'u ngritur. Por atëherë u kujtova: Nuk jam në punë. Dhe prapëseprapë, nuk ishte e frikshme. Me fytyrën e zhytur në jastëk, i lejova sytë të mbylleshin edhe një herë tjetër.

Mieko Kawakami është shkrimtare japoneze, autore e tre librave shumë të njohur "Gjinj dhe vezë", "Qeill" dhe "Gjithë dashnorët e natës", e nderuar me çmime të shumta si "Akutagawa" dhe po ashtu, me "Qeill", e nominuar për Booker Prize.

Vepra e saj është vlerësuar nga disa prej autorëve më të rëndësishëm bashkëkohorë, mes të cilëve edhe Haruki Murakami. Në shqip, botohet nga shtëpia botuese "Onufri".

Karikaturë nga Arben Mexsi

